Në procedurat e prokurimit me vlerë nën kufijtë e lartë monetarë, nëse një apo disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave i refuzon ato, duke i skualifikuar nga procedura, pa i kërkuar sqarim ofertuesit/sve.

Në procedurat e prokurimit me vlerë mbi kufijtë e lartë monetarë, nëse një apo disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, duhet t'i kërkojë operatorit ekonomik të paraqesë brenda tre ditëve pune, shpjegime të çmimit ose kostove të propozuara në ofertë, në përputhje me nenin 93 të LPP-së dhe të vlerësojnë informacionin e dhënë, në konsultim me ofertuesin në përputhje me dispozitat e këtij neni.

Në çdo rast, ofertuesi ka detyrimin të justifikojë dhe dokumentojë me prova me shkrim, shpjegime për elementin/elementet specifike të ofertës, në përputhje me kërkesat e nenit 93 të LPP-së.

2.1 Formula që duhet zbatuar, për të vlerësuar një ofertë anomalisht të ulët, në rastin kur ekzistojnë tre ose më shumë oferta të vlefshme, është si më poshtë:

O - Oferta

MO – Mesatarja e ofertave të vlefshme

N - Numri i ofertave të vlefshme

PR (Zm) – Zbritje e mundshme

MO = O1 + O2 + O3 + ... On / N

PR = 85 % Mo

Vlera e ofertave të vlerësuara < .. PR rrjedhimisht oferta është anomalisht e ulët.

3. Nëse një Operator Ekonomik nuk pranon korrigjimin e gabimeve aritmetike, ose nëse Ofertuesi nuk arrin të japë një justifikim për të bindur Autoritetin/Entin Kontraktor, në rast të një oferte anomalisht të ulët, Oferta e tij do të refuzohet.

4. Procesi i hedhjes së shortit

Nëse dy ose më shumë oferta kanë të njëjtin çmim më të ulët ose kanë të njëjtat pikë, atëherë fituesi përcaktohet me short, në prani të ofertuesve. Ofertuesit njoftohen për datën dhe kohën e hedhjes së shortit. Mospjesëmarrja e ofertuesve gjatë procesit të hedhjes së shortit nuk përbën arsye për skualifikim.

D. DHËNIA E KONTRATËS

- | | |
|---|--|
| 23. Njoftimi i Fituesit | 1. Brenda afatit të vlefshmërisë së Ofertës, Autoriteti/Enti Kontraktor njofton Operatorin Ekonomik të suksesshëm se, Oferta e tij është pranuar, dhe është shpallur fituese. |
| 24. Nënshkrimi i Marrëveshjes Kuadër/Kontratës | <p>1. Pas konfirmimit të fituesit/ve Autoriteti/Enti Kontraktor përgatit, nënshkruan dhe fton Operatorin/ët e suksesshëm Ekonomik të nënshkruajë Marrëveshjen kuadër/Kontratën.</p> <p>2. Autoriteti/Enti Kontraktor i kërkon fituesit një sigurim për realizimin e Kontratës. Shuma e mbulimit për realizimin e kontratës do të jetë 10% e vlerës së Kontratës. Formulari i Sigurimit të Kontratës, dorëzohet para nënshkrimit të Kontratës.</p> <p>Sigurimi për realizimin e kontratës mund të paraqitet në një nga format e mëposhtme:</p> <ul style="list-style-type: none"> a) mundësi pagese nga ofertuesi në vlerë monetare, në llogarinë e autoritetit ose entit kontraktor; b) garanci bankare; c) garanci nga shoqëri sigurimi. |

DH. ANKESAT

25. Procedura e ankesës

1. Çdo Operator Ekonomik, i cili ka interes të ligjshëm për objektin e prokurimit dhe rrezikon të dëmtohet nga vendimmarrja e autoritetit/entit kontraktor mund të paraqesë ankesë njëkohësisht pranë autoritetit/entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik në lidhje me Dokumentet e Tenderit, kualifikimin, përzgjedhjen ose përcaktimin e ofertës fituese, sipas parashikimeve në LPP dhe aktet nënligjore, në Sistemin e Ankesave Elektronike.
2. Në rastet e ankesave për vendimet e autoritetit ose entit kontraktor për përzgjedhjen e kandidatëve pas fazës së parakualifikimit ose për procesin e vlerësimit të ofertave, operatorët ekonomikë, të cilët kanë marrë pjesë në procedurën e prokurimit dhe mund të cenohen nga ankesa e paraqitur, kanë të drejtë të paraqesin argumentet e tyre në lidhje me këtë të fundit njëkohësisht pranë autoritetit ose entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik në Sistemin e Ankesave Elektronike..

Kundër vendimit të autoritetit ose entit kontraktor, operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën, kanë të drejtën të ankohen pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

3. Autoriteti/Enti Kontraktor mund t'i kërkojë Komisionit të Prokurimit Publik që të lëshojë masa të ndërmjetme për mospezullimin e procedurës së prokurimit.

E. ANULIMI I PROCEDURËS

26. Anulimi i procedurës

1. Autoriteti / Enti kontraktor publikon vendimin përfundimtar për Anulimin e Procedurës së Prokurimit, në të njëjtën mënyrë siç publikon Njoftimin e Kontratës, jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga data e skadimit të afatit të fundit për paraqitjen e ankesave, ose dhënien e vendimit përfundimtar për ankimin.
2. Autoriteti/ Enti kontraktor anulon procedurën e prokurimit në rastet kur:
 - a) nuk është paraqitur asnjë kërkesë e përshtatshme në procedurat me faza;
 - b) nuk është paraqitur asnjë ofertë e përshtatshme në procedurat me një fazë;
 - c) konstaton se dokumentet e tenderit përmbajnë gabime ose mangësi të rëndësishme;
 - d) për shkak të rrethanave të paparashikueshme dhe objektive, nevojat ose aftësia paguese e autoritetit ose entit kontraktor ka ndryshuar;

e) Komisioni i Prokurimit Publik vendos anulimin në përputhje me parashikimet në LPP;

Gjithashtu, Titullari i autoritetit/entit vendos anulimin e procedurës sipas përcaktimeve në nenin 19 të LPP dhe nenin 75 të VKM 285/2021, të ndryshuar.

3. Kur procedura e prokurimit publik anulohet në përputhje me shkronjën "d" të paragrafit 2, autoriteti/enti kontraktor nuk duhet të shpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt të prokurimit dhe me të njëjtat të dhëna.

4. Nëse, Autoriteti/Enti Kontraktor duhet të rishpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt të prokurimit dhe me të njëjtat të dhëna, nuk duhet të vijojë me rishpalljen e saj në Sistemin e Prokurimit Elektronik përpara përfundimit të afateve të ankimimit/shqyrtimit të ankesave dhe vendimit të marrë lidhur me to.

SEKSIONI II: LISTA E SHTOJCAVE

Shtojca 1: Formulari i Ofertës Ekonomike

Shtojca 2: Formulari i Ofertës ekonomike, për procedurat e prokurimit për furnizimin me karburant, gazoil, benzol dhe karburant për ngrohje, kur aplikohet si kriter vlerësimi oferta ekonomike më e favorshme bazuar në çmimin më të ulët nga operatori ekonomik

Shtojca 3: Listat e Çmimeve të artikujve

Shtojca 4: Formulari i Sigurimit të Ofertës

Shtojca 5: Lista e Informacionit Konfidencial

Shtojca 6: Formulari i Specifikimeve Teknike

Shtojca 7: Formulari i Sasisë dhe Grafikut i lëvrimit

Shtojca 8: Formulari i Kritereve të Përzgjedhjes së Ofertuesve

Shtojca 9: Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit

Shtojca 10: Formulari i Njoftimit të Skualifikimit

Shtojca 11: Formulari i Njoftimit të Fituesit, pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimimit

Shtojca 12: Formulari i Njoftimit të Fituesit, në përfundim të afateve të ankimimit

Shtojca 13: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimimit

Shtojca 14: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër, në përfundim të afateve të ankimimit

Shtojca 15: Formulari i Njoftimit të Anulimit të Procedurës së Prokurimit, pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimimit

Shtojca 1.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

FORMULARI I OFERTËS EKONOMIKE⁴

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: **[Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit/Entit Kontraktor]**

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i **[Operatori Ekonomik shënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt:**[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE]**, përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.

b) Ne **[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti]**, nuk jemi të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës **[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]**.

c) Ne ofrojmë t'i furnizojmë Autoritetit/Entit Kontraktor **[vendos emrin e Autoritetit/entit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Mallrat për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve të Artikujve dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.

d) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme:

1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
2. Njoftimin e Kontratës;
3. Kriteret e Përzgjedhjes;
4. Specifikimet teknike, grafikun e lëvrimit dhe sasinë e kërkuar;
5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
6. Kushtet e Veçanta të Kontratës;
7. Listat e Çmimeve të Artikujve.

e) Çmimi total i Ofertës sonë, **pa TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**

f) Çmimi total i Ofertës sonë, **me TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**

⁴ Vlera e ofertës ekonomike nuk duhet të kalojë dy shifra pas presjes dhjetore.

Emri i përfaqësuesit të ofertuesit	
Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

Shtojca 2.

[Në rastin e procedurave të prokurimit për furnizimin me karburant, gazoil, benzol dhe karburant për ngrohje, kur aplikohet si kriter vlerësimi oferta ekonomike më e favorshme bazuar në çmimin më të ulët, nga operatori ekonomik plotësohet dhe paraqitet vetëm kjo Shtojcë]

FORMULARI I OFERTËS EKONOMIKE⁵

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: **[Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit/Entit Kontraktor]**

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i **[Operatori Ekonomik shënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt:**[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE]**, përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.

b) Ne **[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti]**, nuk jemi në të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës **[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]**.

c) Ne ofrojmë t'i furnizojmë Autoritetit/Entit Kontraktor **[vendos emrin e Autoritetit/entit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Mallrat për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve të Artikujve dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.

ç) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme:

1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
2. Njoftimin e Kontrates;
3. Kriteret e Përzgjedhjes;
4. Specifikimet teknike, grafikun e lëvrimit dhe sasinë e kërkuar;
5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
6. Kushtet e Veçanta të Kontratës.

⁵ Vlera e ofertës ekonomike nuk duhet të kalojë dy shifra pas presjes dhjetore.

d) Norma e fitimit e shprehur në vlerë absolute është si më poshtë:

1	2	3
Nr.	Përshkrimi i mallrave	Norma e fitimit e shprehur ne vlerë absolute

Emri i përfaqësuesit të ofertuesit	
Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

Kujdes: Bazuar në parashikimet e nenit 45/2.1 të VKM Nr. 285/2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, kur si kriter vlerësimi përdoret “oferta ekonomikisht më e favorshme bazohet në çmimin më të ulët”, autoriteti/enti kontraktor përlllogarit çmimin bazuar në:

- a) çmimin e bursës, së datës kur është publikuar njoftimi i kontratës së procedurës së prokurimit, i konvertuar sipas kursit zyrtar të këmbimit të Bankës së Shqipërisë të kësaj date
- b) elementet fiskale;
- c) normën e fitimit të shprehur në vlerë absolute, e cila duhet të jetë e pandryshuar gjatë gjithë kohës së zbatimit të kontratës;

Shtojca 3.*(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)***LISTA E ÇMIMEVE TË ARTIKUJVE****Data:** _____**Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:**
_____**Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë** (në rast BOE): _____**Monedha:** _____

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, këto do të zbatohen rregullat e përcaktuara në Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Të gjithë artikujt në këtë Formular duhet të plotësohen dhe t'u vendoset çmimi i ofruar në Listën përkatëse të Çmimeve për artikujt. Artikujt pa vlerë do të konsiderohen si artikuj të paofruar dhe do të çojnë në refuzimin e ofertës.

Lista e Çmimeve

1	2	3	4	5	
Artikulli	Përshkrimi i mallit	Sasia	çmimi per njesi	Çmimi total për artikull (3 x 4X)	
1.					
2.					
3.					
4					
	Çmimi total (Mallrat)				_____
Çmimi Neto pa TVSH					
TVSH (%)					
Çmimi total me TVSH:					
Emri i përfaqësuesit të ofertuesit					

Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

Shtojca 4.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

[Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve]

FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

Për: *[Emri dhe adresa e autoritetit/entit kontraktor]*

Në emër të: *[Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]*

* * *

Procedura e prokurimit *[lloji i procedurës]*

Përshkrim i shkurtër i kontratës: *[objekti]*

Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike *[Data]* *[Numri]/Nr. Referencës në faqen e APP-së.*

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e *[emri i autoritetit/entit kontraktor]* vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës së prokurimit kur autoriteti/enti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në *[njoftimin e kontratës]*.

[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]

Shtojca 5.

(Shtojcë për tu paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)

Lista e Informacionit Konfidencial

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial)

Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial	Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale	Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni	Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni

VËMENDJE

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtësit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti/Enti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkelje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkretisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Përfaqësuesi i Ofertuesit

Nënshkrimi

Vula

Shtojca 6.

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Përshkrimi i Specifikimeve Teknike të mallrave objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

Në hartimin e specifikimeve teknike, autoritetet /entet kontraktore mbajnë në konsideratë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin përkatës në fushat, si më poshtë:

- a) Kërkesat minimale të performancës së energjisë, siç përcaktohet në legjislacionin në fuqi për efikasitetin e energjisë dhe për performancën energjetike në ndërtesa, konsumin e energjisë dhe burimeve të tjera të produkteve me ndikim në energji, përfshirë parashikimet për përdorimin e etiketave për produktet me ndikim në energji;
- b) Specifikimet teknike për produkte të caktuara, siç përcaktohet në aktet ligjore dhe nënligjore të fushës me qëllim përmirësimin e performancës energjetike dhe uljen e ndikimit në mjedis;
- c) Çdo parashikim tjetër që buron nga legjislacioni mjedisor, energjetik, social dhe i punës.

Skicimet, parametrat teknik etj:

Specifikimi i Materialeve:

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

SPECIFIKIM TEKNIK

OBJEKTI: 1. Kostum uniforme (kapele, xhakete, pantallona ose fund për punonjëset) për punonjësit e Gardës së Republikës.

Ky specifikim teknik paraqet kërkesat themelore teknike të domosdoshme për prodhimin e artikullit "Kostum uniforme". Në këtë specifikim teknik përcaktohen gjithashtu dhe kërkesat teknike të aksesoreve që shoqërojnë artikullin "Kostum uniforme", si produkt i gatshëm .

Të gjitha përcaktimet teknike të këtij specifikimi teknik duhen të zbatohen detyrimisht saktë nga prodhuesi.

Për procedurë vleresimi dhe miratimi nga perdoruesi, pjesemarresi prodhues konkurues është i detyruar të paraqesi si ofertë teknike të realizuar sipas kërkesave të këtij specifikimi teknik:

- 1 (një) komplet kostumi të perfunduar (kapele, xhakete, pantallona, fund) me nr gjoksi 50.
- 1 (nje) pjesë stofi gjatësi 0,5 ml, gjëresi sa ajo e vet stofit.
- Fletë-analizë laboratorike të treguesve fiziko-mekanik e kimik të lëndës së parë të perdorur nga prodhuesi.

Copa e mostres, lëndës së parë dhe ajo që i bashkengjitet raport-analizes duhet të jenë detyrimisht të njëjta.

Kostumit dhe lëndës së parë u qepet nga një etiketë tekstili të bardhë në të cilën shkruhet: moster “Kostum uniforme”, emri i ofertuesit, data, nënshkrimi dhe vula e ofertuesit.

Mungesa e mostres, lëndës parë dhe fletë analizës që shoqeron ato është kusht skualifikues.

- **LENDA E PARE** : Tekstil me ngjyrë e zezë me përzierje ($\pm 3\%$) : 70 % lesh, 30 % poliester
- **Masa** : 240 gr/m² ($\pm 3\%$)
- **Thurja** : Sarzh.2/2
- **Dëndësia e fijeve në 10 cm**: në bazë 320 +/- 6 , në ind 280 +/- 6 .
- **Numri metrik** Nm. bazë 40/2-42/2 Nm. ind 40/2-42/2
- **Trashësia e tekstit** 0.50 mm +/- 0.15 mm
- **Qëndrueshmeria në ferkim** mbi 4200 cikle
- **Qëndrueshmeria në kg** : në bazë 78-6 në ind 57 – 6.
- **Qëndrueshmeria e ngjyrës** : shumë e mirë

Në lëndën e I-rë stof i zi që duhet të përdoret për konfeksionimin e artikullit “Kostum uniforme” difekte të përhapura të pamjes së jashtme të cilat detyrimisht nuk lejohen do të konsiderohen : papastertite me origjine bimore, njolla të ndryshme vaji ose boje, tonacione të ngjyres , oksidime, rrudhosje, mungesë të fijeve në ind e në bazë, trashim të fijeve në ind e në bazë, vrima në sipërfaqe, lekundje në gjerësi etj. (S.SH.1038 – 88)

M A T E R I A L E T N D I H M E S E :

Materialet ndihmëse që duhet të përdoren për prodhimin e artikullit “Kostum uniforme” janë:

- **Astar** imitim mendafshi ngjyrë e zezë me përbërje 100 % PES
- **Merle** (flieseline e posaçme për kostume) si material ngjites perforcues special të pershtatshem për xhaketen, pantallonin, fundin dhe kapelen me përbërje 100 % PES
- **Shirit tekstili i kuq 3 mm secili**) për fileto e kapeles, xhaketes dhe pantollonave, sipas specifikimit
- **Kanavace** cilësia e I-rë me përbërje 100 % lesh
- **Vata** të posaçme për kostum (materiali i vatave të mos jetë pambuk)
- **Astar xhepi** në ngjyre të zezë, material tekstil me përbërje 100 % viskoz
- **Kopsa të medha garde** me konfiguracion në ngjyrë të artë, material metalik, copë 4 + 2 rezervë (sipas specifikimeve bashkengjitur)
- **Kopsa të vogla garde** me konfiguracion në ngjyrë të artë , material metalik, copë 6 + 2 rezerve (sipas specifikimeve bashkengjitur)
- **Stof leshi** me ngjyrë të errët për të poshtmen e jakes
- **Qemer** i pergatitur për pantallonat dhe fundet
- **Kopsa të vogla** të zeza ebaniti

- **Kapse metalike** mashkull – femer për mbylljen e pantallonave dhe fundeve
- **Zinxhir** me dhembeza plastike **22-24 cm** për pantallonin dhe fundin
- **Penj qepje** të zi me Nm 80/2 për qepje industriale me përbërje 100 % PES
- **Materiallet** që duhet të përdoren për ndertimin e kapeles si : shirit tel çeliku petashuq, material

ingeliti me vrima në sipërfaqe, shirit plastik i presuar me vrima, astar i zi me vrima për ajrim,

strehe me ngjyrë të zezë me lluster,

Elementet Velcro femer (ngjyrë e zezë) për vendosjen:

- **E shenjes së mbiemrit:** Siper në gjoksin e djathtë, vendoset velkrof femer në formë drejtekendeshi 8.5 cm x 2.5 cm, për vendosjen e mbiemrit.
- **E Stemes së Republikës dhe Stemes së Gardës,** velkrof femer në mëngë, me permasa 7.5 cm x 6 cm +/-0.1 cm, pjesa e sipërme është e drejtë ndërsa e pjesa e poshtme në formë ovale (shqyti) me distancë rreth 7-8 cm nga gavatura e mëngës.

“Kostum uniforme” kompletohet me:

- **Steme e Republikës** me velkrof mashkull (sipas specifikimeve të dhëna)
- **Steme Garde** me velkrof mashkull (sipas specifikimeve të dhëna)

Artikulli **“Kostum uniforme oficeri dhe nenoficeri”** prodhohen në gjashtë gjatesi trupore dhe porositen nga përdoruesi në sasi të përkatese sipas numrave të gjokseve **44 – 60** të cilën subjekti prodhues është i detyruar ta respektojë saktësisht. Përmasat e dhëna të elementeve të cilat bëjnë pjesë në ndertimin e kostumit jepen në tabelat e mëposhtme.

Kostumi për meshkuj, përmasat produkti i gatshëm (cm) jepen në këtë tabelë :

Gjatesia e trupit	Prerja	Iniciali prerjes	Gjatesia e xhaketes produkti i gatshëm	Gjatesia e pantallonit produkti i gatshëm
155-160	e parë	I	70	93
161-166	e dytë	II	73	97
167-172	e tretë	III	76	100
173-178	e katërt	IV	79	103
179-184	e pestë	V	82	106
185-190	e gjashtë	VI	85	110

Kostumi për femra, përmasat produkti i gatshëm (cm) jepen në këtë tabelë :

Gjatesia e trupit	Prerja	Iniciali prerjes	Gjatesia e xhaketes produkti i gatshëm	Gjatesia e pantallonit produkti i gatshëm	Gjatesia e fundit produkti i gatshëm (c)
143-148	e parë	I	65	86	53
149-154	e dytë	II	68	90	55
155-160	e tretë	III	71	94	57
161-166	e katërt	IV	74	97	59
167-172	e pestë	V	77	100	61
173-178	e gjashtë	VI	80	104	63

Kostumet për meshkuj do të jenë të numrave nga Nr.46 deri në Nr.56,

Kostumet për femra do të jenë të numrave nga Nr.44 deri në Nr.50. (kapele, xhakete, fund)

Sasia sipas numerave do bëhet mbi bazën e kërkesave të Gardës me lidhjen e kontratës me prodhuesin.

Prodhimi i artikullit “**Kostum uniforme**” duhet të realizohet sipas një procesi teknologjik të percaktuar mbi bazën e kërkesave dhe kushteve teknologjike të sakta në secilen fazë të realizimit të tij. Prodhimi ndahet në tre faza kryesore të cilat janë :

- përpunimi pergatitor
- konfeksionimi (procesi i qepjes)
- ambalazhimi, marketimi dhe etiketimi

Përpunimi pergatitor ka të bëjë me kolaudimin e lëndeve të para dhe ndihmese, skicimin, prerjen në prestari, marketimin dhe kollaritjen e pjesëve përbërse të kostumit (xhaketes, pantallonit, fundit dhe kapeles).

Konfeksionimi ka të bëjë me qepjen e pjeseve përbërse të kostumit (xhaketes, pantallonit, fundit dhe kapeles) sipas një procesi linear të percaktuar. Në faza të ndërmjetme të këtij procesi do të kryhet hekurosja dhe presimi me avull i gjysëmprodukteve. Në perfundim kryhet dhe hekurosja e produktit të gatshëm.

Ambalazhimi ka të bëjë me etiketimin, amblazhimin për çdo produkt dhe amblazhimin total të gjithë sasisë të produktit të gatshëm dhe pergatitjen e tij për levrimin drejt magazinave të përdoruesit

PERPUNIMI PERGATITOR

Kolaudimi i lëndës së parë dhe materialeve ndihmese

Kolaudimi i lëndës së parë dhe materialeve ndihmese në menyrë të saktë dhe të drejtë është bazë për një ecuri cilësore të procesve teknologjike të metejshme zinxhir për prodhimin me cilësi të artikullit “**Kostum uniforme** oficeri dhe nënoficeri”

Skicimi

Ky proces duhet të realizohet me metodat matematikore të programimit linear të cilat sigurojnë një shenim të saktë të prerjeve dhe shenjave sipas vizatimeve duke pasur kujdes që detajet e kostumit duhet të jenë në drejtim të fijeve të bazës.

Prerja

Procesi i prerjes duhet të bëhet me shume kujdes që të mos ketë devijime në fletet e fundit të dyshekut i cili është mirë që të mos kalojë 80 fletë. Kujdes duhet të bëhet dhe në pjeset e harkuara të detajeve dhe buzët e prera të mos jenë me dhëmbëza.

Marketimi

Ky proces është shumë i rëndësishëm sepse eliminon qepjen e detajeve të kostumit me tonacione të ndryshme duke siguruar njëllojshmeri në ngjyrë të artikullit.

Kollaritja

Detajeve gjysëm të gatshme të pantallonit dhe të fundit ngjitja e flieselines duhet të bëhet me prese speciale me avull në Tem. 130-140 °C, në kohë 8-10 sek. në presion 2 atm. Ky proces duhet të kryhet sa më i saktë në menyrë që të mos ketë asnjë mundësi që në objekt të krijohen deformime gjatë hekurosjes me avull, larjes dhe lagies nga shiu, të cilat bëjnë të mundur humbjen e pamjes fillestare. Kollaritja dhe ngjitja nuk lejohet me shtesa.

Merlja (flieseline e posacme për kostume) ngjitet në perparsen e djathtë e të majtë të xhaketes, në jaka dhe kapaket e xhepave. Gjithashtu, Merlja (flieseline e posacme për kostume) ngjitet në këto pjesë si më poshtë:

4 detaje në xhepat pllake, 2 detaje tek spalinat e supit, 4 detaje tek fundet e mëngës, 4 detaje tek fundet e xhaketes mbrapa, 2 detaje në pjesën e shpinës sipër, 2 detaje në gavatë, 2 detaje tek mostra e xhepit brenda, 1 detaj tek kapaket e xhepave, 2 detaje tek qemeri i pantallonit

dhe i fundit, **1** detaj tek filetoja e pantallonit, **1** detaj tek kapaku i xhepit te pantallonit, **1** detaj tek sallkia, **2** detaje tek kanavaca, **1** detaj tek hapja mbrapa e fundit.

KONFEKSIONIMI

Procesi i Qepjes

Xhaketa eshte me kater kopsa, me dy kamat e hapura ne perparse, kama e pare ne mesin e gjoksit dhe e dyta ne gavature. Kamat mbyllen 10-11 cm poshte vijes se mesit. Xhaketa ka 4 xhepa pllake me kapake me nje vrimë ne mes qe mberthehen me kopsa te vogla Garde (sipas specifikimeve bashkengjitur).

Xhepat ne anen e poshtme behen me cepa pak te harkuar. Dy xhepat e vegjel me permasa (gjatesi,gjeresi) 15 x 13 +/- 1 cm jane ne pjesen e gjoksit, dy xhepat e medhenj te poshtem me permasa (gjatesi,gjeresi) 21 x 19 +/- 5mm. Ne dy perpareset ka nga nje xhep te brendshem me fileto dhe ylyk qe jane te futur ne astar dhe mberthehen me kopsa te vogla civile te zeza. Kapakeve te xhepave u kalohet tegeli ne ane. Gjatesia e kapakeve eshte sa gjeresia e xhepave , gjeresia e kapakut te xhepit te siperm 6 +/- 0.5 cm , gjeresia e kapakut te xhepit te poshtem 7 +/- 0.5 cm. Kapaku i xhepit te siperm behet pak i harkuar ne dy cepat.

Jaka e xhaketes eshte me forme karakteristike te pershtatshme per kostume. Jaka eshte monopet, e nenteshmja e saj eshte me material leshi te posaçem (ngjyre e afert me te stofit) per ruajtjen e formes dhe mos deformimine saj.

Perparsja, shpina dhe menget jane te veshura me astar mendafshi me ngjyre te njejte me stofin.

Xhaketa ne mengën e djathte 7-8 cm poshte qepjes se bashkimit te menges me trupin e matur nga pika me e larte e supit ne qender vendoset me velkrof femer-mashkull “Stema e Gardes” sipas specifikimeve teknike te saj bashkelidhur. Po keshtu ne mengën e majte te xhaketes 7-8 cm poshte qepjes se bashkimit te menges me trupin e matur nga pika me e larte e supit ne qender vendoset me velkrof femer-mashkull “Stema e Republikës” sipas specifikimeve teknike te saj bashkelidhur.

Ne gjoksin e djathte ne qender mbi xhepin e djathtë vendoset velkrof femer ne ngjyre te zeze ne forme drejtekendshi me permasa 8.5 cm x 2.5 cm, qe do te sherbeje per vendosjen e mbiemrit.

Xhaketa duhet te jete simetrike ne te gjithë elementet perberes te saj.

Gjokseve te xhaketes u ngjitet merlja (flieseline e posacme per kostume) ne prese speciale. Pas ketij procesi gjokseve u montohen xhepat e pergatitur dhe u ngjitet shiriti ngjites dhe shirit fortese ne sup ne gavature dhe ne pjesen fundore te gjokseve. Gjokseve u vendoset materiali perforcues kanavce Kanavaca duhet te jete me dy fortesa. Fortesa e dyte duhet te jete rreth **10-12 cm** me e shkurter se e para. Per ti dhene formen e plote te gjoksit kanavaces duhet ti behen **2-3** prerje. Pas fiksimit te kanavaces dhe mbylljeve te prerjes se saj behet kalimi ne procesin e hekurosjes me prese speciale me avull ku i jepet forma e gjoksit. Ky proces ka rendesi te vecante sepse jep formen e trupit prandaj duhet bere me shume kujdes qe rrudhat qe mund te krijohen te eliminohen duke i shtyre ne drejtim te qepjeve anesore te xhaketes.

Xhepat e xhaketes jane pllake dhe me cepa e poshtem te rrumbullakosura. Xhepat ne mes kane nje palosje ne mesin e te ciles lart vendoset nje kopse plastike ne ngjyre te arte te shndritshme qe sherben per mbylljen e xhepit. Xhepat mbyllen me kapak. Xhepat dhe kapaket qe te jene uniform duhet te pergatiten me kallep qepjeje. Xhepave pasi u ngjitet flieselina u qepet astari dhe pastaj hekurosen. Xhepave iu kalohet nje tegel zbukurimi 1 mm larg buzes. Gjate fiksimit te xhepave tek gjokset duhet bere kujdes qe ato te jene te shtrira mire dhe te

jene simetrike pra ne te njejtin nivel distance ne te dy gjokset.Xhaketes nga brenda ne te dy gjokset u qepet nga nje xhep i vogel me ylyk dhe mbyllje me kopse.Ne xhepin e majte nga brenda vendoset etiketa e firmes prodhuese me numrin perkates te kostumit dhe insruksionin e larjes,hekurosjes dhe te pastrimit.

Kapaket e xhepave jane me harqe te harkuara nga brenda dhe me nje vrimë ne mes.Kapaket perbehen nga pjesa e sipërme dhe e poshtme.Pjeses se sipërme te kapakut per perforcim iu ngjitet flieselina ,bashkohet me pjesen e poshtme,khehen dhe pastaj u qepet astari dhe hekurosen.Kapakut i kalohet nje tegel zbukurimi **5 mm** larg buzës.Duhet bere kujdes qe cepat e kapakut te mos jene te rrumbullakta por te kene pamje estetike.Mbi kapakun e xhepit te djathte ne qender vendoset velkrof femer ne ngjyre te zeze ne forme drejtekendshi qe do te sherbeje per vendosjen e mbiemrit.

Shpina eshte e drejte e paçare. Ne gavaturen e shpines vendoset nje fortese.Ne pjesen e supit tek koka e menges vendosen vatat speciale per kostum te cilat duhet te dalin 1-1.5 cm nga buza e supit.Vatat speciale per kostum vendosen me pak kend qe ti pershtaten formes se supeve.Gjate montimit te shpines me gjokset duhet bere shume kujdes ne menyre qe te mos krijohen diferenca ne gjatesi te gjokseve.

Astari i brendshem perbehet nga ai i perparses,i shpines dhe i mengeve.Prerja e astareve te gjokseve,te shpines dhe te mengeve duhet te jene ne po ate forme qe kane copat e prera te stofit me rezerven e duhur.Fiksimi i astarit ne trupin e xhaketes duhet te behet me kujdes ne menyre te tille qe te rri i shtrire mire dhe pa rrudha duke iu pershtatur pjeseve e xhaketes.Pas fiksimit te astarit behet kthimi dhe palosja e fundit te xhaketes duke pasur kujdes qe astari te mos varet poshte duke dale jashte fundit te saj.Po keshtu dhe per astarin e mengeve.

Jaka eshte e sipërme dhe e poshtme. Jaka e poshtme pregatitet me stof leshi ne ngjyre te erret i cili fiksohet me punim te fshehte dhe sherben per te ruajtur formen e saj.Jaka e sipërme eshte me zonarke dhe pregatitet se bashku me jaken e poshteme.Jaka montohet me kend te drejte me mostren (jaka e gjokseve).Montimi duhet bere me kujdes qe jaka te jete uniforme dhe simetrike. Palosja e jakes duhet te jete e njejte dhe e shtrire mire ne te gjithë gjatesine e saj dhe ti pershtatet sa me mire qafes se perdoruesit.Jaka gjate qepjes ne trupin e xhaketes kalohet 2 here ne hekurosje me prese speciale me avull.

Kujdes duhet bere dhe gjate kthimit dhe hekurosjes se mostres (jaka e gjokseve) ku cepat e saj nuk duhet te dalin te rrumbullaket dhe buzet e mostres te jene te holla dhe pa valezime.Mostra e gjokseve thyhet ne drejtim te kapakut te xhepit te gjoksit duke siguruar keshtu ruajtjen e formes se jakes dhe te mostres.Cepat e mostres duhet te jene simetrike ne te dy anet.Jakes dhe mostres gjate gjithë gjatesise se tyre i kalohet nje tegel zbukurimi **1 mm** larg buzeve.Lart ne jake nga brenda qepet nje etikete e vogel qe tregon numrin me prerjen perkatese te gjoksit te kostumit dhe vendoset dhe nje fitil tekstili qe do sherbeje per te varur xhaketen.

Menget jane te perbera nga pjesa e sipërme dhe pjesa e poshtme.Ne fund te menges nga brenda me hekur vendoset shirit ngjites per thyerjen e menges.Mbyllja e supeve duhet bere ne menyre te atille qe buzet te mos kene rrudha apo vende te ngritura dhe te shtrihen mire.Modeli i mengeve eshte me supe te ngritura.

Menget 10 cm nga buza e tyre pershkohen nga nje shirit i kuq 3-4 mm.

Bashkimi i mengeve. Per bashkimin e mengeve me trupin e xhaketes duhet qe thellesia e rrethit te sqetulles te perputhet me thellesine e menges.Gjate bashkimit te menges ne trupin e xhaketes,per te pasur nje bashkim te forte,te ngritur dhe te harkuar bukur,rreth e qark menges ne pjesen e bashkimit mbi vaten fiksohet nje fitil prej stofi.Bashkimi i mengeve me trupin e

xhaketes duhet te jete simetrik. Bashkimi duhet te behet pa rrudha ne pjesen e sipërme te menges dhe te mos formoje terheqje apo pale ne pjesen e perparme dhe te pasme te saj. Gjate bashkimit te mengeve behet njekohesisht dhe montimi i spalinave.

Në supe vendosen dy ylyqe për montimin e gradave të supit në forme spaletë.

Ylyqet me permasa 4 x 1 cm qepen në mënyrë të tillë që mesi i ylykut të jetë mbi tengelin e bashkimit të shpinës me gjoksin. Ylyku i parë qepet 1 cm nga tengeli i rrethit të mëngës (gavatura). Ylyku i dytë qepet 9 cm nga ylyku i parë.

Ne fund te gjithë ketij procesi xhaketa kalon ne fazat e hekurosjes perfundimtare duke bere kujdes qe te ruhet forma e gjokseve dhe e xhepave.Mbas ketij procesi kalohet ne qepjen e kopsave.

Vrimat dhe kopsat duhen te vendosen ne distancat e percaktuara dhe te korrespondojne me njera-tjetren.Per meshkujt kostumit i hapen kater vrima ne gjoksin e majte dhe ne te djathtin i vendosen kopsat, ndersa per femra kostumit i hapen vrimat ne gjoksin e djathte dhe ne te majtin i vendosen kopsat.

Xhaketa per femra behet me penca ne gjoks per ti dhene nje forme sa me te pershtatshme perpara.

Pantalloni ka dy xhepa te pjerret perpara me fileto stofi me gjeresi **3 mm** dhe nje xhep mbrapa po me filet **3 mm** qe mbyllet me kapak me kopse ebaniti ne ngjyre te zeze. **Sallkia** eshte e me stof dhe fileto astari dhe per mbyllje i fiksohet nje zinxhir plastik me dhembeza te vegjel.**Qemeri** ka **7** (shtate) mbajtese rripi. Mbyllja e pantallonave ne mes realizohet me kapese metalike mashkull – femer dhe me kopse.Ne mes te qemerit nga brenda vendoset etiketa me numrin dhe prerjen perkatese te pantallonit si dhe instruksioni i larjes, i pastrimit, i hekurosjes dhe i perdorimit. Pantalloni eshte me dy penca nga jashte. Xhepat anesore jane me astar permasat e te cilave jepen ne tabelen perkatese.Pantalloni ne dy anesoret ne bashkimin e perparseve me pjesen e prapme te tyre,pershkohet nga shirit i kuq **3 mm**,nga qemeri deri ne fund te pantallonit.

Pantallonit ne fund lihet lisho ose i lihet 5 cm rezerve dhe ne fund te pales i vendoset fortese astari.

Per te qepur pantallonin ne fillim pergatiten pjeset ndihmese si : qemeri,filetot,astaret dhe kapaket e xhepave,mbajteset e rripit dhe sallkia.

Qemeri duhet te pergatitet ne menyre te tille qe te mos rrije as i shtreguar dhe as i lire.Gjeresia e qemerit perpara duhet te jete 4.5 cm ndersa mbrapa 3.5 cm.Qemeri duhet te jete i perforcuar me flieseline dhe nga brenda i qepet astar i posacem per qemer.Qemerit pergjate gjithë gjatesise se tij i kalohet tegel zbukurimi **1 mm** larg buzes ne te dy anet. Qemeri ka **7** (shtate) mbajtese rripi te kthiera te pershkruara me tegela siper **1mm** larg buzes.

Kapaku i xhepit te pasem eshte me maje ne forme trekendeshi.Kapaku perbehet nga pjesa e sipërme dhe e poshtme.Pjeses se sipërme per perforcim i ngjitet flieselina,bashkohen me pjesen e poshtme, kthehet, i qepet astar nga mbrapa,hekuroset dhe i kalohet nje tegel zbukurimi **1mm** larg buzes.Gjate kthimit duhet bere kujdes qe cepat dhe majat e kapakut te mos dalin te rrumbullaket.

Hekurosja perfundimtare e pantallonit duhet bere me kujdes sidomos per formimin e vijes se hekurit ne menyre qe ajo te jete rrije drejt ne mes te kembes.

Pantalloni i femrave ne pamje te jashtme do te jete i njejte me ate te meshkujve por mbyllja e sallkise me zinxhir vendoset ne krah te kundert me ate te pantallonit per meshkuj.

Fundi per femra i drejte dhe me nje te çare nga prapa. Gjatesia 2 – 3 cm poshte gjurit mbyllet ose anash ne te majte ose mbrapa ne mes me kapse metalike mashkull – femer dhe me nje zinzhir plastik 15 cm te gjate te mbuluar nga nje bordure me tegel 1.5 cm larg buzeve. Qemerit eshte 5-5.5 cm i gjere, me 6 (gjashte) mbajtese rripi te kthyera te pershkruara me tegela siper 1mm larg buzes. Qemerit eshte i perforcuar me flieseline dhe nga brenda i qepet astar i posacem per qemer. Qemerit pergjate gjithë gjatesise se tij i kalohet tegel zbukurimi 1 mm larg buzes ne te dy anet. Ne pjesen e poshtme mbrapa fundi ka nje hapje me gjatesi 10–15 cm qe perforcohet me flieseline dhe i kalohet nje tegel zbukurimi 1 mm larg buzes. Tegeli tek hapja lart qepet me pjeresi 45 grade. Ne pjesen fundore te fundit tekstili kthehet 5 cm nga brenda. Nga perpara dhe mbrapa fundi ka nga dy penca (palosje) me thellesi 1.5 cm dhe te mbyllura me tegel 10-15 cm te gjate. Fundi ne dy anesoret, ne bashkimin e perpareseve me pjesen e prapme, pershkohet nga nje shirit i kuq 3 mm, nga qemerit deri ne fund te tij.

Tegelat duhet te jene te forte, uniforme, te mos kene vende te shqepura, te jene simetrike, te rregullt dhe te drejte. Buzet e mbylljeve te brendeshme te behen me syzator me 3 fije dhe te jene te tilla qe te mos krijojne dhe lejojne daljen e fijeve. Tegelat duhet te jene te forte ne menyre te tille qe te mos hapen nen ushtrimin e forces se duarve. Fortesia e tegelave te jete mbi 12 kG. Thellesia e tegelave ne qepje tek pantalloni te jete 1.5 cm. Tegelat duhet te jene te perforcuar ne fund. Peri qe do te perdoret per qepje duhet te jete i forte dhe me ngjyre te erret si ajo e stofit me Nm 80/2 , 100 % PES.

Pantalloni dhe fundi duhet te jene simetrik ne te gjithë elementet e tyre.

KAPELJA :

Ka strehë plastike me ngjyrë të zezë. Për gradën Drejtues madhor, strehës plastike i montohen në pjesën e përparme në gjithë gjatësinë e saj, dy shirita në formë gjethe lisi e punuar me fije ngjyrë ari. Për gradat Drejtues, Drejtues i parë dhe Drejtues i lartë, montohet një shirit në formë gjethe lisi e punuar me fije ngjyre ari. Kapelja në bashkimin e tepelekut me rrethin, përshkohet nga një fileto dekorative me gjerësi 3 mm, me ngjyrë të kuqe.

Drejtues Madhor



Drejtues i Lartë, Drejtues i Parë, Drejtues



Meshkuj



Femra

Për nivelin e mesëm



Meshkuj



Femra

Për nivelin bazë



Meshkuj



Femra

Per procesin e pergatitjes dhe qepjes se kapeles se kostumit nevojiten makina speciale qepjeje dhe puntore te specializuar sidomos per procesin e montimit dhe qepjen e strehes se kapeles. Materialet te cilat duhen te perdoren per ndertimin e kapeles jane:

- **Stof** i njejte me ate te xhaketes e te pantallonit.
- **tel petashuq** shirit çeliku me gjeresi **2 - 3.5 mm** qe vendoset ne brendesi rreth e qark tepelekut
- **shirit plastik** i presuar me vrima per ajrim me gjeresi **5.5 cm** dhe trashesi **1-2 mm** per perforcim si
- **fortese** rreth e qark qemerit
- **shirit** i zi **4.5–5.5 cm** i gjere, material ingeliti me vrima per ajrim qe vendoset rreth e qark qemerit
- **astar** i zi i birosur per ajrim qe vendoset brenda kapeles, poshte tepelekut
- **Material** plastik i pathyshem, per fortese ku do te vendoset emblema
- **strehe** e zeze me lluster me dekoracionin perkates (gjethe lisi) e perforcuar ne brendesi me karton prespan te presuar ose flete PVC e presuar me trashesi **1.5 – 2 mm**

Permasat kryesore te kapeles jepen ne tabelen e meposhteme (ne cm) :

- **A – lartesia e rrethit te kapeles sipas perimetrit te kokes**

B – gjeresia e urave perpara

C – gjeresia e urave mbrapa

D – gjatesia ne qender e tepelekut te kapeles

E – gjeresia ne qender e tepelekut te kapeles

F – gjatesia e shiritit petashuq te celikut qe vendoset perreth tepelekut te kapeles

Nr. kapeles	53	54	55	56	57	58	59	60	61	62	tol. +/- cm
Permasa											
A	4.5	4.5	4.5	4.5	4.5	4.5	4.5	4.5	4.5	4.5	0.1
B	7	7	7	7	7	7	7	7	7	7	0.1
C	4.5	4.5	4.5	4.5	4.5	4.5	4.5	4.5	4.5	4.5	0.1
D	26.5	26.5	27.5	27.5	28	28	28.5	28.5	29	29	0.3
E	25.5	25.5	26	26	27	27	28	28	28.5	28.5	0.3
F	74	75	76	77.5	79	81	83	85	87	89	0.5

Sasia sipas gradave e numerave të kapelëve do bëhet mbi bazën e kerkesave të Gardës me lidhjen e kontratës me prodhuesin.

Kapelja perbehet ne vetevete nga tepeleku, kater urat dhe qemeret. Brenda kapeles nga poshte siperfaqes se stofit te tepelekut vendoset i shtrire mire, astar me vrima (material special) qe ka si veti kryesore lejimin e depertueshmerise se ajrit dhe avujve te kokes te perdoruesit.

Për graden Drejtues Madhor streha plastike ne pjesen e perparme ne gjithë gjatesine e saj ka te qendisur dy shirita ne forme gjethe lisi e punuar me fije me ngjyre ari. Dekoracioni kurore mbeshtetet ne te gjithë gjeresine e strehes se kapeles. Gjeresia e dekoracionit ne ane 1cm, duke u zgjeruar ne qender 2 cm. Ndersa për gradat Drejtues i lartë, Drejtues i parë dhe Drejtues nje shirit ne forme gjethe lisi e punuar me fije, ngjyre ari.

Kapelja ne bashkimin e tepelekut me rrethin, pershkohet nga nje shirit i kuq 3 mm.

Filetoja e tekstilit vendoset e shtrire mire ne menyre te dukshme siper tek tepeleku pergjate gjithë perimetrit te tij dhe ne te dy buzet siper dhe poshte perreth te gjithë perimetrit te qemerit. Urat perpara dhe mbrapa duhet te jene te perforcuara me fortese te kollaritur.

Streha e kapeles te jete me gjeresi ne pjesen e qendres se harkut te saj 56-57 mm, dhe trashesi 2.5-3.5 mm, ne brendesi eshte e perforcuar me karton prespan te presuar ose i flete PVC e presuar me trashesi 1.5 – 2 mm. Ne pjesen e sipërme streha mbulohet me nje flete PVC-je ne ngjyre te zeze te lemuar dhe te shkelqyeshme. Pjesa e perparme e strehes perfundon me nje bordure plastike te perthyer dy here e cila fiksohet me tegel siper dhe poshte deri ne ekstreme. Streha ka forme gjysem hene ku harku i brendshem duhet te jete me rreze 230-240 mm nga e cila del masa 205 mm. Pjesa e perparme ne forme kurbe ne qender te strehes duhet te kete gjeresi 56-57 mm duke iu afruar te dy ekstremeve deri ne piken zero me harkun e pare.

Kopsa

SPECIFIKIM TEKNIK: Kopsa të medha dhe të vogla Garde



E madhe Ø 22 mm



E vogël Ø 1,4 mm

Ofertuesit duhet te paraqesin ne tender detyrimisht mostrat e mesiperme.

Mungesa e mostres eshte kusht skualifikues

1. Pershkrimi.

Kopsat në qendër të tyre kanë te stampuar ne relief shenjën dalluese perkrenaren e Skenderbeut ne profil me pamje nga e djathta, ku shkruhet ne menyre gjysem rrethore me shkronja kapitale “GARDA E REPUBLIKES SE SHQIPERISE”. Ne pjesen rrethuese eshte ne formen e nje shiriti me gjeresi 2 mm.

Trashesia e kopses ne ane eshte 3.5 mm, ne qender eshte 5 mm.

Bishti i kopses eshte i derdhur se bashku me pjesen tjeter te saj me keto dimensione : gjatesi , gjeresi 5mm (+/- 0.3 mm), trashesi 3mm (+/-0.3 mm) dhe me vrime ne mes.

Vrima ti reziztoje forces ne terheqje dhe te jete e zmusuar.

2. Materiali

Kopsat jane te punuara me material metal i lehte ne nje sasi te mjaftueshme ne brendesi te stampave duke realizuar relievet e vendosura dhe te kerkuara mbi kopsa.

Kopsat kalohen ne metalizim ne ngjyre te arte duke ruajtur efektin e punimeve te imta qe kerkon modeli ashtu edhe per ruajtjen dhe shkelqimin e ngjyres nga oksidimet eventuale qe mund te vijne nga agjentet atmosferik, kimik e mekanike.

3. Ngjyrat

Ngjyra e arte pa shkelqim (mat), per te dy tipet e kopsave.

4. Punimi

Nuk lejohet punimi me ngjyrosje apo sprucim.

5.Dimensionet

Kopsa e madhe eshte ne forme te rumbullaket me diameter 2.2 cm.

Kopsa e vogel me diameter 1.4 cm.

PROVA TEKNIKE

Cilesia e kopsave provohet

- Rezistenca ne uje; Zhytet ne uje te distiluar 24 ore ne 25 °C
- Rezistenca ne deterive ; Zhytet 24 ore ne solucion sapuni marseje 3% ne 25 °C.
- Rezistenca ndaj tretësve; Kampionet i kalohen nje shtrese alkool etilik dhe menjehere me pas nje shtrese benzine, te cilet nuk verifikojne humbje te ngjyrave.

Rezistenca ne klorur sode; zhytet kampioni nje ore ne solucion klorur sode 1

Dekoracioni i strehes se kapeles



Për gradat Drejtues madhor

1. Pershkrimi

Element baze jane dekoracioni kuror gjethe lisi ne forme harkore sipas strehes se kapeles. Te gjitha elementet e dekoracionit te kapeles jane qendisura me fije ngjyre ari. Dekoracioni kuror mbeshetet ne te gjithë gjerësinë e strehes se kapeles.

2. Materiali

Tekstil i hollë i qendisur me fill me ngjyre ari.

3. Ngjyrat

Ngjyra e arte. Qendrueshmeria e ngjyres te jete e larte.

4.Dimensionet

Gjeresia e nje dekoracionit ne ane eshte 1cm, duke u zgjeruar ne qender 2 cm. Per graden Gjeneral streha ka dy elemente te tille kurore, te cilat vendosen te ngjitura njera prane tjetres duke mbuluar gjithë strehen e kapeles, ndersa per gradat Major- Kolonel, streha ka nje element te tille kurore.

STEMA E REPUBLIKËS (Shenjë krah)

Lëndët e para e ndihmëse:

Material i hollë e reziztent tekstili i qendisur me penjë sipas ngjyrave të çdo elementi të stemës.

Stemës mbas qendisjes i qepet velkrof mashkull, me të njëjtat permasa , duke e realizuar si një trup të vetem.

Qendrueshmeria e ngjyrave dhe rezistenca në keputje të jete e lartë.

Elementët përbërës të stemës.

Stema është në formen e një mburoje me permasa 7.5 x 6 cm +/-0.1 cm.

Pjesa e sipërme është e drejtë ndërsa e pjesa e poshtme në formë ovale (shqyti). Fusha është në ngjyrë të kuqe në mes të së cilës gjëndet shqiponja dykrenare e qendrisur me penj me ngjyrë të zezë mbi të cilën në qendër vëndoset perkrenarja e Skenderbeut qëndrisur me penj ngjyrë ari, në profil me pamje nga e djathta.

Stema rrethohet me një kornizë qëndrisur me penj ngjyrë ari të vijeziuar me gjeresi 2 mm. Stema në tërësi si dhe gjithë elementët përbërës të saj të jenë rezistente ndaj gjithë faktoreve atmosferike. Po kështu dhe qëndrueshmëria e ngjyrave të jetë shumë e mirë. Stema vëndoset në krahun e majtë me anë të një velkrofi femër- mashkull.



STEMA E GARDËS SË REPUBLIKËS (Shenjë krah)

Lëndët e para e ndihmëse:

Material i hollë e rezistent tekstili i qëndrisur me penjë sipas ngjyrave të çdo elementi të stemës.

Stemës mbas qëndrisjes i qepet velkrof mashkull, me të njëjtat permasa , duke e realizuar si një trup të vetëm.

Qëndrueshmëria e ngjyrave dhe rezistenca në keputje të jete e lartë.

Elementët përbërës të stemës.

Stema është në formën e një mburoje (shqyti) me permasa 7.5cm x 6 cm +/-0.1 cm. Pjesa e sipërme është e drejtë ndërsa e pjesa e poshtme në formë ovale (shqyti).

Stema rrethohet me një kornizë ngjyrë ari, me gjeresi 2 mm, në qendër të saj është vëndosur shqiponja e zezë dykrenare, e përdorur si simbol në krijimin e këtij formacioni. Mbi shqiponjë qëndron perkrenarja e Heroit tonë kombëtar, Skënderbeut, në ngjyrë të artë. Perkrenarja e Skënderbeut është vëndosur në pamje ballore, për të bërë të mundur leximin e shkronjave “BT”, “IN”, duke respektuar semantiken, rregullat dhe stilet araldike të kurorave, e duke bërë më të lexueshme çfarë përfaqëson kjo perkrenare. Ajo i shmanget kopjimit përsëritës të saj, duke e bërë të vecantë për këtë institucion. Në këtë pozicion shikohet karakteri i saj laik e qytetar, fisnik e ushtarak. Emblema eidenton ndërthurjen e madhështisë me bukurinë që paraqet ky element në fushën e sematikës Shqiptare.

Duke qenë se stema shërben edhe si shenjë krah për gardistët në pjesën harkore të shqytit, është shkruar me germa kapitale “GARDA E REPUBLIKËS”.

Stema në tërësi si dhe gjithë elementet përbërës të saj të jenë rezistentë ndaj gjithë faktoreve atmosferike. Po kështu dhe qëndrueshmëria e ngjyrave e copës dhe penjëve të përdorur të jetë shumë e mirë.



ETIKETIMI, AMBALLAZHIMI

Kostumit (kapeles, xhaketes e pantallonit) ne pjesen e brendeshme te tyre u vendoset nga nje etikete e cila duhet te permbaje : nr. i gjoksit, prerjen dhe shenjat konvencionale te trajtimit te stofit ne larje hekurosje, nr. kapeles etj. Te xhaketa etiketa qepet ne pjesen e brendshme te jakes ne qender te saj ku bashkohet me shpinen, te pantalloni ne pjesen e brendshme ku bashkohet qemeri me perpareshen, te kapelja ne pjesen e brendshme te tepelekut. Kostumi kompletohet xhakete dhe dy pale pantallona , vendoset ne varse rrobash(kremastar) dhe futet ne qese transparente plasmasi.

Afati i lëvrimit: Brenda 90 ditëve nga lidhja e kontratës, por jo më vonë se data 20 dhjetor e vitit planifikues.

KOLAUDIMI MARRJA NE DORZIM

Pranimi i të gjithë sasisë të artikullit “Kostum sherbimi” të përcaktuar në kontratë dhe të dorëzuar në magazinën e Gardës, do të bëhet vetëm në bazë të rezultateve që do të merrën gjatë procesit të Kolaudit për të gjithë sasinë e produktit të gatshëm të dorëzuar në magazinë. Kolaudimi do të bëhet mbi bazën e rezultateve të Fletë-analizave laboratorike të lëshuara nga Laboratore te Akredituar te Tekstil-Konfeksioneve, që shoqërojnë mallin, të sjella nga kontraktuesi, sipas përcaktimeve në kontratë, dhe ekzaminimit e të mallit të furnizuar, që do të bëjë “Komisioni i pritjes, kontrollit dhe pranimi të mallit të Gardës së Republikës”, i cili kryen direkt matjet e vlersimet organo-leptike të sasise së mallit të dorëzuar dhe bën krahasimin e të gjithë këtyre rezultateve me kerkesat dhe të dhënat teknike të ketij specifikimi teknik.

Gjithashtu, komisioni nëse e shikon të aryeshme dërgon mostra e kryen analiza laboratorike pranë laboratorëve të akredituar, duke i krahasuar rezultatet e tyre me rezultatet e analizave të sjella nga OE furnizues.

Artikulli konsiderohet teknikisht i pranuar kur ai ploteson te gjitha kerkesat e ketij Specifikimi Teknik.

SPECIFIKIM TEKNIK

OBJEKTI: 2. Kostum sherbimi e stërvitje (1 xhakete, 1palë pantallona, beretë për e 1/2 sasisë së kostumëve, Kapele tip sport për 1/2 e sasisë së kostumëve) për punonjësit e Gardës së Republikës.

Ky specifikim teknik paraqet kërkesat themelore teknike të domosdoshme për prodhimin e artikullit “Kostum sherbimi e stervitje“. Në këtë specifikim teknik përcaktohen gjithashtu dhe

kerkesat teknike të aksesoreve që shoqërojnë artikullin “Kostum sherbimi e stervitje” si produkt i gatshëm .

Të gjitha përcaktimet teknike të këtij specifikimi teknik duhen të zbatohen detyrimisht saktë nga prodhuesi.

Për procedurë vlerësimi dhe miratimi nga perdoruesi, ofertuesi është i detyruar të paraqesi si ofertë teknike të realizuar sipas kërkesave të këtij specifikimi teknik :

- 1 (një) komplet kostumi të përfunduar (xhakete, pantallota, kapele sport dhe beretë,) me nr gjoksi 50.

- 1 (një) pjesë tekstili 50 x50 cm.

- Fletë-analize laboratorike të treguesve fiziko-mekanik e kimik të lëndës së parë të perdorur nga prodhuesi.

Copa e mostrës, lëndës së parë dhe ajo që i bashkengjitet raport-analizes duhet të jenë detyrimisht të njëjta.

Kostumit dhe lëndës së parë u qepet nga një etiketë tekstili të bardhë në të cilën shkruhet: moster “Kostum sherbimi e stervitje”, emri i ofertuesit, data, nënshkrimi dhe vula e ofertuesit.

Mungesa e mostres, lëndës së parë dhe fletë analizes që shoqëron ato është kusht skualifikues.

Treguesit fiziko mekanik.

LËNDA E PARË: Tekstil, ngjyrë e zezë me perzierje (+/-3%): 50 % pambuk, 50 % polyester

MASA: 210 gr/m² (+/-3%).

THURJA: Ripstop (reps i kombinuar me garniturë 1:1)

Dëndësia e fijeve në bazë / cm 45

Dëndësia e fijeve në ind / cm 22

Qëndrushmeria N, në bazë, 1200 N

Qëndrushmeria N, në ind, 700 N

Qëndrushmeria në fërkim, (jo me pak) 20000 cikle.

Qëndrushmeria e ngjyrës ndaj dritës, Shumë e mirë

Në lëndën e parë që duhet të përdoret për konfeksionimin e artikullit “Kostum sherbimi e stervitje ” difekte të përhapura të pamjes së jashtme të cilat detyrimisht nuk lejohen do të konsiderohen: papastërtitë me origjinë bimore, njolla të ndryshme vaji ose boje, tonacione të ngjyrës, oksidime, rrudhosje, mungesë të fijeve në ind e në baze, trashim të fijeve në ind e në bazë, vrima në sipërfaqe, lekundje në gjërësi etj.

M A T E R I A L E T NDIHMESE :

Materialet ndihmëse që duhet të përdoren për prodhimin e artikullit “Kostum sherbimi e stervitje” janë:

- **Astari material,** ngjyrë e zezë me përzierje (+/-3%): 50 % pambuk, 50 % polyester me peshë 80 gr/m²
- **Përforcues (frazelinë adezive)** si material ngjites përforcues special të përshtatshëm për Xhaketen dhe pantallonin.
- **Shirit tekstili i kuq 3 mm secili)** për shiritat e beretës, xhaketes dhe pantollonave sipas specifikimit
- **Astar xhepi** në ngjyrë të zezë, material me përzierje (+/-3%): 50 % pambuk, 50 % polyester me peshë 80 gr/m²
- **Qemer** i përgatitur për pantallonat
- **Kopsa të medha** të zeza ebaniti për xhaketen

- **Kopsa të vogla** të zeza ebaniti
- **Kapse metalike** mashkull –femër për mbylljen e pantallonave
- **Zinxhir** me dhembza plastike 16-18 cm për pantallonin
- **Penj qepje** të zi me Nm 80/2 për qepje industriale me përbërje 100 % PES
- **Materialet** që duhet të përdoren për ndertimin e beretës si : stof leshi, astar i zi me vrima për ajrim

Elementet Velcro femër (me ngjyrë të zezë) për vendosjen:

- **E shenjës së mbiemrit dhe gradës:** Siper në gjoksin e djathtë e të majte, vendoset velkrof femer ne forme drejtekendeshi 8.5 cm x 2.5 cm, për vendosjen e mbiemrit dhe gradës.
- **E Stemes së Republikës dhe Stemes së Gardës,** velkrof femër në mëngë, me permasa 7.5 cm x 6 cm +/-0.1 cm, pjesa e sipërme është e drejtë ndersa e pjesa e poshtme në formë ovale (shqyti) me distancë rreth 7-8 cm nga gavatura e mëngës

Kostumi i sherbimit e stërvitjes, kompletohet me:

- **Steme e Republikës** me velkrof mashkull (sipas specifikimeve të dhëna)
- **Steme Garde** me velkrof mashkull (sipas specifikimeve të dhëna)

Artikulli “Kostum sherbimi e stërvitje” prodhohet në gjashtë gjatësi truperore dhe porositet nga perdoruesi në sasi të perkatese sipas numrave të gjokseve, të cilat subjekti prodhues është i detyruar ti respektojë saktësisht. Përmasat e duhura të elementeve të cilat bëjnë pjesë në ndertimin e artikullit “Kostum sherbimi e stërvitje” jepen në përshkrimet, tabelat dhe figurat e mëposhtme.

Përmasat e produktit të gatshem (cm) jepen në këtë tabelë :

Gjatesia e trupit	Prerja	Iniciali prerjes	Gjatësia e xhaketës produkt i gatshem	Gjatësia e pantallonit produkt i gatshem
155-160	e pare	I	71	93
161-166	e dyte	II	74	97
167-172	e trete	III	77	100
173-178	e katert	IV	80	103
179-184	e peste	V	83	106
185-190	e gjashte	VI	86	110

Kostumet do të jenë të numrave nga nr. 46 deri në nr. 58

Beretat do të jenë të numrave nga 1-3

Sasia sipas numerave do të bëhet mbi bazën e kërkesave të Gardës me lidhjen e kontratës me prodhuesin.

Prodhimi i artikullit “Kostum sherbimi e stërvitje” duhet të realizohet sipas një procesi teknologjik të përcaktuar mbi bazën e kërkesave dhe kushtëve teknologjike të sakta në secilen fazë të realizimit të tij. Prodhimi ndahet në tre faza kryesore të cilat janë :

- përpunimi pergatitor
- konfeksionimi (procesi i qepjes)
- Ambalazhimi,marketimi dhe ektiketimi

Përpunimi pergatitor ka te beje me kolaudimin e lendeve te para dhe ndihmese, skicimin, prerjen ne prestari, marketimin dhe kollaritjen e pjeseve perberse te kostumit.

Konfeksionimi ka te beje me qepjen e pjeseve perberse te kostumit sipas nje procesi linear te percaktuar. Ne faza te ndermjetme te ketij procesi do te kryhet hekurosja dhe presimi me avull i gjysemprodukteve. Ne perfundim kryhet dhe hekurosja e produktit te gatshem.

Ambalazhimi ka te beje me etiketimin, ambalazhimin per cdo produkt dhe ambalazhimin total te gjithe sasise te produktit te gatshem dhe pergatitjen e tij per levrimin drejt magazinave te perdoruesit.

PËRPUNIMI PERGATITOR

Kolaudimi i lëndës së parë dhe materialeve ndihmëse

Kolaudimi i lentes se pare dhe materialeve ndihmese ne menyre te sakte dhe te drejte eshte baze per nje ecuri cilesore te procesve teknologjike te metejshme zinxhir per prodhimin me cilesi te artikullit “Kostum sherbim e stervitje”.

Skicimi

Ky proces duhet te realizohet me metodat matematikore te programimit linear te cilat sigurojne nje shenim te sakte te prerjeve dhe shenjave sipas vizatimeve duke pasur kujdes qe detajet e kostumit duhet te jene ne drejtim te fijeve te bazes.

Prerja

Procesi i prerjes duhet te behet me shume kujdes qe te mos te kete devijime ne fletet e fundit te dyshekut i cili eshte mire qe te mos te kaloje 80 flete. Kujdes duhet te behet dhe ne pjeset e harkuara te detajeve dhe buzet e prera te mos jene me dhembza.

Marketimi

Ky proces eshte shume i rendesishem sepse eliminon qepjen e detajeve te kostumit me tonacione te ndryshme duke siguruar njellojshmeri ne ngjyre te artikullit.

Kollaritja

Detajeve gjysem te gatshme te xhaketes dhe pantallonit ngjitja e frazelinës duhet te behet me prese speciale me avull ne Tem. 130-140 °C, ne kohe 8-10 sek. ne presion 2-3 bar . Ky proces duhet te kryhet sa me i sakte ne menyre qe te mos kete asnje mundesi qe ne objekt te krijohen deformime gjate hekurosjes me avull, larjes dhe lagies nga shiu, te cilat bejne te mundur humbjen e pamjes fillestare. Kollaritja dhe ngjitja nuk lejohet me shtesa. Adezivi nuk duhet të depërtojë në anën tjetër të tekstilit

Frazelina ngjitet ne keto pjese si me poshte: 2 detaje tek kapaket e xhepave pllake te xhakete, 1 detaj tek jaka, 4 detaje tek perforcueset e brylit dhe te supeve, 2 detaje tek qemeri i pantallonit, 4 detaje tek kapaket e xhepave te pantallonit, 1 detaj tek sallkia, 1 detaj tek karshilleku.

- KONFEKSIONIMI

XHAKETA :

Eshte me jake te hapur, ne pjesen e sipërme te gjoksit ka dy xhepa pllake me kapak qe mbyllen me velkrof femer – mashkull, me permasa 16 x 14 cm (+/- 1 cm). Ne krahun e majte te menges 5- 6 cm poshte bashkimit te menges me trupin ne qender te saj ka nje xhep pllake me kapak qe mbyllet me me velkrof femer – mashkull, me permasa 13 x 9 cm (+/- 0.5 cm). Perparset mberthehen me 5 kopsa ne perpareshen e djathte dhe 5 vrimat koresponduese ne sallki ne perpareshen e majte.

Ne pjesen e brendshme te mengeve 18- 20 cm poshte bashkimit te menges me supin vendoset ylyku dhe kopsa per mbajtjen e menges se perveshur (mbledhur). Ne shpatulla pershkohet nga nje fileto e kuqe 3 mm.

Ne supe ka dy spaleta me gjerësi 4.9 cm dhe gjatësi deri në bashkimin me jakën, të cilat në anësore përshkohen nga një shirit i kuq, 3 mm. Po kështu dhe jaka rreth e qark përshkohet nga një shirit i kuq, 3 mm.

Kapakeve të xhëpave i kalohet një tegel zbkurimi 5 mm larg buzës. Duhet bërë kujdes që cepat e kapakut të mos jenë të rrumbullakta por të kenë pamje estetike. Mbi kapakun e xhëpit të djathtë në qender vendoset velkrof femer në ngjyrë të zeze në formë drejtekëndshi me përmasa 8.5 cm x 2.5 cm që do të shërbejë për vendosjen e mbiemrit, ndërsa mbi kapakun e xhëpit të majtë në qender vendoset velkrof femer në formë drejtekëndshi me përmasa 8.5 cm x 2.5 cm për vendosjen e grades.

Gjatësia e kapakeve është sa gjerësia e xhëpave, gjerësia e kapakut të xhëpave të sipërme të xhakës është 6 cm (+/- 0.5 cm), gjerësia e kapakut të xhëpit anësor të krahut është 7 cm (+/- 0.5 cm). Kapaket e xhëpave bëhet pak të harkuar në dy cepat.

Menget 1 cm nga buza, kanë një rrip në formë drejtekëndshi me dimensjone 10 cm x 3 cm të paisur me velkrof femer-mashkull, për shtrengimin e tyre, 6 cm nga buza, menget përshkohen nga një shirit i kuq me gjerësi 3 mm. Menget në berryll behen me fortësi nga i njëjti material.

Xhaketa në pjesën e shpinës (të shpatullave), 10 cm në bashkimin me jakën përshkohet nga një shirit i kuq me gjerësi 3 mm.

Xhaketa në mëngën e djathtë 7-8 cm poshtë qepjes së bashkimit të mëngës me trupin, e matur nga pika me e lartë e supit në qender vendoset me velkrof femer-mashkull, "Stema e Gardes" sipas specifikimeve teknike të saj.

Po kështu në mëngën e majtë të xhakës 7-8 cm poshtë qepjes së bashkimit të mëngës me trupin e matur nga pika me e lartë e supit në qender mbi kapakun e xhëpit anësor, vendoset me velkrof femer-mashkull "Stema e Republikës" sipas specifikimeve teknike të saj.

Bashkimi i mëngëve duhet të bëhet me makinë dygjiplëshe në të cilën përfitohet një tegel dysh zbkurimi. Për të pasur një bashkim të fortë, të ngritur dhe të harkuar bukur të mëngëve me trupin e xhakës, duhet që thellësia e rrethit të sqetullës të përputhet me thellësinë e mëngës. Bashkimi i mëngëve me trupin e xhakës duhet të jetë simetrik. Bashkimi duhet të bëhet pa rrudha në pjesën e sipërme të mëngës dhe të mos formojë terheqje apo pale në pjesën e përparme dhe të pasme të saj.

Mbylljet duhet të realizohen me makinë qepje dygjiplëshe për një fiksion sa më të mirë duke përfituar dhe një tegel dysh zbkurimi. Mbyllja e xhakës fillon me bashkimin anësor të shpinës me gjokset dhe duke vazhduar me mbylljen e mëngëve.

Në perfundim bëhet hapja e vrimave dhe vendosja e kopsave. Vrimat duhet të hapen terthorazi mostres dhe tegeli i tyre duhet të jetë i rregullt dhe pa vende të shqepura. Gjithsej vendosen 5 kopsa ku kopsa e parë vendoset në distancë 12 cm me poshtë nga fillimi i mostres së poshtme dhe 3.5-4 cm nga buza e sipërme e mostres, ndërsa kopsat e tjera vendosen në distancë 10 cm nga njëra tjetra. Për meshkujt xhakës i hapen vrimat në gjoksin e majtë dhe në të djathtin i vendosen kopsat, ndërsa për femrat vrimat hapen në gjoksin e djathtë dhe në të majtën i vendosen kopsat. Xhaketa për femrat bëhet me penca në gjoks për të dhënë një formë sa më të përshtatshme përpara.

PANTALLONAT :

Pantallonat, janë me dy pensa (pala) përpara, dy xhepa të pjerrët në anësore dhe 2 xhepa pllakë prapa me kapak. Pantallonat në pjesën anësore të këmbës, kanë dy xhepa pllakë me kapak. Pantallonat në pjesën e gjunjëve dhe të ndenjurrave bëhen me fortësi nga i njëjti material. Pantallonat në dy anësoret, në bashkimin e përparësive me pjesën e prapme të tyre, nga qëmeri deri në fund të pantallonit, përshkohen nga fileto e kuqe 3 mm.

Pjesët përbërëse të pantallonave:

- Qemeri
- Dy pjesët e këmbëve
- Dy xhepat e përparmë
- Dy xhepat e këmbëve
- Dy xhepat e pasmë
- Dy arnat për gjunjë
- Arna në pjesën e vitheve

Këmbët e pantallonave duhet të ndërtohen me katër pjesë: dy pjesët e përparme dhe dy pjesët e pasme.

Bashkimi i këmbëve të pantallonave duhet të bëhen me anë të një tegeli linear një gjilpërësh të profiluar me tegel syzator katër gjilpërësh (syzator 3 gjilpërësh + një tegel linear). Bashkimi anësor i jashtëm, i brendshëm dhe bashkimi qendror duhet të përshkohen dhe me anë të një tegeli linear dy gjilpërësh sipërfaqësor.

Këmbët duhet përfundojnë me një palosje të brendshme 2 cm të qepur me tegel linear një gjilpërësh me distancë 2 cm nga buza.

Pantalloni në fund qepet me tegel të thjeshtë makine dhe përshkohet nga një fjongo prej të njëjtit material për shtrengimin e këmbeve për mos daljen e pantallonave nga kepuca.

Ylyqet. Pantallonat duhet të kenë 6 ylyqe me gjatësi 6.5 cm dhe gjerësi 2.5 cm: dy përpara dhe katër mbrapa. Ylyqet e përparme duhet të vendosen të baraslarguar nga xhepat anësorë në një distancë prej 2 □3 cm, sipas masës. Ylyqet e pasme gjithashtu duhet të vendosen të baraslarguara nga njëra tjetra, sipas masës.

Ylyqet duhet të përbëhen nga një shtresë tekstili ngjyrë si pantallonat e palosur më dysh, të përforcuar nga brenda me frazeline.

Ylyqet duhet të përshkohen nga dy tegela dy gjilpërësh gjatësorë me distancë 6 mm nga njëri tjetri dhe dy tegela linearë një gjilpërësh me distancë 2 mm nga buza e poshtme dhe e sipërme. Tegelat gjatësorë duhet të përforcohen me traveta tek ekstremitetet. Tegelat duhet të jenë të gjithë sipërfaqësorë.

Kopsat duhet të jenë Nr. 34 (21 mm) me ngjyrë zezë. Qepja e kopsave duhet të bëhet kryq. Një kopsë rezervë duhet të qepet në pjesën e brendshme të qemerit, në anën e majtë.

Arnat përforcuese të gjunjëve duhet të jenë prej të njëjtit tekstil si pantallonat. Ato duhet të kenë formë trapezi dhe përmasat e tyre duhet të ndryshojnë në varësi të masës së pantallonave.

Buza e sipërme dhe e poshtme e arnës duhet të jenë të qepura me tegela linearë dy gjilpërësh sipërfaqësorë me distancë 2 dhe 8 mm nga buza. Buzët anësore të arnës duhet të qepen në tegelat qepës anësorë të pantallonave.

Arnat përforcuese të vitheve duhet të qepen në zonën e poshtme të vitheve. Ato duhet të jenë prej të njëjtit tekstil si pantallonat.

Arnat duhet të kenë formë gjysmë elipsi dhe përmasat e tyre duhet të ndryshojnë sipas masës së pantallonave. Qendrat e elipseve duhet të jetë tek pika ku bashkohen katër pjesët e këmbëve.

Anët e harkuara të arnave duhet të jenë të qepura tek pantallonat me tegel linear dy gjilpërësh me distancë 2 dhe 8 mm nga buza.

Anët e drejta (të brendshme) duhet të qepen bashkë me tegelat bashkues anësorë dhe qendror. Tegelat sipërfaqësorë përcaktojnë edhe thellësinë e palosjes së brendshme të tekstilit.

Mbyllja e pantallonave në mes realizohet me dy kopse. Në mes të qemerit nga brenda vendoset etiketa me numrin dhe prerjen perkatese të pantallonit si dhe instruksioni i larjes, i pastrimit, i hekurosjes dhe i përdorimit. Për të qepur pantallonin në fillim përgatiten pjesët

ndihmese si : mbajteset e rripit, qemeri, xhepat, kapaket e xhepave, astaret e xhepave dhe sallkia. Pantalloni duhet te dorezohet me funde te perfunduara.

Qemeri duhet te pergatitet ne menyre te tille qe te mos rrije as i shtreguar dhe as i lire. Gjeresia e qemerit perpara duhet te jete 5 cm. Qemeri duhet te jete i perforcuar me flieseline dhe nga brenda i qepet astar i posacem per qemer. Qemerit pergjate gjithë gjatesise ne te dy anet e tij i kalohet nga nje tegel dysh zburimi.

Mbylljet (tegelat) e pantallonit duhet te realizohen me makine qepje dygjilpershe.

Hekurosja perfundimtare e pantallonit duhet bere me qellim eleminimin e rudhosjeve.

Mbylljet tek xhaketa dhe pantalloni duhet te realizohen me makine qepje dygjilpershe. Tegelat duhet jene te forte ne menyre te tille qe te mos hapen nen ushtrimin e forces se duarve. Fortesia e tegelave te jete mbi 12 kG. Tegelat duhet te jene te perforcuar ne fund. Peri qe do te perdoret per qepje duhet te jete i forte dhe me ngjyre te zeze me Nm 80/2 , 100 % PES.

Xhepat e përparmë

Pantallonat duhet të pajisen me dy xhepa të përparmë diagonalë. Hapja e xhepit duhet të fillojë poshtë qemerit, në një distancë 5 cm nga tegeli anësor i pantallonave dhe të përfundojë po tek tegeli anësor.

Xhepat duhet të jenë 17 cm e gjatë. Ato duhet të përforcohen në të dy ekstremitetet e tyre me traveta.

Xhepat duhet të përshkohen gjatë gjithë gjatësisë nga një tegel linear dy gjilpërësh me distancë 2 mm dhe 8 mm nga buza. Në pjesën e dukshme (mostra) xhepat duhet të jenë të veshur me tekstil të njëjtë me pantallonat.

Astari i xhepave duhet të ketë përmasa 30 x 16 cm.

Xhepat e këmbëve

Pantallonat duhet të pajisen me dy xhepa me kapak me elementë *velcro*, palë të puthitur dhe tegel sipërfaqësor linear dy gjilpërësh.

Xhepat dhe kapakët duhet të kenë formë drejtkëndore të rregullt. Përmasat e xhepave duhet të jenë 23 x 22 cm, ndërsa përmasat e kapakëve të xhepave duhet të jenë 22.5 x 7 cm. Pala e xhepave duhet të jetë e tipit e puthitur: palë e dyanshme e përmbysur dhe e kufizuar me traveta. Përmasat e palës duhet të jenë 23 x 4 cm.

Hapja e palës nga jashtë duhet të jetë vetëm 14 cm e gjatë dhe e përforcuar me traveta horizontale tek ekstremitetet. Traveta e poshtme duhet të qepet në distancë 3 cm nga buza e poshtme, ndërsa traveta e sipërme duhet të qepet në distancë 6 cm nga buza e sipërme. Pjesa tjetër e hapjes së palës duhet të jetë e qepur.

Xhepat duhet të përshkohen në pjesën e sipërme nga një tegel linear një gjilpërësh me distancë 2.5 cm nga buza dhe të qepen në pantallona me anë të një tegeli sipërfaqësor linear dy gjilpërësh me distancë 2 mm dhe 8 mm nga buzët. Tek buza e sipërme, tegeli duhet të përforcohet me traveta.

Kapakët e xhepave duhet të përbëhen nga dy shtresa tekstili me përmasa të njëjta të përforcuara në brendësi me frazelinë termoadezive. Shtresa përforcuese prej frazelinë termoadezive duhet të bashkohet me shtresën e sipërme në tranxhë me avull të nxehtë.

Shtresat e kapakut duhet të bashkohet me njera-tjetrën me tegel sipërfaqësor linear dy gjilpërësh. Tegeli i sipërm duhet të bëjë qepjen e kapakut tek këmbët. Ai duhet të përforcohet edhe me dy traveta kryq në secilin ekstremitet.

Xhepat duhet të pozicionohen në anën e jashtme të kofshëve, sipër gjurit, ndërsa kapakët e xhepave duhet të qepen në një distancë rreth 2.5 cm mbi xhepa.

Mbyllja e kapakëve duhet të bëhet me anë të dy elementëve *velcro* mashkull/femër me përmasa 2 x 2.5 cm. Elementët *velcro* duhet të vendosen në dy cepat e xhepave, brenda tegelit perimetral

Pantallonat duhet të pajisen me dy xhepa të pasmë me fileto, kapak dhe mbyllje me elementë *velcro*, të pozicionuar rreth 5.5 cm poshtë qemerit. Kapakët dhe filetот duhet të përforcohen me frazelinë termoadezive.

Kapakët e xhepave duhet të kenë përmasa 14.5 cm x 5 cm, ndërsa filetot duhet të kenë përmasa 14.5 x 1.5 cm.


Kapakët duhet të përshkohet nga tre anët e lira me tegela perimetralë linearë dy gjilpërësh sipërfaqësorë me distancë 2 dhe 8 mm nga buzët, ndërsa rreth e përçark filetove, në një distancë prej 1 mm nga buza, duhet të qepet një tegel linear një gjilpërësh sipërfaqësor.

Mbyllja e kapakëve duhet të bëhet me anë të dy elementëve *velcro* mashkull/femër me përmasa 2.5 x 2 cm. Elementët *velcro* duhet të vendosen në dy cepat e xhepave, brenda tegelit perimetral.

Sallkia duhet të ndërtohet me dy pjesë: pjesa e mbuluar dhe kapaku i zinxhirit. Të dyja pjesët duhet të jenë prej tekstili të njëjtë si pantallonat.

Shtresa e dukshme e pjesës së mbuluar dhe shtresa e padukshme e kapakut duhet të jenë të përforcuara me frazelinë termoadezive.

Zinxhiri i sallkisë. Gjatësia e zinxhirit mund të ndryshojë sipas masave, nga 16 □ 18 cm. Zinxhiri duhet të jetë me fiksion tek koka në mënyrë që të mos hapet vetë gjatë përdorimit. Ngjyra e zinxhirit duhet të jetë e zezë.



BERETA: është material 100% lesh me trashësi 2-3mm, ngjyre e zeze, bereta përbehet nga pjesa e sipërme ose tepeleku dhe rrethi, rrethi përforcohet me një cope të holle inkeliti, për mos depertimin e djersës, brenda se cilit kalon një fill që shërben për rregullimin e perimetrit të rrethit të beretes. Tepeleku përbehet nga dy pjesë, suprina dhe astari. Pjesa e brendshme e beretes vishet me astar të zi. Në krahun e djathtë në pjesën e rrethit ka një fortësë plastike për vendosjen e emblemes.

KAPELJA TIP SPORTIVE: Është prej të njëjtit material si i kostumit e përbëhet nga kupola, streha dhe mekanizmi shtërngues. Kupola ndërtohet nga një pjesë trekëndore, pjesa balllore përforcohet me teksitl të kollarisur. Kapela në pjesën e pasme pajiset me rrip shtërngues. Streha përbëhet nga shtresa e harkuar plastike e cila vishet me shtresë tekstili si të kapelës nëpërmjet disa tengelave linear.



Velkrofet - Velkrofet femer te krahut jane me ngjyre te zeze ne forme parzmore me permasa 60 mm gjeresi dhe 75 mm gjatesi i cili qepet me tegel dysh ne qender te menges se majte dhe te djathte, me ulje 7 - 8 cm nga maja e supit. Sherbejne per fiksimin e “Stemes te Gardes” dhe te “Stemes te Republikes”.

Velkrof femer, me ngjyre te zeze ne forme drejtekendshi me permasa 2.5 cm gjeresi, 8,5 cm gjatesi, per vendosjen e mbiemrit, qepet me tegel dysh mbi kapakun e xhepit te djathte, nje tjeter velkrof femer ne ngjyre te zeze ne forme drejtekendshi me permasa 2.5 cm gjeresi dhe 8,5 cm gjatesi, per vendosjen e gradave te gjoksit, i cili qepet me tegel dysh mbi kapakun e xhepit te majte.

Elementëve *velcro* mashkull/femër me përmasa 2 x 2.5 cm për mbylljen e kapakëve të xhepave.

STEMA E REPUBLIKËS (Shenjë krahu)

Lëndët e para e ndihmëse:

Material i hollë e reziztent tekstili i qendisur me penjë sipas ngjyrave të çdo elementi të stemës.

Stemës mbas qendisjes i qepet velkrof mashkull, me të njejtat permasa , duke e realizuar si një trup të vetem.

Qendrueshmeria e ngjyrave dhe rezistenca në keputje të jete e lartë.

Elementët përbërës të stemës.

Stema është në formen e një mburoje me permasa 7.5 x 6 cm +/-0.1 cm.

Pjesa e sipërme është e drejtë ndersa e pjesa e poshtme në formë ovale (shqyti). Fusha është në ngjyrë të kuqe në mes të së cilës gjëndet shqiponja dykrenare e qendisur me penj me ngjyrë të zezë mbi të cilën në qendër vëndoset perkrenarja e Skenderbeut qëndisur me penj ngjyrë ari,në profil me pamje nga e djathta.

Stema rrethohet me një kornizë qendisur me penj ngjyrë ari të vijeuar me gjeresi 2 mm. Stema në tërësi si dhe gjithë elementët përbërës të saj të jenë rezistente ndaj gjithë faktoreve atmosferike. Po kështu dhe qendrueshmeria e ngjyrave të jetë shumë e mirë. Stema vendoset në krahun e majtë me anë të një velkrofi femer- mashkull.



STEMA E GARDËS SË REPUBLIKËS (Shenjë krahu)

Lëndët e para e ndihmëse:

Material i hollë e rezistent tekstili i qendisur me penjë sipas ngjyrave të çdo elementi të stemës.

Stemës mbas qendisjes i qepet velkrof mashkull, me të njejtat permasa , duke e realizuar si një trup të vetëm.

Qendrueshmeria e ngjyrave dhe rezistenca në keputje të jete e lartë.

Elementët përbërës të stemës.

Stema është në formën e një mburoje (shqyti) me permasa 7.5cm x 6 cm +/-0.1 cm. Pjesa e sipërme është e drejtë ndersa e pjesa e poshtme në forme ovale (shqyti).

Stema rrethohet me një kornizë ngjyrë ari, me gjëresi 2 mm, në qendër të saj është vendosur shqiponja e zezë dykrenare, e përdorur si simbol në krijimin e këtij formacioni. Mbi shqiponjë qëndron përkrenarja e Heroit tonë kombëtar, Skënderbeut, në ngjyrë të artë. Përkrenarja e Skënderbeut është vendosur në pamje ballore, për të bërë të mundur leximin e shkronjave “BT”, ”IN”, duke respektuar semantiken, rregullat dhe stilet araldike të kurorave, e duke bërë më të lexueshme çfarë përfaqëson kjo përkrenare. Ajo i shmanget kopjimit përsëritës të saj, duke e bërë të vecantë për këtë institucion. Në këtë pozicion shikohet karakteri i saj laik e qytetar, fisnik e ushtarak. Emblema evidenton ndërthurjen e madhështisë me bukurinë që paraqet ky element në fushën e sematikës Shqiptare.

Duke qenë se stema shërben edhe si shenjë krahu për gardistët në pjesën harkore të shqytit, është shkruar me gërma kapitale “GARDA E REPUBLIKËS”.

Stema në teresi si dhe gjithë elementet përbërës të saj të jenë rezistentë ndaj gjithë faktoreve atmosferike. Po kështu dhe qendrueshmeria e ngjyrave e copës dhe penjëve të përdorur të jetë shumë e mirë.



ETIKETIMI, AMBALLAZHIMI

Kostumit(beretes, xhaketes e pantallonit) ne pjesen e brendeshme te tyre u vendoset nga nje etikete e cila duhet te permbaje : nr. i gjoksit, prerjen dhe shenjat konvencionale te trajtimit ne larje hekurosje, nr. kapeles etj. Te xhaketa etiketa qepet ne pjesen e brendshme te jakes ne qender te saj ku bashkohet me shpinen, te pantalloni ne pjesen e brendshme ku bashkohet qemerit me perpresen, te kapelja ne pjesen e brendshme te tepeleku.

Kostumi kompletohet xhakete dhe nje pale pantallona, futen ne qese transparente plasmasi. Kostumet e paketuara futen ne kuti kartoni nga 30 cope kostume. Ne çdo kuti duhet te vendosen kostume te nje numri dhe fraksioni prerje. Te gjitha kutite duhet te kene te njejtin numer kostumesh. Kutite duhet te jene te rregullta dhe te shiritizohen duke siguruar mbyllje te mire. Mbi kutite vendosen etiketa ku shenohet qarte: emri i firmes prodhuese me vulen perkatese, numri dhe fraksioni i prerjes se kostumit, sasia dhe viti i prodhimit.

Transporti i artikullit deri ne magazinat e porositesit behet me çdo lloj mjeti, duke mbajtur parasysh kushtet klimaterike dhe temperaturat. Mjeti duhet te jete i mbuluar.

Afati i lëvrimit: Brenda 90 ditëve nga lidhja e kontratës, por jo më vonë se data 20 dhjetor e vitit planifikues.

KOLAUDIMI MARRJA NE DORZIM

Pranimi i te gjithë sasisë të artikullit “Kostum sherbimi e stervitje” të përcaktuar në kontratë dhe të dorëzuar në magazinën e Gardës, do të bëhet vetëm në bazë të rezultateve që do të marrën gjatë procesit të Kolaudit për të gjithë sasinë e produktit të gatshëm të dorëzuar në magazinë. Kolaudi do të bëhet mbi bazën e rezultateve të Fletë-analizave laboratorike të lëshuara nga Laboratore të Akredituar të Tekstil-Konfeksioneve, që shoqërojnë mallin, të sjella nga kontraktuesi, sipas përcaktimeve në kontratë, dhe ekzaminimit të mallit të furnizuar, që do të bëjë “Komisioni i pritjes, kontrollit dhe pranimit të mallit të Gardës së Republikës”, i cili kryen direkt matjet e vlersimet organo-leptike të sasisë së mallit të dorëzuar dhe bën krahasimin e të gjithë këtyre rezultateve me kërkesat dhe të dhënat teknike të këtij specifikimi teknik.

Gjithashtu, komisioni nëse e shikon të aryeshme dërgon mostra e kryen analiza laboratorike pranë laboratorëve të akredituar, duke i krahasuar rezultatet e tyre me rezultatet e analizave të sjella nga OE furnizues.

Artikulli konsiderohet teknikisht i pranuar kur ai ploteson të gjitha kërkesat e këtij Specifikimi Teknik.

SPECIFIKIM TEKNIK

OBJEKTI: 3. “Xhup $\frac{3}{4}$ me veshje të ngrohtë” për punonjësit e Gardës së Republikës.

Ky specifikim teknik paraqet kërkesat themelore teknike të domosdoshme për prodhimin e artikullit “Xhup $\frac{3}{4}$ me veshje të ngrohtë”. Në këtë specifikim teknik përcaktohen gjithashtu dhe kërkesat teknike të aksesoreve që shoqërojnë artikullin “Xhup $\frac{3}{4}$ me veshje të ngrohtë” si produkt i gatshëm duke realizuar kompletimin e plotë të tyre.

Të gjitha përcaktimet teknike të këtij specifikimi teknik duhen të zbatohen detyrimisht saktë nga prodhuesi.

Për procedurë vlerësimi dhe miratimi nga përdoruesi, pjesëmarresi prodhues konkurues është i detyruar të paraqes si ofertë teknike të realizuar sipas kërkesave të këtij specifikimi teknik:

- 1 (një) copë “Xhup $\frac{3}{4}$ me veshje të ngrohtë” me nr gjoksi 50.
- 1 (një) pjesë pelhure impermeable gjatesi 0,5 ml, gjërësi sa ajo e vetë pelhurës impermeable.
- Fletë-analizë laboratorike të treguesve fiziko-mekanik e kimik të lëndës së parë të përdorur nga prodhuesi.

Copa e Xhupit moster, lëndës së parë (pelhurë impermeable) që shoqëron atë dhe ajo që i bashkëngjitet raport-analizës duhet të jenë detyrimisht të njëjta.

Xhupit $\frac{3}{4}$ dhe lëndës së parë, u qepet me tegel makine nga një etikete tekstili e bardhë, me permasa të përafërta 10 x10 cm, në të cilën shkruhet: moster “Xhup $\frac{3}{4}$ me veshje të ngrohtë”, emri i ofertuesit, data e tenderit, nënshkrimi dhe vula e ofertuesit.

Mungesa e mostres, lëndës së parë dhe fletë analizës që shoqëron ato, është kusht skualifikues.

LENDË E PARË : Pelhure impermeable (tekstil i gomuar) ngjyre e zezë 100 % poliester.

- Masa: 240-260 gr/m² (± 3%)

- Thurrja:	Garniturë.
- Hollesia e fijeve:	Filament
- Dëndësia e fijeve në 10 cm:	Në bazë 480+/-10 ne ind 330 +/- 10.
- Qëndrueshmeria në kg:	Në bazë 111 +/- 3 ne ind 74 +/-3.
- Qëndrueshmeria e ngjyrës:	Shumë e mirë

MATERIALET NDIHMËSE që duhet të përdorën për ndertimin e artikullit “Xhup $\frac{3}{4}$ me veshje të ngrohtë” janë:

- **Astar** mendafshi me ngjyrë të zezë me perberje 100 % PES
- **Veshje** e ngrotë vatin e thurur në dy krahët me astar mendafshi ngjyrë e zezë
- **Vatine** me ngjyrë të bardhë me peshë 120 g/m².
- **Zinxhir për mbylljen e xhupit** - Standard, me fund të hapur, me rezistencë maksimale ndaj ujit, dhëmbët 100% acetal, madhësia e dhëmbëzave 8 VS ose 10VF, shiriti prej tekstili 100% polyester, me ngjyrë të zezë.
- **Zinxhir me fund të hapur, për montimin dhe çmontimin e veshjes** se ngrohte - Standard, me dhëmbë spirale, me fund të hapur, për aplikime në linja të harkuara dhe me dy koka, madhësia e dhëmbëzave 4 CF ose 5 CF, dhëmbët 100% poliester monofilament, shiriti prej tekstili 100% polyester, ngjyra e zezë.
- **Zinxhir** për montimin e kapucit - Standard, me fund të mbyllur, madhësia e dhëmbëzave 4 CF ose 5 CF, dhëmbët 100% poliester monofilament, shiriti prej tekstili 100% poliester ngjyra e zezë.
- **Flieseline** teroadezive perforcues special të pershtatshëm për elementet e xhupit me përbërje 100 % PES
- **Kordon** me ngjyrë të zezë methurje gershet me fiksuese plastike në fund
- **Astar xhepi** në ngjyrë të errët
- **Butona** metalike mashkull - femer në ngjyrë të zezë .
- **Penj qepje** të zi Nm 80/2 për qepje industriale me përbërje 100 % PES

Elementet Velcro femer (me ngjyrë të zezë) për vendosjen:

- **E shenjës së mbiemrit dhe gradës:** Siper në gjoksin e djathtë e të majtë vendoset velkrof femër 8.5 cm x 2.5 cm, në formë drejtëkëndeshi, për vendosjen e mbiemrit dhe gradës.
- **E Stemes së Republikës dhe Stemes së Gardës,** velkrof femer në mëngë, me permasa 7.5 cm x 6 cm +/-0.1 cm, pjesa e sipërme është e drejtë ndërsa e pjesa e poshtme në formë ovale (shqyti) me distancë rreth 7-8 cm nga gavatura e mëngës.

Xhupit $\frac{3}{4}$ me veshje të ngrohtë, kompletohet me:

- **Steme e Republikës** me velkrof mashkull (sipas specifikimeve të dhëna)
- **Steme Garde** me velkrof mashkull (sipas specifikimeve të dhëna)

Për vertetësinë e të dhënave teknike të kërkuara në këtë Specifikim Teknik dhe të deklaruara nga subjekti ofertues me anë të mostrave fizike të shoqëruar me Flet-analizen e leshuar nga Laboratori përkatës i tekstil-konfeksioneve, komisioni i vlerësimit të ofertave, ka të drejtë që të verifikojë menjëherë ato. Mos perputhja e treguesve të lëndës së I-rë dhe të materialeve ndihmëse të Specifikimit Teknik me treguesit e lëndës së I-rë dhe të materialeve ndihmëse të përdorura për ndertimin e artikullit “Xhup $\frac{3}{4}$ me veshje të ngrohtë” të ofruara nga pjesëmarrësi në procedurën e vlerësimit me ato të depozituara në Laboratorin përkatës të tekstil-konfeksioneve përbën dhe konsiderohet kusht skualifikimi për vazhdimin e procedurave.

QEPJA:

Jaka e “Xhupit $\frac{3}{4}$ sintetik me veshje të ngrohtë”, është në formë rrethore me lartësi rreth 10 cm.

Mbyllja e xhupit bëhet me zinxhire në sallki dhe 7 butona (2 në pjesën e jakës e 5 në pjesën e trupit), të mbuluar me bordurë. Dy perpareset në pjesën e poshtme kanë nga një xhep të pjerret me dy tegela sipër. Në pjesën e gjoksit deri në pjesën e sipërme të xhepave të poshtëm qepen dy xhepa të drejtë me gjërësi 7-7.5 cm, të cilëve u kalohen dy tegela sipër. Po kështu në mes të gjatësisë së tyre kalon një tegel.

Në gjoksin e djathtë në qender mbi supanje vendoset velkrof femër në ngjyrë të zezë në formë drejtekendshi me permasa 8.5 cm x 2.5 cm, që do të shërbejë për vendosjen e mbiemrit, ndërsa në krahun e majtë në qender mbi supanje vendoset velkrof femër në formë drejtekendshi me permasa 8.5 cm x 2.5 cm për vendosjen e gradës.

Shpina është dy copeshe me qepje në mes dhe dy tegela. Në pjesën e sipërme të shpines dhe perparseve vendoset supanje e lire e cila qepet në gjithë perimetrin e saj në thellesi 1.5 cm nga buza duke krijuar bordurë.

Xhupi, në mëngën e djathtë, 7-8 cm poshtë qepjes së bashkimit të mëngës me trupin e matur nga pika me e lartë e supit në qendër vendoset me velkrof femër-mashkull “Stema e Gardes” sipas specifikimeve teknike të saj. Po kështu në mëngën e majtë të xhupit 7-8 cm poshtë qepjes së bashkimit të mëngës me trupin e matur nga pika me e lartë e supit në qendër vendoset me velkrof femër-mashkull “Stema e Republikës” sipas specifikimeve teknike të saj.

Në supë ka dy spaleta me gjërësi 5 cm dhe gjatësi deri në bashkimin me jakën. Spalinat përbehen nga pjesa e sipërme dhe e poshtme të cilave për forcim iu vendoset ekstrafor (flieseline). Spalines 5 mm larg buzëve i kalohet një tegel dysh zbulurimi. Montimi i spalinave në supë duhet të bëhet në mënyrë të tillë që mesi i spalines të perputhet me tegelin e bashkimit të shpines me gjoksin.

Mëngët janë një copeshe, në qepjen e saj dhe 3 - 4 cm nga fundi i mëngës qepet një spaline me gjërësi 5 cm për ngushtimin e mëngës e cila mberthehet me 2 butona mashkull-femër ngjyrë të zezë.

Përparesa e majtë ka një xhep me fileto me yll dhe kopse të vogël të zezë. Gjithë pjesa e brendshme e xhupit perpareset, shpina, mëngët janë të veshura me astar mendafshi ngjyrë të zezë me vatin 150-180 gr/m² e nderthurur në formë rombi. Në mes të belit në të dy anët në bashkimet e perparseve me shpinën qepet nga një yll 4.5 – 5 cm për kalimin e rripit i cili qepet prej të njejtë material si xhupi. Rripi është me togez ngjyrë të zezë, i gjërë 4 +/-0.2 cm e gjatësi 160 – 170 cm përshkohet nga dy tegela në të dy anët.

Veshja e ngrohtë e brendshme, është vatin e thurur në dy krahët, me astar ngjyrë të zezë, përbëhet nga pjesa e shpines dhe e gjokseve. Veshja e ngrohtë duhet të jetë e vendosur në të gjithë sipërfaqen e brendshme të shpines dhe të gjokseve. Sipërfaqja e veshjes së ngrohtë duhet të perputhet me sipërfaqen e shpines dhe të gjokseve. Fiksimi i veshjes së ngrohtë me trupin e xhupit duhet të bëhet me ane të zinxhirit që fiksohet nga brenda përgjatë gjithë gjatësisë së mostres gjoksit të majtë duke vazhduar lart në pjesën e qafës dhe me pas zbrit poshtë deri në fund nga brenda përgjate gjithë gjatësië së mostres të gjoksit të djathtë. Gjatësia e veshjes së ngrohtë duhet të jetë 8-10 cm me e vogël se gjatësia e shpines dhe e gjokseve të xhupit.

Xhupi kompletohet me **kapuç** prej të njejtë material si i xhupit, i cili montohet me zinxir konfeksioni në bashkimin e jakës me trupin. Kapuçi në pjesën fundore në brendësi, përgjatë gjithë gjatësië përshkohet nga një kordon me ngjyrë të zezë me thurje gershet me fiksues plastikë në fund, për mbylljen e kapuçit sipas nevojës.

“Xhup $\frac{3}{4}$ me veshje të ngrohtë” duhet të jetë simetrik në të gjithë elementet përbërës të tij.

“Xhup $\frac{3}{4}$ me veshje të ngrohtë” është i njëjte ne model si per meshkuj ashtu dhe per femra.

Tegelat e qepjes duhet te jene te forte, uniforme, te mos kene vende te shqepura, te jene simetrike, te rregullt dhe te drejte. Buzet e tegelave te brendshem te detajeve perberese te xhupit duhet te behen me syzator qe te mos krijojne dhe lejojne daljen e fijeve. Mbylljet e xhupit duhet te realizohen me syzator. Tegelat duhet jene të fortë në menyrë të tillë që të mos hapen nën ushtrimin e forces së duarve.

Xhupat te jene numrave 44 – 56.

Sasia sipas numerave do bëhët mbi bazën e kerkesave të Gardës me lidhjen e kontratës me prodhuesin.

Permasat e “Xhup $\frac{3}{4}$ me veshje të ngrohtë” si produkt i gatshem (cm) jepen në këtë tabelë :

Gjatesia e trupit	Prerja	Iniciali prerjes	Gjatesia e xhupit produkt i gatshem
155-160	e pare	I	82
161-166	e dyte	II	84
167-172	e trete	III	88
173-178	e katert	IV	92
179-184	e peste	V	96
185-190	e gjashte	VI	100

STEMA E REPUBLIKËS (Shenjë krahu)

Lëndët e para e ndihmëse:

Material i hollë e reziztent tekstili i qendisur me penjë sipas ngjyrave të çdo elementi të stemës.

Stemës mbas qendisjes i qepet velkrof mashkull, me të njëjtat permasa , duke e realizuar si një trup të vetem.

Qendrueshmeria e ngjyrave dhe rezistenca në keputje të jete e lartë.

Elementët përbërës të stemës.

Stema është në formen e një mburoje me permasa 7.5 x 6 cm +/-0.1 cm.

Pjesa e sipërme është e drejtë ndersa e pjesa e poshtme në formë ovale (shqyti). Fusha është në ngjyrë të kuqe në mes të së cilës gjëndet shqiponja dykrenare e qendisur me penj me ngjyrë të zezë mbi të cilën në qendër vëndoset perkrenarja e Skenderbeut qëndisur me penj ngjyrë ari,në profil me pamje nga e djathta.

Stema rrethohet me një kornizë qendisur me penj ngjyrë ari të vijeuar me gjerësi 2 mm. Stema në terësi si dhe gjithë elementët përbërës të saj të jenë rezistente ndaj gjithë faktoreve atmosferike. Po kështu dhe qendrueshmeria e ngjyrave të jetë shumë e mirë. Stema vendoset në krahun e majtë me anë të një velkrofi femer- mashkull.



STEMA E GARDËS SË REPUBLIKËS (Shenjë krahu)

Lëndët e para e ndihmëse:

Material i hollë e reziztent tekstili i qendisur me penjë sipas ngjyrave të çdo elementi të stemës.

Stemës mbas qendisjes i qepet velkrof mashkull, me të njejtat permasa , duke e realizuar si një trup të vetem.

Qendrueshmeria e ngjyrave dhe rezistenca në keputje të jete e lartë.

Elementët përbërës të stemës.

Stema është në formën e një mburoje (shqyti) me permasa 7.5cm x 6 cm +/-0.1 cm. Pjesa e sipërme është e drejtë ndersa e pjesa e poshtme në forme ovale (shqyti).

Stema rrethohet me një kornizë ngjyrë ari, me gjëresi 2 mm, në qendër të saj është vendosur shqiponja e zezë dykrenare, e përdorur si simbol në krijimin e këtij formacioni. Mbi shqiponjë qëndron përkrenarja e Heroit tonë kombëtar, Skënderbeut, në ngjyrë të artë. Përkrenarja e Skënderbeut është vendosur në pamje ballore, për të bërë të mundur leximin e shkronjave “BT”, “IN”, duke respektuar semantiken, rregullat dhe stilet araldike të kurorave, e duke bërë më të lexueshme çfarë përfaqëson kjo përkrenare. Ajo i shmanget kopjimit përsëritës të saj, duke e bërë të vecantë për këtë institucion. Në këtë pozicion shikohet karakteri i saj laik e qytetar, fisnik e ushtarak. Emblema evidenton ndërthurjen e madhështisë me bukurinë që paraqet ky element në fushën e sematikës Shqiptare.

Duke qenë se stema shërben edhe si shenjë krahu për gardistët në pjesën harkore të shqytit, është shkruar me gërma kapitale “GARDA E REPUBLIKËS”.

Stema në teresi si dhe gjithë elementet përbërës të saj të jenë rezistentë ndaj gjithë faktoreve atmosferike. Po kështu dhe qendrueshmeria e ngjyrave e copës dhe penjëve të përdorur të jetë shumë e mirë.



ETIKETIMI, AMBALLAZHIMI:

Xhupave u vendoset nga një etikete (në pjesën e brëndeshme të tyre në qender të shpines ku bashkohet trupi me jaken) e cila duhet të përmbaje numrin e gjoksit dhe prerjen si dhe shenjat konvencionale te trajtimit në larje etj.

Xhupat amballazhohen sejcili në qese polietileni futen në kuti kartoni deri në 20 cope secila. Kutite paisen me etiketa ku të shenohet artikulli, emri i prodhuesit, data, numri gjoksit. Në çdo kuti futen xhupa të një numri.

TRASPORTIMI: Transportimi do të bëhet me mjete të pershtateshme për tu mbrojtur nga agjentet atmosferik.

Afati i lëvrimit: Brenda 90 ditëve nga lidhja e kontratës, por jo më vonë se data 20 dhjetor e vitit planifikues.



KOLAUDIMI MARRJA NE DORZIM

Pranimi i të gjithë sasisë së artikullit “Xhup $\frac{3}{4}$ me veshje të ngrohtë” të përcaktuar në kontratë dhe të dorëzuar në magazinën e Gardës, do të bëhet vetëm në bazë të rezultateve që do të merrën gjatë procesit të Kolaudimit për të gjithë sasinë e produktit të gatshëm të dorëzuar në magazinë. Kolaudimi do të bëhet mbi bazën e rezultateve të Fletë-analizave laboratorike të lëshuara nga Laboratore te Akredituar te Tekstil-Konfeksioneve, që shoqërojnë mallin, të sjella nga kontraktuesi, sipas përcaktimeve në kontratë, dhe ekzaminimit e të mallit të furnizuar, që do të bëjë “Komisioni i pritjes, kontrollit dhe pranimit të mallit të Gardës së Republikës”, i cili kryen direkt matjet e vlersimet organo-leptike të sasise së mallit të dorëzuar dhe bën krahasimin e të gjithë këtyre rezultateve me kerkesat dhe të dhënat teknike të ketij specifikimi teknik.

Gjithashtu, komisioni nëse e shikon të aryeshme dërgon mostra e kryen analiza laboratorike pranë laboratorëve të akredituar, duke i krahasuar rezultatet e tyre me rezultatet e analizave të sjella nga OE furnizues.

Artikulli konsiderohet teknikisht i pranuar kur ai ploteson të gjitha kerkesat e ketij Specifikimi Teknik.

SPECIFIKIM TEKNIK

OBJEKTI: 4. “Xhakovento” për punonjësit e Gardës të Republikës.

Ky specifikim teknik paraqet kërkesat themelore teknike të domosdoshme të artikullit “Xhakovento”. Në këtë specifikim teknik përcaktohen gjithashtu dhe kërkesat teknike të aksesoreve që shoqërojnë artikullin “Xhakovento” si produkt i gatshëm duke realizuar kompletimin e plotë të tyre.

Të gjitha përcaktimet teknike të këtij specifikimi teknik duhën të zbatohen detyrimisht saktë nga prodhuesi.

Për procedurë vlerësimi dhe miratimi nga përdoruesi, ofertuesi është i detyruar të paraqes si ofertë teknike të realizuar sipas kërkesave të këtij specifikimi teknik:

- 1 (një) copë “Xhakovento” me nr gjoksi 50.
- 1 (një) pjesë stof gjatësi 0,5 ml.
- Fletë-analize laboratorike të treguesve fiziko-mekanik e kimik të lëndës së parë të përdorur nga prodhuesi.

Copa e Xhakoventos moster, lëndës së parë që shoqëron atë dhe ajo që i bashkengjitet raport-analizës duhet të jenë detyrimisht të njejta.

Xhakoventos dhe lëndës së parë, u qepet me tegel makine nga një etiketë tekstili e bardhë, me permasa të përafërta 10 x10 cm, në të cilën shkruhet: moster “Xhakovento” emri i ofertuesit, data e tenderit, nënshkrimi dhe vula e ofertuesit.

Mungesa e mostres, lëndës së parë dhe fletë analizës që shoqëron ato është kusht skualifikues.

Nuk lejohen defekte të perhapura si; nuance të ndryshme ose pabarazia e ngjyres, fibrat e vdekura të leshit, papastërtitë të lëndës së huaja me origjin bimorë, njollat e ndryshme, sperkatjet me bojë ose vaj, oksidimet (ndotjet nga ndryshku), thyerjet e palosjet, rrudhat.

Difektet e lokalizuara ku hyjnë vrimat, njollat e vogla, fijet e felliqura, xhufkat, vendet e pathura ose të thurura keq, mungesa e fijeve të bazës ose të indit, fijet me mgjyra të ndryshme, dendësia me e madhe ose me e vogël se norma, fijet e trasha dhe nyjet.

LENDA E PARE : Stof ngjyre e zeze me perzierje (+/- 3%): 50 % lesh, 50 % poliester.

Masa : 240 gr/m² (+/- 3%).

Thurja : Sarzh. 2/2

Numri i fillit 50-54/2.

Dendësia e fijeve në 10 cm: në bazë 320 +/- 6 , në ind 280 +/- 6 .

Qendrushmeria keputje në kg : në bazë 78-6, në ind 57 – 6.

Qendrushmeria e ngjyres : shumë e mirë (nota 4-5). përfshinë: qendrushmeria e ngjyrave ndaj larjes me sapun e sode të kalcionuar, ndaj ujit , ndaj sperkatjes, ndaj djerses, ndaj ferkimit me të thatë dhe të njome, ndaj hekurosjes, ndaj larjes së thatë.

Qendrushmeria e ngjyres ndaj drites: shumë e mirë

M A T E R I A L E T N D I H M E S E :

Astar për mëngët dhe xhepat me përbërje 50% pambuk e 50% poliester,thurje diagonale, pesha 80 gr/m² me ngjyrë e zezë.

Flieseline, perforcues special të përshtatshëm për elementet e xhakoventos me përbërje 100 % PES

Filli - 100% polyester, ngjyra e zezë.

Zinxhir për mbylljen e xhakoventos - Standard, me fund të hapur, me rezistencë maksimale ndaj ujit, dhëmbët 100% acetal, madhësia e dhëmbëzave 8 VS ose 10VF, shiriti prej tekstili 100% polyester, me ngjyrë të zezë.

Zinxhir për xhepin e brendshëm të xhakoventos - Standard, me fund të mbyllur, madhësia e dhëmbëzave 4 CF ose 5 CF, dhëmbët 100% poliestër monofilament, shiriti prej tekstili 100% poliestër ngjyra e zezë.

Llastik akreliku me ngjyre te zeze për fundin dhe mëngët 6-7 cm

Elementet Velcro femer (ngjyre e zeze) per vendosjen:

- **E shenjes së mbiemrit** : Siper në gjoksin e djathtë 8.5 cm x 2.5 cm, vendoset velkrof femer në formë drejtëkëndeshi për vendosjen e mbiemrit.
- **E Stemes se Republikës dhe Stemes së Gardës**, velkrof femer ne mende, me permasa 7.5 cm x 6 cm +/-0.1 cm, pjesa e sipërme është e drejtë ndërsa e pjesa e poshtme në formë ovale (shqyti) me distancë rreth 7-8 cm nga gavatura e mëngës

Xhakovento, kompletohet me:

- **Stemë e Republikës** me velkrof mashkull (sipas specifikimeve të dhëna)
- **Stemë Garde** me velkrof mashkull (sipas specifikimeve të dhëna)

KERKESA CILESORE TE XHAKOVENTES

- Xhakovento është e hapur përpara, mberthehet me zinxhire i cili mbulohet me sallki 3-3.5 cm, sallkise i vendosen në dy ekstremet nga një kapse metalike mashkull-femer. Nga brenda i vendoset astar në të gjithë trupin. Në të dy përparësit ka xhepa oblik me qese astari.

Në fund xhakoventes dhe tek jaka e mëngës i vendoset llastik akreliku me ngjyre te zeze, gjëresia e llastikut në fund tek jaka e mëngës do të jetë 6-7 cm.

- **Në supe** në vend të spaletave vendosen dy ylyqe për montimin e gradave të supit në formë spaletë.

Ylyqet me permasa 4 x 1 cm qepën në mënyrë të tillë që mesi i ylykut të jetë mbi tengelin e bashkimit të shpines me gjoksin. Ylyku i parë qepet 1 cm nga tengeli i rrethit të mëngës (gavatura). Ylyku i dytë qepet 8 cm nga ylyku i parë.

- Xhakoventa në pjesën e brendshme (përpara) ka të vendosur material të pershtatshëm përforcues për mbajtjen e saj bukur në trup.

- Përparësja, shpina dhe mëngët janë të veshura me astar me ngjyre te zezë.

- Xhakoventa në mëngën e djathtë 7-8 cm poshtë qepjes së bashkimit të mëngës me trupin e matur nga pika me e lartë e supit në qendër vendoset me velkrof femer-mashkull “Stema e Gardës” sipas specifikimeve teknike të saj bashkelidhur. Po kështu në mëngën e majtë të xhakoventos 7-8 cm poshtë qepjes së bashkimit të mëngës me trupin e matur nga pika me e lartë e supit në qendër vendoset me velkrof femer-mashkull “Stema e Republikës” sipas specifikimeve teknike të saj bashkelidhur.

- Jaka do të ketë forme vezake ku zinxhiri para, do të mbyllet tek jaka.

Xhakoventa do të ketë tre prerje dhe katër gjokse .

Gjokset janë : 44-46, 48-50, 52-54, 56-58

Prerjet janë : I , II , III

Gjatesia e trupit 68, 72, 76

Gjatesia e mëngës 62, 66, 70

Permasat e Xhakoventes sipas Nr të gjokseve dhe prerjeve

Nr i gjoksit	44-46	48- 50	52 - 54	56 – 58
Gjeresia e gjoksit	49- 52	54-56	58-60	62-64
Shmangiet ne cm ($\pm$ 1cm)				

Gjatesia e pergjithshme (cm)		Gjatesia e menges (cm)
Prerje e pare	68	62
Prerja e dyte	72	66
Prerja e trete	76	70
Shmangiet ne cm	$\pm$ 2	$\pm$ 1

Sasia sipas numerave do bëhet mbi bazën e kerkesave të Gardës me lidhjen e kontratës.

STEMA E REPUBLIKËS (Shenjë krah)

Lëndët e para e ndihmëse:

Material i hollë e reziztent tekstili i qendisur me penjë sipas ngjyrave të çdo elementi të stemës.

Stemës mbas qendisjes i qepet velkrof mashkull, me të njejtat permasa , duke e realizuar si një trup të vetem.

Qendrueshmeria e ngjyrave dhe rezistenca në keputje të jete e lartë.

Elementët përbërës të stemës.

Stema është në formen e një mburoje me permasa 7.5 x 6 cm +/-0.1 cm.

Pjesa e sipërme është e drejtë ndërsa e pjesa e poshtme në formë ovale (shqyti). Fusha është në ngjyrë të kuqe në mes të së cilës gjëndet shqiponja dykrenare e qendisur me penjë me ngjyrë të zezë mbi të cilën në qendër vëndoset perkrenarja e Skenderbeut qendisur me penjë ngjyrë ari,në profil me pamje nga e djathta.

Stema rrethohet me një kornizë qendisur me penjë ngjyrë ari të vijeuar me gjeresi 2 mm. Stema në tërësi si dhe gjithë elementët përbërës të saj të jenë rezistente ndaj gjithë faktoreve atmosferike. Po kështu dhe qendrueshmeria e ngjyrave të jetë shumë e mirë. Stema vëndoset në krahun e majtë me anë të një velkrofi femer- mashkull.



STEMA E GARDËS SË REPUBLIKËS (Shenjë krah)

Lëndët e para e ndihmëse:

Material i hollë e reziztent tekstili i qendisur me penjë sipas ngjyrave të çdo elementi të stemës.

Stemës mbas qendisjes i qepet velkrof mashkull, me të njejtat permasa , duke e realizuar si një trup të vetem.

Qendrueshmeria e ngjyrave dhe rezistenca në keputje të jete e lartë.

Elementët përbërës të stemës.

Stema është në formën e një mburoje (shqyti) me permasa 7.5cm x 6 cm +/-0.1 cm. Pjesa e sipërme është e drejtë ndërsa e pjesa e poshtme në formë ovale (shqyti).

Stema rrethohet me një kornizë ngjyrë ari, me gjëresi 2 mm, në qendër të saj është vendosur shqiponja e zezë dykrenare, e përdorur si simbol në krijimin e këtij formacioni. Mbi shqiponjë qëndron përkrenarja e Heroit tonë kombëtar, Skënderbeut, në ngjyrë të artë. Përkrenarja e Skënderbeut është vendosur në pamje ballore, për të bërë të mundur leximin e shkronjave “BT”, “IN”, duke respektuar semantiken, rregullat dhe stilet araldike të kurorave, e duke bërë më të lexueshme çfarë përfaqëson kjo përkrenare. Ajo i shmanget kopjimit përsëritës të saj, duke e bërë të vecantë për këtë institucion. Në këtë pozicion shikohet karakteri i saj laik e qytetar, fisnik e ushtarak. Emblema evidenton ndërthurjen e madhështisë me bukurinë që paraqet ky element në fushën e semantikës Shqiptare.

Duke qenë se stema shërben edhe si shenjë krahu për gardistët në pjesën harkore të shqytit, është shkruar me gërma kapitale “GARDA E REPUBLIKËS”.

Stema në teresi si dhe gjithë elementet përbërës të saj të jenë rezistentë ndaj gjithë faktoreve atmosferike. Po kështu dhe qëndrueshmëria e ngjyrave e copës dhe penjëve të përdorur të jetë shumë e mirë.



ETIKETIMI, AMBALLAZHIMI:

Xhakoventove u vendoset nga një etiketë (në pjesën e brendeshme) e cila duhet të përmbajë numrin e gjoksit dhe prerjen, si dhe shenjat konvencionale të trajtimit në larje etj.

Xhakoventot amballazhohen secili në qese polietileni futën në kuti kartoni. Kutite paisen me etiketa ku të shenohet artikulli, emri i prodhuesit, data, numri gjoksit. Në çdo kuti futen xhupa të një numri.

TRASPORTIMI: Transportimi do të bëhet me mjete të përshtatshme për tu mbrojtur nga agjentet atmosferik.

Afati i lëvrimit: Brenda 90 ditëve nga lidhja e kontratës, por jo më vonë se data 20 dhjetor e vitit planifikues.

KOLAUDIMI MARRJA NË DORZIM

Pranimi i të gjithë sasisë të artikullit “Xhakovento” të përcaktuar në kontratë dhe të dorëzuar në magazinën e Gardës, do të bëhet vetëm në bazë të rezultateve që do të merrën gjatë procesit të Kolaudit për të gjithë sasinë e produktit të gatshëm të dorëzuar në magazinë. Kolaudimi do të bëhet mbi bazën e rezultateve të Fletë-analizave laboratorike të lëshuara nga Laboratore të Akredituar të Tekstil-Konfeksioneve, që shoqërojnë mallin, të sjella nga kontraktuesi, sipas përcaktimeve në kontratë, dhe ekzaminimit të mallit të furnizuar, që do të bëjë “Komisioni i pritjes, kontrollit dhe pranimit të mallit të Gardës së Republikës”, i cili kryen direkt matjet e vlersimet organo-leptike të sasisë së mallit të dorëzuar dhe bën krahasimin e të gjithë këtyre rezultateve me kërkesat dhe të dhënat teknike të këtij specifikimi teknik.

Gjithashtu, komisioni nëse e shikon të arsyeshme dërgon mostra e kryen analiza laboratorike pranë laboratorëve të akredituar, duke i krahasuar rezultatet e tyre me rezultatet e analizave të sjella nga OE furnizues.

Artikulli konsiderohet teknikisht i pranuar kur ai ploteson të gjitha kërkesat e këtij Specifikimi Teknik.

SPECIFIKIM TEKNIK

OBJEKTI: 5. “Këmishë me mëngë të shkurtra” për punonjësit e Gardës së Republikës

Ky specifikim teknik paraqet kërkesat themelore teknike të domosdoshme për prodhimin e artikullit “Këmishë me mëngë të shkurtra”. Në këtë specifikim teknik përcaktohen gjithashtu dhe kërkesat teknike të aksesoreve që shoqërojnë artikullin “Këmishë me mëngë të shkurtra” si produkt i gatshëm .

Të gjitha përcaktimet teknike të këtij specifikimi teknik duhën të zbatohen detyrimisht saktë nga prodhuesi.

Për procedurë vlerësimi dhe miratimi nga perdoruesi, pjesemarresi prodhues konkurues është i detyruar të paraqesë si ofertë teknike të realizuar sipas kërkesave të këtij specifikimi teknik:

- 1 (një) copë “Këmishë me mëngë të shkurtra” me nr gjoksi 50.
- 1 (një) pjesë pupline gjatësi 0,5 ml, gjërësi sa ajo e vet puplinës.
- Fletë-analize laboratorike të treguesve fiziko-mekanik e kimik të lëndës së parë të përdorur nga prodhuesi.

Copa e Këmishës muster, lëndës së parë (pjesë puplinë) dhe ajo që i bashkengjitet raport-analizës duhet të jenë detyrimisht të njëjta.

Këmishës dhe lëndës së parë u qepet me tegel makine nga një etiketë tekstili i bardhë, me permasa të përafërta 10 x10 cm, në të cilën shkruhet: muster “Këmishë me mëngë të shkurta uniforme Garde”, emri i ofertuesit, data e tenderit, nënshkrimi dhe vula e ofertuesit.

Mungesa e mostrës, lëndës parë dhe fletë analizës që shoqeron ato është kusht skualifikues.

LËNDA E PARË : Tekstil me ngjyrë të bardhë, përbërje (+/-3%) : 80% pambuk dhe 20% poliestër

- | | |
|------------------------------------|--|
| - Masa: | 120 gr/m2 (+/-3%). |
| - Thurja: | Garniture. |
| - Ngjyra: | Bardhë |
| - Qëndrueshmëria në keputje në kg: | Në bazë jo me pak se 35, në ind jo me pak se 22. |
| - Qëndrueshmëria e ngjyrës: | Shumë e mirë |
| - Dëndësia e fijeve në 10 cm: | Në bazë 450 (+/-3%)., në ind 300 (+/-3%). |
| - Numri i fillit : | 54/1. |

Materialet Ndihmëse: që duhet të përdoren për prodhimin e artikullit “Këmishë me mëngë të shkurta uniforme” janë:

- **Kollaritje** material tekstili ngjitës me fortesë të plotë për të përforcuar jaken dhe kapaket e xhepave
- **Kopsa të vogla Garde** metalike, 9 copë
- **Penj qepje**, Nm 120, 100% PES me ngjyrën e puplinës ose me ngjyrë të përtafërt
-

Elementet Velcro femër me ngjyrë të bardhë për vëndosjen:

- **E shenjës së mbiemrit:** Siper në gjoksin e djathtë vendoset velkrof femër në formë drejtëkëndeshi 8.5 cm x 2.5 cm, me ngjyrë të përtafërt me tekstin e kemishës për vëndosjen e mbiemrit.
- **E Stemes së Republikës dhe Stemes së Gardës**, velkrof femër në mëngë, me përmasa 7.5 cm x 6 cm (+/- 1 mm), pjesa e sipërme është e drejtë ndërsa e pjesa e poshtme në formë ovale (shqyti) me distancë rreth 7-8 cm nga gavatura e mëngës

Këmishë me mëngë të shkurtra uniforme, kompletëhet me:

- **Steme e Republikës** me velkrof mashkull (sipas specifikimeve të dhëna)
- **Steme Garde** me velkrof mashkull (sipas specifikimeve të dhëna)

Prodhimi i artikullit “Kemishë me mëngë të shkurta” duhet të realizohet sipas një procesi teknologjik të përcaktuar mbi bazën e kërkesave dhe kushteve teknologjike të sakta në secilen fazë të realizimit të tij. Prodhimi ndahet në tre faza kryesore të cilat janë:

A. PERPUNIMI PERGATITOR

Kolaudimi i lëndës së parë dhe materialëve ndihmës

Kolaudimi i lëndës së parë dhe materialeve ndihmës në mënyrë të sakte dhe të drejtë është bazë për një ecuri cilësore të procesve teknologjike të metejshme zinxhir për prodhimin me cilësi të artikullit “Kemishë me mëngë të shkurta”.

Skicimi

Ky proces duhet të realizohet me metodat matematikore të programimit linear të cilat sigurojnë një shenim të sakte të prerjeve dhe shenjave sipas vizatimeve duke pasur kujdes që detajet e kemishës duhet të jenë në drejtim të fijeve të bazës.

Prerja Procesi i prerjes duhet të bëhet me shumë kujdes që të mos të ketë devijime në fletet e fundit të dyshekut i cili është mirë që të mos të kalojë 100 - 120 flete. Kujdes duhet të bëhet dhe në pjesët e harkuara të detajeve dhe buzët e prera të mos jenë me dhembëza.

Marketimi

Ky proces është shumë i rëndësishëm sepse eliminon qepjen e detajeve të kemishës me tonacione të ndryshme duke siguruar njëllojshmëri në ngjyrë të artikullit.

Kollaritja

Detajeve gjysem të gatshme të kemishës ngjitja e materialit tekstil kollarites duhet të bëhet me prese speciale me avull në Temp 130-140 °C, në kohë 8-10 sek. në presion 2 atm. Ky proces duhet të kryhet sa më i saktë në mënyrë që të mos ketë asnjë mundësi që në objekt të krijohen deformime gjatë hekurosjes me avull, larjes dhe lagies nga shiu, të cilat bëjnë të mundur humbjen e pamjes fillestare. Kollaritja nuk lejohet me shtesa.

Kollaritja është material tekstil i posacëm për kemisha dhe i veshur nga njëra anë me material ngjitës të posacëm. Kollaritja shoqërohet me fortesë të plotë dhe përdoret për të përforcuar jakën dhe kapaket e xhepave.

B. KONFEKSIONIMI (PROCESI I QEPJES)

Kemisha perbehet nga jaka, menget e shkurta, xhepat pllake me palosje ne mes me mbyllje me kapak, ylyqet në sup dhe kopsa të vogla garde sipas specifikimeve teknike te saj te pershkruara me poshte.

Kemisha ne mengjen e djathte 7-8 cm poshte qepjes se bashkimit te menges me trupin, e matur nga pika me e larte e supit ne qender vendoset me velkrof femër, “Stema e Gardes” sipas specifikimeve teknike te saj te pershkruara me poshte.

Po keshtu ne mengjen e majte te kemishes 7-8 cm poshte qepjes se bashkimit te menges me trupin e matur nga pika me e larte e supit, vendoset vendoset me velkrof femër “Stema e Republikës” sipas specifikimeve teknike te saj te pershkruara me poshte.

Gjatesia e kemishes te jete 84 cm.

Pjesa e shpines e kemishes eshte me supanje te ndertuar me dy copa nje ne pjesen e brendeshme dhe nje ne pjesen jashtme.

Fundi i kemishes pershkohet nga nje tegel i thjeshte makine. Bashkimi i mengeve me trupin, mbyllja e tyre dhe e fjongove anesore behet me syzator.

Jaka e kemishes eshte e mbyllur. Jaka perbehet nga maja dhe baza (kama) e saj. Jaka (maja dhe baza) perbehet nga pjesa e siperme dhe pjesa e poshtme. Jakes (majes dhe bazes) i vendoset kollaritje ne pjesen e siperme. Kollaritja duhet te jete material tekstili ngjites ne ngjyre te bardhe dhe me fortese te plote per te perforcuar jaken. Maja dhe baza e jakes ndertohen te ndara. Maja dhe baza e jakes mbas kollaritjes fiksohen me tegel. Majes se jakes per perforcim te kulmeve te majave u vendoset nga nje maje plastike te cilat jane te fiksuara me ngjitje ne nje cope tekstili te bardhe si. Pas ketyre proceseve pjeset e siperme te kollaritura te majes dhe te bazes se jakes bashkohen me pjeset e poshtme, kthehen, hekurosen dhe rregullohen. Duhet bere kujdes qe majat e jakes te mos jene te rrumbullakta por te kene pamje estetike. Majes se jakes i kalohet tegeli i zbukurimit 5 mm larg buzës .

Ne perfundim behet procesi i bashkimit te majes se jakes me bazen e saj. Bazes se jakes i qepet tegeli i zbukurimit i cili tek pjeset e harkuara te bazes duhet te jete 1 mm larg buzës.

Gjoksi - Kemishat te jene pa bordure perpara. Mberthimi i kemishes behet me pese kopsa te vogla Garde metalike te qepura ne perpareshen e djathte te cilave u korespondojne vrimat ne perpareshen e majte per meshkujt dhe te qepura ne perpareshen e majte dhe me vrimat koresponduse ne perpareshen e djathte per femrat. Kopsa e pare qepet ne kthimin e jakes dhe jane te baraslarguara nga njera tjetra 11-11.5 cm.

Xhepat jane pllake me permasa 14 x 16 cm. Xhepat ne te dy anet poshte jane me cepa me forme te prere. Xhepat ne mes kane nje palosje me gjeresi 3 cm ne mesin e te ciles lart vendoset nje kopse e vogel Garde metalike ne ngjyre si te puplines, qe sherben per mbylljen e xhepit. Xhepat u kalohet nje tegel zbukurimi 0.5 cm larg buzeve. Xhepat mbyllen me kapak.

Kapaket jane ne forme drejtkendeshi dhe me nje vrimë ne mes. Kapaket perbehen nga pjesa e siperme dhe e poshtme. Pjeses se siperme te kapakut per perforcim i vendoset kollaritje (material tekstili ngjites ne ngjyre te bardhe). Duhet bere kujdes qe cepat e kapakut te mos jene te rrumbullakta por me kende te drejte dhe te kene pamje estetike. Kapakut i kalohet nje tegel zbukurimi 5 mm larg buzeve. Mbi kapakun e xhepit te djathte ne qender vendoset velkrof femer ne ngjyre te bardhë ne forme drejtekendshi me permasa 8.5 cm x 2.5 cm qe do te sherbeje per vendosjen e mbiemrit.

Në supe vendosen dy ylyqe per montimin e gradave te supit ne forme spalete.

Ylyqet me permasa 4 x 1 cm qepen ne menyre te tille qe mesi i ylykut te jete mbi tengelin e bashkimit te shpines me gjoksin. Ylyku i pare qepet 1 cm nga tengeli i rrethit te menges (gavatura). Ylyku i dyte qepet 8 cm nga ylyku i pare.

Menget jane me gjatesi 27 cm behen me tegel 2.5-3 cm nga buza e menges.

Shpina e kemishes perbehet nga supanja dhe pjesa e poshtme e shpines. Supanja perbehet nga pjesa e sipërme dhe pjesa e poshtme. Supanja e perfunduar ka thellesi 12 cm e matur nga pika ku bashkohet me jaken deri ne tegelin e bashkimit me pjesen e poshtme te shpines. Pergjate bashkimit te supanjes me pjesen e poshtme te shpines ne distance jo me shume se 10 cm nga tegeli i bashkimit te menges me shpinen realizohen dy penca me thellesi 1,5 cm. Pergjate bashkimit te supanjes me pjesen e poshtme te shpines kalohet nje tegel zbukurimi 1 mm larg buzes. Shpina ne fund mbyllet me nje bordure me gjeresi 1- 1.5 cm, i kalohet tegel 3-5 mm larg buzeve duke e palosur dy here copen.

Mbylljet duhet te realizohen me makine qepje dygjilpershe. Mbyllja e kemishes fillon me bashkimin anesor te shpines me gjokset dhe duke vazhduar me mbylljen e mengeve.

Tegelat e qepjes duhet jene te forte ne menyre te tille qe te mos hapen nen ushtrimin e forces se duarve. Fortesia e tegelave te jete mbi 12 kG. Tegelat duhet te jene te perforcuar ne fund. Peri qe do te perdoret per qepje duhet te jete i forte dhe me ngjyre si ajo e puplines ose ngjyre te perafert me Nm 120 ,100 % PES.

Kemisha duhet te jete simetrike ne te gjithë elementet e saj.

Kemisha me mende te shkurta eshte e njejte ne model si per meshkuj ashtu dhe per femra
STEMA E REPUBLIKËS (Shenjë krah)

Lëndët e para e ndihmëse:

Material i hollë e reziztent tekstili i qendisur me penjë sipas ngjyrave të çdo elementi të stemës.

Stemës mbas qendisjes i qepet velkrof mashkull, me të njejtat permasa , duke e realizuar si një trup të vetem.

Qendrueshmeria e ngjyrave dhe rezistenca në keputje të jete e lartë.

Elementët përbërës të stemës.

Stema është në formen e një mburoje me permasa 7.5 x 6 cm +/-0.1 cm.

Pjesa e sipërme është e drejtë ndersa e pjesa e poshtme në formë ovale (shqyti). Fusha është në ngjyrë të kuqe në mes të së cilës gjëndet shqiponja dykrenare e qendisur me penj me ngjyrë të zezë mbi të cilën në qendër vëndoset perkrenarja e Skenderbeut qendisur me penj ngjyrë ari,në profil me pamje nga e djathta.

Stema rrethohet me një kornizë qendisur me penj ngjyrë ari të vijeuar me gjeresi 2 mm. Stema në terësi si dhe gjithë elementët përbërës të saj të jenë rezistente ndaj gjithë faktoreve atmosferike. Po kështu dhe qendrueshmeria e ngjyrave të jetë shumë e mirë. Stema vendoset në krahun e majtë me anë të një velkrofi femer- mashkull.



STEMA E GARDËS SË REPUBLIKËS (Shenjë krahu)

Lëndët e para e ndihmëse:

Material i hollë e reziztent tekstili i qendisur me penjë sipas ngjyrave të çdo elementi të stemës.

Stemës mbas qendisjes i qepet velkrof mashkull, me të njejtat permasa , duke e realizuar si një trup të vetem.

Qendrueshmeria e ngjyrave dhe rezistenca në keputje të jete e lartë.

Elementët përbërës të stemës.

Stema është në formën e një mburoje (shqyti) me permasa 7.5cm x 6 cm +/-0.1 cm. Pjesa e sipërme është e drejtë ndersa e pjesa e poshtme në forme ovale (shqyti).

Stema rrethohet me një kornizë ngjyrë ari, me gjëresi 2 mm, në qendër të saj është vendosur shqiponja e zezë dykrenare, e përdorur si simbol në krijimin e këtij formacioni. Mbi shqiponjë qëndron përkrenarja e Heroit tonë kombëtar, Skënderbeut, në ngjyrë të artë. Përkrenarja e Skënderbeut është vendosur në pamje ballore, për të bërë të mundur leximin e shkronjave “BT”, “IN”, duke respektuar semantiken, rregullat dhe stilet araldike të kurorave, e duke bërë më të lexueshme çfarë përfaqëson kjo përkrenare. Ajo i shmanget kopjimit përsëritës të saj, duke e bërë të vecantë për këtë institucion. Në këtë pozicion shikohet karakteri i saj laik e qytetar, fisnik e ushtarak. Emblema evidenton ndërthurjen e madhështisë me bukurinë që paraqet ky element në fushën e sematikës Shqiptare.

Duke qenë se stema shërben edhe si shenjë krahu për gardistët në pjesën harkore të shqytit, është shkruar me gërma kapitale “GARDA E REPUBLIKËS”.

Stema në teresi si dhe gjithë elementet përbërës të saj të jenë rezistentë ndaj gjithë faktoreve atmosferike. Po kështu dhe qendrueshmeria e ngjyrave e copës dhe penjëve të përdorur të jetë shumë e mirë.



C. AMBALLAZHIMI, MARKETIMI DHE ETIKETIMI

Kemisha me minge te shkurta e kompletuar me te gjitha elementet dekorative dhe shenjat e percaktuara ne kete Specifikim Teknik marketohet qarte me shkrim me ane te nje etikete tekstili te qepur ne pjesen e brendshme ne qender te bashkimit te jakes me shpinen dhe qe permban Emrin e ndermarjes ose te firmes prodhuese, numrin e gjoksit dhe vitin e prodhimit. Çdo kemishe duhet te jete pastruar mire nga penjet te jete e hekurosur dhe te mos kete njolla. Poshte ne ane ne pjesen e brendshme te bordures se gjoksit duhet te vendoset nje etikete e veçante ne te cilen shenohen treguesit baze te lendes se I-re te perdorur si dhe me shenja konvencionale trajtimi i kemisheve hekurosje, larje etj.

Kemisha paloset duke i vendosur ne brendesi karton dhe fiksohet me gjilpera me koke. Kemisha paketohe ne qese celofoni. Kemishat e paketuara futen ne kuti kartoni nga 30 cope kemisha. Ne çdo kuti duhet te vendosen kemisha te nje numri gjoksi. Te gjitha kutite duhet te kene te njeitin numer kemishash. Kutite duhet te jene te rregullta dhe te shiritizohen duke siguruar mbyllje te mire. Mbi kutite vendosen etiketa ku shenohet qarte emri i firmes prodhuese me vulen perkatese, numri i gjoksit, sasia dhe viti i prodhimit.

Afati i lëvrimit: Brenda 90 ditëve nga lidhja e kontratës, por jo më vonë se data 20 dhjetor e vitit planifikues.

KOLAUDIMI MARRJA NE DORZIM

Pranimi i të gjithë sasisë së artikullit “Këmishë me mëngë të shkurtera” të përcaktuar në kontratë dhe të dorëzuar në magazinën e Gardës, do të bëhet vetëm në bazë të rezultateve që do të merrën gjatë procesit të Kolaudit për të gjithë sasinë e produktit të gatshëm të dorëzuar në magazinë. Kolaudi do të bëhet mbi bazën e rezultateve të Fletë-analizave laboratorike të lëshuara nga Laboratore te Akredituar te Tekstil-Konfeksioneve, që shoqërojnë mallin, të sjella nga kontraktuesi, sipas përcaktimeve në kontratë, dhe ekzaminimit e të mallit të furnizuar, që do të bëjë “Komisioni i pritjes, kontrollit dhe pranimi të mallit të Gardës së Republikës”, i cili kryen direkt matjet e vlersimet organo-leptike të sasise së mallit të dorëzuar dhe bën krahasimin e të gjithë këtyre rezultateve me kerkesat dhe të dhënat teknike të ketij specifikimi teknik.

Gjithashtu, komisioni nëse e shikon të aryeshme dërgon mostra e kryen analiza laboratorike pranë laboratorëve të akredituar, duke i krahasuar rezultatet e tyre me rezultatet e analizave të sjella nga OE furnizues.

Artikulli konsiderohet teknikisht i pranuar kur ai ploteson te gjitha kerkesat e ketij Specifikimi Teknik.

SPECIFIKIME - TEKNIKE

OBJEKTI: 6. Bluzë mëngë të shkurta (me tre kopsa) për punonjësit e Gardës së Republikës.

Ky specifikim teknik paraqet kerkesat themelore teknike të domosdoshme për artikullin “Bluzë mëngë të shkurta (me tre kopsa)”. Në këtë specifikim teknik percaktohen gjithashtu dhe kerkesat teknike të aksesoreve që shoqërojnë artikullin “Bluzë mëngë të shkurta (me tre kopsa)” si produkt te gatshem.

Të gjitha përcaktimet teknike të këtij specifikimi teknik duhen të zbatohen detyrimisht saktë nga prodhuesi.

Për procedurë vlerësimi dhe miratimi nga përdoruesi, ofertuesi është i detyruar të paraqesi si ofertë teknike të realizuar sipas kërkesave të këtij specifikimi teknik :

- 1 (një) copë “Bluzë mëngë të shkurta (me tre kopsa)” me nr gjoksi 50.
Mostra duhet të ketë vulë dhe etikete origjinale të subjektit prodhues.
- 1 (një) pjesë trikotazhi me permasa 50 x 50 cm.
- Fletë-analizë laboratorike të treguesve fiziko-mekanik e kimik të lëndës së parë të përdorur nga prodhuesi.

Copa e mostrës, lëndës së parë dhe ajo që i bashkengjitet raport-analizes duhet të jenë detyrimisht të njëjta.

Mos plotësimi nga subjekti prodhues (ofertues) në procedurë vlerësimi i tre kërkesave të mësipërme do të konsiderohet skualifikim teknik.

Bluzës së pambukut dhe lëndës së parë u qepet nga një etiketë tekstili në të cilën shkruhet: moster “Bluzë mëngë të shkurta me tre kopsa”, emri i ofertuesit, data dhe vula e ofertuesit.

Mungesa e mostres, lëndës parë dhe fletë analizës që shoqëron ato është kusht skualifikues.

- a. Materiali bazë që duhet të përdoret për prodhimin e artikullit “Bluzë mëngë të shkurta (me tre kopsa)” duhet të jete i cilësisë së parë, me këto të dhëna teknike:**

Përbërja : 50% pambuk, 50% poliestër ($\pm 3\%$)

Thurja: Trupi – pique (syth irlandez); jaka dhe bordura e mëngës – punim llastik 1:1.

Masa : Trupi: 180 gr/m² ($\pm 3\%$); jaka dhe bordura e mëngës: 200 gr/m² ($\pm 3\%$).

Ngjyra: E zezë;

Qëndrueshmëria e ngjyrës: Shumë e mirë.

- b. Materialet ndihmëse dhe aksesoret që duhet të përdoren në artikullin “Bluzë mëngë të shkurta (me tre kopsa)”:**

Frazelinë: Për përforsimin e bordurës së kopsave dhe vrimave – 100% pambuk, pesha rreth 80 gr/m², ngjyrë e errët. Frazelinë për qepjen e elementeve *Velcro* – e pershtatshme për tekstin e bluzës.

Fileto për përforsimin e bashkimit të jakes me trupin: Trashësia 1cm, 100% pambuk, ngjyra si e bluzës (e zezë).

- c. Fill qepës** (për të gjitha qepjet e trikotazhit përfshi vrimat e kopsave): 100% poliestër, qëndrueshmëria në tërheqje jo më pak se 12 N, ngjyra e njëjtë me tekstin e bluzës.

Elementet *Velcro* femër (ngjyrë e zezë) për vëndosjen:

- **E shenjës së mbiemrit dhe gradës:** Sipër në gjoksin e djathtë e të majtë, vendoset velkrof femër në formë drejtëkëndëshi 8.5 cm x 2.5 cm, me ngjyrë të perafert me tekstin e bluzës për vëndosjen e mbiemrit dhe gradës.
- **E Stemës së Republikës dhe Stemës së Gardës,** velkrof femër në mëngë, me permasa 7.5 cm x 6 cm ± 0.1 cm, pjesa e sipërme është e drejte ndersa e pjesa e poshtme në forme ovale (shqyti) me distancë rreth 7-8 cm nga gavatura e mëngës

Bluzë mëngë të shkurta me tre kopsa, kompletëhet me:

- **Stemë e Republikës** me velkrof mashkull (sipas specifikimeve të dhëna) **për ½ e sasië së bluzave.**
- **Stemë Garde** me velkrof mashkull (sipas specifikimeve të dhëna) **për ½ e sasië së bluzave.**

PJESËT PËRBËRESE TË BLUZËS

Jaka – duhet të ndertohet me tekstil trikotazh methurje llastik 1:1 drejtim vertikal dhe lartësi standarte 8 cm.

Bashkimi i dy pjesëve të bluzës duhet të bëhet me anë të një filetoje prej pambuku me gjërësi rreth 1 cm. Qepja e filetos tek jaka dhe tek bluza duhet të bëhet me dy tengela lineare një gjilpërësh.

Bordura e vrimave dhe e kopsave duhet të jenë të dyja të perforcuara me fazeline termoadezive.

Në pjesën e poshteme bordurat duhet të bashkohën me njera tjetren me një qepje në formë drejtkëndore me përmasa 3.5 x 1 cm.


Kopsat duhet të jenë Nr 18 (11 mm) e vendosën në anën e djathtë. Qepja e tyre duhet të bëhet kryq me fill me ngjyre të zezë.

Vrima e parë e kopsës duhet të jetë me drejtim horizontal. Ajo duhet të hapet në një distance 1 cm nga buza e sipërme e bordurës. Vrimat e tjera duhet të jenë me drejtim vertikal dhe të barazlanguara me një distance 4.5 cm nga njëra - tjetra. Vrimat e kopsave duhet të kenë gjatësi 18 mm.

Pjesët përpara dhe mbrapa – Si përpara edhe mbrapa bluza duhet të ndërtohet me nga një pjesë të vetme dhe bashkohën njera me tjetrën me tengel linear një gjilpërësh të perforcuar nga brenda me tengel syzatore.

Në linjen e supeve duhet qepur një fileto përforcuese për ruajtjen e formës së supeve.

Midis shpatullave të bluzës, në brëndësi, duhet të qepet një shtresë përforcuese në formën e gjysem rrethit me të njetin tekstil si bluza. Në vartësi të masës së bluzes, rrezja e rrethit duhet të jetë rreth 9 cm (për masen M).





Në fund bluza mbyllet me një palosje me lartësi rreth 2.5 cm. Palosja duhet të qepet me tengel syzatore dy gjilperesh.

Pjesët “e çara” duhet të jenë të larta 4 cm dhe duhet të përforcohen me tengel linear një gjilpërësh sipërfaqësore nga secila anë e buzës.

Fundi i bluzës duhet të jetë i drejtë dhe të ketë të njëjtën gjatësi në të dyja anët.

Jaka dhe bordura e mëngës përshkohen nga një fileto e kuqe 3 mm, me material të njëjtë me atë të trupit, në distancë 0.5 cm nga buza fundore e mëngëve dhe jakës.

Mëngët - duhet të përbëhen nga një pjesë të vetme tekstili.

Përmasat e mëngës duhet të ndryshojnë në varësi të masës së bluzës.

Mënga duhet të bashkohet me trupin e bluzës me 2 tegela: 1 tegel qepës linear dhe 1 tegel syzator 5 gjilpërësh.

Mënga duhet të mbyllet me tekstil trikotazh methurje “llastik” 1:1 me drejtim vertikal (i njëjtë me atë të jakës) me lartësi rreth 3 cm.
Tekstili trikotazh duhet të bashkohet me mëngën me tegel linear dy gjilpërësh dhe të përforcohet nga brenda me tegel syzator.

Përmasa të pandryshueshme për të gjitha masat e bluzës

Lartësia e jakës	8 cm
Lartësia e shiritit llastik të mëngës	3 cm
Madhësia e çarjeve	4 cm
Lartësia e kthimit të palës së fundit të bluzës	2.5 cm

Elementët velcro

Bluza duhet të pajiset me 4 elementë Velcro femër:

- 1 copë për vendosjen e gradës së gjoksit, me përmasa 8.5 x 2.5 cm.
- 1 copë për vendosjen e mbiemrit të punonjesit të Gardes, me përmasa 8.5 x 2.5 cm.
- 1 copë për vendosjen e Stemës së Republikës në mëngën e majtë me përmasa 7.5 x 6 cm.
- 1 copë për vendosjen e Stemes së Gardes në mëngën e djathtë me përmasa 7.5 x 6 cm.

Elementët *Velcro* në gjoks duhet të vendosen paralel me njëra-tjetrën dhe të barazlarguar nga bordura e kopsave. Elementi *Velcro* për vendosjen e shenjave në mëngë duhet të ketë një distancë rreth 7-8 cm nga gavatura e mëngës.

Elementët *Velcro* duhet të qepen me tegel linear perimetral me ngjyrë të zezë dhe të përforcohen me dy tegela diagonalë. Qepja e elementëve *Velcro* duhet të bëhet me ndihmën e shtresës përforcuese prej frazelinë në mënyrë që të mos ketë dëmtime ose grisje të tekstilit gjatë qepjes dhe gjatë përdorimit.

Grada & Shenja dalluese

- **Stemë e Republikës** me velkrof mashkull (sipas specifikimeve të dhëna)
- **Stemë Garde** me velkrof mashkull (sipas specifikimeve të dhëna)

STEMA E REPUBLIKËS (Shenjë krah)

Lëndët e para e ndihmëse:

Material i hollë e reziztent tekstili i qendisur me penjë sipas ngjyrave të çdo elementi të stemës.

Stemës mbas qendisjes i qepet velkrof mashkull, me të njejtat përmasa, duke e realizuar si një trup të vetëm.

Qendrueshmeria e ngjyrave dhe rezistenca në keputje të jete e lartë.

Elementët përbërës të stemës.

Stema është në formën e një mburoje me përmasa 7.5 x 6 cm +/-0.1 cm.

Pjesa e sipërme është e drejtë ndersa e pjesa e poshtme në formë ovale (shqyti). Fusha është në ngjyrë të kuqe në mes të së cilës gjëndet shqiponja dykrenare e qendisur me penjë me ngjyrë të zezë mbi të cilën në qendër vëndoset perkrenarja e Skenderbeut qendisur me penjë ngjyrë ari, në profil me pamje nga e djathta.

Stema rrethohet me një kornizë qendisur me penjë ngjyrë ari të vijeuar me gjerësi 2 mm. Stema në terësi si dhe gjithë elementët përbërës të saj të jenë rezistente ndaj gjithë faktoreve atmosferike. Po kështu dhe qendrueshmeria e ngjyrave të jetë shumë e mirë. Stema vëndoset në krahun e majtë me anë të një velkrofi femer- mashkull.



STEMA E GARDËS SË REPUBLIKËS (Shenjë krahut)

Lëndët e para e ndihmëse:

Material i hollë e reziztent tekstili i qenditur me penjë sipas ngjyrave të çdo elementi të stemës.

Stemës mbas qendrisjes i qepet velkrof mashkull, me të njëjtat permasa , duke e realizuar si një trup të vetem.

Qendrueshmeria e ngjyrave dhe rezistenca në keputje të jete e lartë.

Elementët përbërës të stemës.

Stema është në formën e një mburoje (shqyti) me permasa 7.5cm x 6 cm +/-0.1 cm. Pjesa e sipërme është e drejtë ndersa e pjesa e poshtme në forme ovale (shqyti).

Stema rrethohet me një kornizë ngjyrë ari, me gjëresi 2 mm, në qendër të saj është vendosur shqiponja e zezë dykrenare, e përdorur si simbol në krijimin e këtij formacioni. Mbi shqiponjë qëndron përkrenarja e Heroit tonë kombëtar, Skënderbeut, në ngjyrë të artë. Përkrenarja e Skënderbeut është vendosur në pamje ballore, për të bërë të mundur leximin e shkronjave “BT”, ”IN”, duke respektuar semantiken, rregullat dhe stilet araldike të kurorave, e duke bërë më të lexueshme çfarë përfaqëson kjo përkrenare. Ajo i shmanget kopjimit përsëritës të saj, duke e bërë të vecantë për këtë institucion. Në këtë pozicion shikohet karakteri i saj laik e qytetar, fisnik e ushtarak. Emblema evidenton ndërthurjen e madhështisë me bukurinë që paraqet ky element në fushën e semantikës Shqiptare.

Duke qenë se stema shërben edhe si shenjë krahut për gardistët në pjesën harkore të shqytit, është shkruar me gërma kapitale “GARDA E REPUBLIKËS”.

Stema në teresi si dhe gjithë elementet përbërës të saj të jenë rezistentë ndaj gjithë faktoreve atmosferike. Po kështu dhe qendrueshmeria e ngjyrave e copës dhe penjëve të përdorur të jetë shumë e mirë.



NUMRAT- e këtij artikulli do të jenë S - XXXL.

Sasia sipas numërave do bëhet mbi bazën e kërkesave të Gardës me lidhjen e kontratës.

Amballazhimi, marketimi dhe etiketimi

Artikulli “Bluzë mëngë të shkurtëra (me tre kopsa)” e kompletuar me të gjitha elementet e percaktuara në këtë Specifikim Teknik marketohet qartë me shkrim me anë të një etikete tekstili të qepur në pjesën e brendshme në qendër të bashkimit të jakes me shpinen dhe që përmban emrin e firmes prodhuese, masen e bluzës dhe vitin e prodhimit. Çdo bluzë duhet të jetë pastruar mirë nga penjët dhe të mos ketë njolla.

Poshtë në anë, në pjesën e brendshme të bluzës duhet të vendoset një etiketë e veçantë në të cilën shenohen treguesit bazë të lëndës së I-re trikotazh i zi të përdorur si dhe me shenja konvencionale trajtimi i bluzës (hekurosje, larje etj).

Bluza me mëngë të shkurtera paloset dhe paketohet në qese celofoni. Bluzat e paketuara futën në kuti kartoni nga 40 copë bluza. Në çdo kuti duhet të vendosën bluza të një mase. Të gjitha kutitë duhet të kenë të njejtin numer bluzash. Kutite duhet të jenë të rregullta dhe të shiritizohen duke siguruar mbyllje të mirë. Mbi kutite vendosen etiketa ku shenohet qartë emri i firmes prodhuese me vulen përkatëse, masa e bluzës, sasia dhe viti i prodhimit.

Kolaudimi marrja ne dorzim

Pranimi i të gjithë sasisë të artikullit “Bluzë mëngë të shkurtëra (me tre kopsa)” të përcaktuar në kontratë dhe të dorëzuar në magazinën e Gardës, do të bëhet vetëm në bazë të rezultateve që do të merrën gjatë procesit të Kolaudit për të gjithë sasinë e produktit të gatshëm të dorëzuar në magazinë. Kolaudimi do të bëhet mbi bazën e rezultateve të Fletë-analizave laboratorike të lëshuara nga Laboratore te Akredituar te Tekstil-Konfeksioneve, që shoqërojnë mallin, të sjella nga kontraktuesi, sipas përcaktimeve në kontratë, dhe ekzaminimit të mallit të furnizuar, që do të bëjë “Komisioni i pritjes, kontrollit dhe pranimit të mallit të Gardës së Republikës”, i cili kryen direkt matjet e vlersimet organo-leptike të sasise së mallit të dorëzuar dhe bën krahasimin e të gjithë këtyre rezultateve me kërkesat dhe të dhënat teknike të këtij specifikimi teknik.

Gjithashtu, komisioni nëse e shikon të arsyeshme dërgon mostra e kryen analiza laboratorike pranë laboratorëve të akredituar, duke i krahasuar rezultatet e tyre me rezultatet e analizave të sjella nga OE furnizues.

Afati i lëvrimit: Brenda 90 ditëve nga lidhja e kontratës, por jo më vonë se data 20 dhjetor e vitit planifikues.

Artikulli konsiderohet teknikisht i pranuar kur ai ploteson të gjitha kërkesat e këtij Specifikimi Teknik.

SPECIFIKIME - TEKNIKE

OBJEKTI: 7. “Bluzë e brendshme pambuku mëngë të shkurta (jakë rrethore)” për punonjësit e Gardës së Republikës

Ky specifikim teknik paraqet kërkesat themelore teknike të domosdoshme për prodhimin të artikullit “**Bluzë e brendshme pambuku mëngë të shkurta** (jakë rrethore) “. Në këtë specifikim teknik përcaktohen gjithashtu dhe kërkesat teknike të aksesoreve që shoqërojnë artikullin “**Bluzë e brendshme pambuku mëngë të shkurta** (jakë rrethore)” si produkt i gatshëm .

Për procedurë vlerësimi dhe miratimi nga përdoruesi, ofertuesi është i detyruar të paraqesi si oferte teknike të realizuar sipas kërkesave të këtij specifikimi teknik :

- 1 (një) copë bluzë pambuku me nr gjoksi 50.
Mostra duhet të ketë vulë dhe etiketë origjinale të subjektit prodhues.
 - 1 (një) pjesë trikotazhi me permasa 50 x 50 cm.
 - Fletë-analize laboratorike të treguesve fiziko-mekanik e kimik të lëndës së parë të përdorur nga prodhuesi.
- Copa e mostrës, lëndës së parë dhe ajo që i bashkëngjitet raport-analizës duhet të jenë detyruesisht të njëjta.
- Mos plotësimi nga subjekti prodhues (ofertues) në procedurë vlerësimi i tre kërkesave të mësipërme do të konsiderohet skualifikim teknik.
- Bluzës së pambukut dhe lëndës së parë u qepet nga një etiketë tekstili në të cilën shkruhet: moster “bluzë pambuku me mëngë të shkurta “, emri i ofertuesit, data dhe vula e ofertuesit.

Mungesa e mostrës, lëndës së parë dhe fletë analizës që shoqëron ato është kusht skualifikues.

LENDET E PARA :

Tekstil i trikotuar cilesi parë me ngjyrë të zezë, përbërje 100% pambuk.

Thurja : xhersi (e thjeshtë) 1+1 në trup dhethurje llastik 2+2 në jakë.

Masa : 160 gr/m² (+/- 3%).

Trashësia e tekstili: 0.5 +/- 0.1 mm

Hollësia e fillit : 50/1.

Dëndësia fijeve në 10 cm: vertikale 210+/-8 syth, horizontale 160+/-8 syth

Qëndrueshmëria e ngjyrës : shumë e mirë

Qëndrueshmëri në këputje në kg: vertikale 30+/-3, horizontale 16+/-3.

LËNDËT NDIHMËSE:

Penj qepje Nr.40/2 me ngjyrë të zezë.

QEPJA :

Materiali lenda e parë pritët në drejtim të fijes së bazës, dhe nuk lejohen tonacione të ngjyrës e difekte të tjera në pamjen e jashme.

Bluzat të jenë me jake rrethore me gjerësi 3 cm dhethurje llastik 2+2. Të mos rrije e varur por të puthitet mirë në qafë.

Bashkimi i mëngëve të bluzës me trupin bëhën me makinë speciale (syzator), po kështu edhe mbyllja e mëngëve dhe e fjongove (anesore) bëhët me syzator. Gjatësia e mëngëve të jetë 25 cm.

Bluzat në pjesën e majte të gjoksit kanë të stampuar me ngjyrë të bardhë stemen e Gardës në permasat e percaktuara në specifikimin teknik të përshkruar me poshtë.

Në pjesën e shpatullave ka të stampuar me ngjyrë të bardhë mbishkrimin “GARDA” – shkrimi ”New Times Roman”, me shkronja ”Kapitale” me lartësi 8 cm.

Numrat e këtij artikulli do të jenë: S,M,L,XL,XXL.

Sasia sipas numerave do bëhët mbi bazën e kërkesave të Gardës me lidhjen e kontratës me prodhuesin.

Stema ne anen e majte të gjoksit



LENDET E PARA E NDIHMESE:

Bojë stampimi e bardhë e reziztente të dallohet qartë secili element i stemës.

Qëndrueshmëria e ngjyrave dhe rezistenca në larje e plasaritje të jetë e lartë.

ELEMENTET PËRBËRESE TË STEMËS.

Stema është në formën e një mburoje (shqyti) me permasa 7.5cm x 6 cm +/-0.1 cm. Pjesa e sipërme është e drejtë ndersa e pjesa e poshtme në forme ovale (shqyti).

Stema rrethohet me një kornizë, me gjëresi 2 mm, në qendër të saj është vendosur shqiponja dykrenare, e përdorur si simbol në krijimin e këtij formacioni. Mbi shqiponjë qëndron përkrenarja e Heroit tonë kombëtar, Skënderbeut. Përkrenarja e Skënderbeut është vendosur në pamje ballore. Në këtë pozicion shikohet karakteri i saj laik e qytetar, fisnik e ushtarak. Emblema evidenton ndërthurjen e madhështisë me bukurinë që paraqet ky element në fushën e sematikës Shqiptare. Në pjesën e poshtme në formë ovale shkruhet me shkronja kapitale, me shkrim “Arial” bold, me lartësi 6mm, me ngjyrë të bardhë, fjala “GARDA E REPUBLIKËS”.

Amballazhimi, marketimi dhe etiketimi

Bluzë me mëngë të shkurtëra e kompletuar me të gjitha elementet e percaktuara në këtë Specifikim Teknik marketohet qartë me shkrim me anë të një etikete tekstili të qepur në pjesën e brendshme në qendër të bashkimit të jakës me shpinën dhe që përmban emrin e firmës prodhuese, masën e bluzës dhe vitin e prodhimit. Çdo bluzë duhet të jetë pastruar mirë nga penjet dhe të mos ketë njolla.

Poshtë në anë në pjesën e brendshme të bluzës duhet të vendoset një etikete e veçantë në të cilën shenohen treguesit bazë të lëndës së I-re, të përdorur si dhe me shenja konvencionale trajtimi i bluzës (hekurosje, larje etj).

Bluza me mëngë të shkurtera paloset dhe paketohet në qese celofoni. Bluzat e paketuara futen në kuti kartoni nga 40 copë bluza. Në çdo kuti duhet të vendosen bluza të një mase. Të gjitha kutitë duhet të kenë të njëjtin numer bluzash. Kutitë duhet të jenë të rregullta dhe të shiritizohen duke siguruar mbyllje të mirë. Mbi kutitë vendosen etiketa ku shenohet qartë emri i firmës prodhuese me vulën perkatese, masa e bluzës, sasia dhe viti i prodhimit.

Kolaudimi marrja në dorzim

Pranimi i të gjithë sasisë së artikullit “**Bluzë e brendshme pambuku mëngë të shkurta** (jakë rrethore)” të përcaktuar në kontratë dhe të dorëzuar në magazinën e Gardës, do të bëhet vetëm në bazë të rezultateve që do të merrën gjatë procesit të Kolaudit për të gjithë sasinë e produktit të gatshëm të dorëzuar në magazinë. Kolaudi do të bëhet mbi bazën e rezultateve të Fletë-analizave laboratorike të lëshuara nga Laboratore të Akredituar të Tekstil-Konfeksioneve, që shoqërojnë mallin, të sjella nga kontraktuesi, sipas përcaktimeve në kontratë, dhe ekzaminimit të mallit të furnizuar, që do të bëjë “Komisioni i pritjes, kontrollit dhe pranimi të mallit të Gardës së Republikës”, i cili kryen direkt matjet e vlersimit organoleptike të sasisë së mallit të dorëzuar dhe bën krahasimin e të gjithë këtyre rezultateve me kërkesat dhe të dhënat teknike të këtij specifikimi teknik.

Gjithashtu, komisioni nëse e shikon të arsyeshme dërgon mostra e kryen analiza laboratorike pranë laboratorëve të akredituar, duke i krahasuar rezultatet e tyre me rezultatet e analizave të sjella nga OE furnizues.

Afati i lëvrimit: Brenda 90 ditëve nga lidhja e kontratës, por jo më vonë se data 20 dhjetor e vitit planifikues.

Artikulli konsiderohet teknikisht i pranuar kur ai plotëson të gjitha kërkesat e këtij Specifikimi Teknik.

SPECIFIKIM TEKNIK

OBJEKTI : 8. “Bluzë brendshme pambuku mëngë të gjata” për punonjësit e Gardës së Republikës

Ky specifikim teknik paraqet kërkesat themelore teknike të domosdoshme për prodhimin e artikullit “Bluzë pambuku mëngë të gjata”. Në këtë specifikim teknik përcaktohen gjithashtu dhe kërkesat teknike të aksesoreve që shoqërojnë artikullin “Bluzë pambuku mëngë të gjata” si produkt i gatshëm duke realizuar kompletimin e plotë të tyre.

Të gjitha përcaktimet teknike të këtij specifikimi teknik duhen të zbatohen detyrimisht saktë nga prodhuesi.

Për procedurë vlerësimi dhe miratimi nga përdoruesi, ofertuesi është i detyruar të paraqesi si ofertë teknike të realizuar sipas kërkesave të këtij specifikimi teknik :

- 1 (nje) copë “bluzë pambuku mëngë të gjata” me nr gjoksi 50.

Mostra duhet të kenë vulë dhe etikete origjinale të fabrikës prodhuese.

- 1 (nje) pjesë trikotazhi me permasa 50 x 50 cm.

- Fletë-analizë laboratorike të treguesve fiziko-mekanik e kimik të lëndës së parë të përdorur nga prodhuesi.

Copa e mostres, lëndës së parë dhe ajo që i bashkëngjitet raport-analizës duhet të jenë detyrimisht të njëjta.

Mos plotësimi nga subjekti prodhues (ofertues) në procedurë vlerësimi i tre kërkesave të mësipërme do të konsiderohet skualifikim teknik.

Bluzës së pambukut dhe lëndës së parë u qepet nga një etikete tekstili në të cilën shkruhet: moster “bluzë pambuku me mëngë të gjata”, emri i ofertuesit, data dhe vula e ofertuesit.

Mungesa e mostres, lëndës së parë dhe fletë analizës që shoqëron ato është kusht skualifikues.

LENDET E PARA E NDIHMESE:

PERBERJA: Trikotazh me ngjyrë të zezë, tekstil i trikotuar cilesi parë methurje tutë dyshtresore, me push nga brenda, 100% pambuk.

MASA : 290 gr/m² (+/- 3%).

THURJA : tutë dyshtresore në trup, gjysëm golfi thurje llastik 2+2.

QENDRUESHMERIA E NGJYRES : Shumë e mirë.

Trashësia e tekstilit: 1,3 mm.

Penj qepje: Nr.40/2 me ngjyrë të zezë.

Materiali për bluzat e trikotazhit priten në drejtim të fijes së bazës, dhe nuk lejohen tonacione të ngjyrës e difekte të tjera në pamjen e jashme. Bluza me jake rrethore gjysëm golfi me gjerësi 4-5cm dhe thurje llastik 2+2. Bluza në pjesën e majtë të gjoksit kanë të stampuar me ngjyrë të bardhë stemen e Gardës. Në pjesën e shpatullave ka të stampuar me ngjyrë të bardhë mbishkrimin “GARDA” – shkrimi “New Times Roman”, me shkronja ”Kapitale”, me lartësi 8 cm.

Bashkimi i mëngëve me trupin bëhen me makine speciale (syzator) , po kështu mbyllja e mëngëve dhe e fjangove (anësore) bëhet me syzator. Mëngët e bluzave në fund bëhen me thurje llastik.

Artikulli “**Bluzë brendshme pambuku mëngë të gjata**” prodhohet dhe porositet nga perdoruesi në sasi të përkatëse sipas masave të gjokseve **S , M , L , XL , XXL** të cilat subjekti prodhues është i detyruar ta respektojë saktësisht. Përmasat e duhura të elementëve të cilat bëjnë pjesë në ndertimin e artikullit “**Bluzë pambuku me mëngë të gjata**” jepen në përshkrimet, tabelat dhe figurat e mëposhtme.

Bluzë brendshme pambuku mëngë të gjata produkt i gatshëm prodhohet me përmasat (**cm**) të dhena në **Tabelen Nr.1** si më poshtë :

a -- gjatësia e bluzës e matur nga jaka e qafës deri në fund

b -- gjatësia e mëngës e matur nga pika me e lartë e tegelit të supit deri në fund

c -- gjysma e rrethit të gjoksit

d -- gjerësia e shpines e matur mbrapa lart tek shpatullat

e -- gjysma e perimetrit të hapjes së poshtme të mëngës

f -- bashkimi i mëngës

g -- gjatësia e supit e matur nga supi deri tek bashkimi i jakës

m --hapja lart e jakës (perimetri i jashtëm)

Tabelen Nr.1

masa	S	M	L	XL	XXL	tol.
përmasa						+/- cm
a	68	71	73	75	76	1
b	58	59	60	61	62	1
c	45	49	52	55	58	0.5
d	44	46	48	50	52	1
e	9	9.5	10	11	12	0.5
f	25	26	27	28	29	0.5
g	15	15.5	16	16.5	17.5	0.5
m	16.5	17	17.5	18	19	0.5

Numrat e këtij artikulli do të jenë nga S deri XXL.

Sasia sipas numerave do bëhet mbi bazën e kërkesave të Gardës me lidhjen e kontrates me prodhuesin.

Stema ne anen e majte te gjoksit

SPECIFIKIM TEKNIK_: Stema e Gardës



LENDET E PARA E NDIHMESE:

Bojë stampimi e bardhë e reziztente të dallohet qartë secili element i stemës.

Qëndrueshmëria e ngjyrave dhe rezistenca në larje e plasaritje të jetë e lartë.

ELEMENTET PËRBËRESE TË STEMËS.

Stema është në formën e një mburoje (shqyti) me permasa 7.5cm x 6 cm +/-0.1 cm. Pjesa e sipërme është e drejtë ndersa e pjesa e poshtme në forme ovale (shqyti).

Stema rrethohet me një kornizë, me gjëresi 2 mm, në qendër të saj është vendosur shqiponja dykrenare, e përdorur si simbol në krijimin e këtij formacioni. Mbi shqiponjë qëndron përkrenarja e Heroit tonë kombëtar, Skënderbeut. Përkrenarja e Skënderbeut është vendosur në pamje ballore. Në këtë pozicion shikohet karakteri i saj laik e qytetar, fisnik e ushtarak. Emblema evidenton ndërthurjen e madhështisë me bukurinë që paraqet ky element në fushën e sematikës Shqiptare. Në pjesën e poshtme në formë ovale shkruhet me shkronja kapitale, me shkrim "Arial" bold, me lartësi 6mm, me ngjyrë të bardhë, fjala "GARDA E REPUBLIKËS".

Amballazhimi, marketimi, etiketimi.

Bluza pasi të jetë pastruar mirë nga penjte, paiset me një etiketë të qepur në pjesën e brendshme të tyre në bashkimin e jakes me shpinën e cila permban numrin e gjoksit. Gjithashtu ka një etiketë që permban trajtimin e tyre, me shenja konvencionale.

Bluza paloset dhe paketohet në qese celofoni nga dy copë në secilën qese të të njejtit numër. Bluzat e paketuara futën në kuti kartoni nga 40 copë bluza secila. Në çdo kuti duhet të vendosën bluza të një mase. Kutite duhet të jenë të rregullta dhe të shiritizohen duke siguruar mbyllje të mirë. Mbi kutitë vendosën etiketa ku shënohet qartë emri i firmës prodhuese me vulen përkatëse, masa e bluzës, sasia dhe viti i prodhimit.

Transportimi: Transportimi do të bëhet me mjete të pershtateshme për tu mbrojtur nga agjentet atmosferik.

Afati i lëvrimit: Brenda 90 ditëve nga lidhja e kontratës, por jo më vonë se data 20 dhjetor e vitit planifikues.

Kolaudimi marrja në dorzim

Pranimi i të gjithë sasisë të artikullit “Bluzë pambuku mëngë të gjata” të përcaktuar në kontratë dhe të dorëzuar në magazinën e Gardës, do të bëhet vetëm në bazë të rezultateve që do të merrën gjatë procesit të Kolaudit për të gjithë sasinë e produktit të gatshëm të dorëzuar në magazinë. Kolaudimi do të bëhet mbi bazën e rezultateve të Fletë-analizave laboratorike të lëshuara nga Laboratore të Akredituar të Tekstil-Konfeksioneve, që shoqërojnë mallin, të sjella nga kontraktuesi, sipas përcaktimeve në kontratë, dhe ekzaminimit të mallit të furnizuar, që do të bëjë “Komisioni i pritjes, kontrollit dhe pranimi të mallit të Gardës së Republikës”, i cili kryen direkt matjet e vlersimet organo-leptike të sasisë së mallit të dorëzuar dhe bën krahasimin e të gjithë këtyre rezultateve me kërkesat dhe të dhënat teknike të këtij specifikimi teknik.

Gjithashtu, komisioni nëse e shikon të aryeshme dërgon mostra e kryen analiza laboratorike pranë laboratorëve të akredituar, duke i krahasuar rezultatet e tyre me rezultatet e analizave të sjella nga OE furnizues.

Kujdes :Ngjyra e germave nuk duhet të fshihet gjatë provës të ferkimit në të thatë dhe në të njomë me një copë të bardhë.

Bluza me mëngë të gjata duhet të jetë simetrike në të gjithë elementët e saj. Ato janë të njëjtat në model si për meshkuj ashtu dhe për femra.

Artikulli konsiderohet teknikisht i pranuar kur ai ploteson të gjitha kërkesat e këtij specifikimi teknik.

S P E C I F I K I M E - T E K N I K E

OBJEKTI: 9.“Kemisha mëngë të gjata” për punonjësit e Gardës së Republikës.

Ky specifikim teknik paraqet kërkesat themelore teknike të domosdoshme të artikullit “Kemisha mëngë të gjata”.

Në këtë specifikim teknik përcaktohen gjithashtu dhe kërkesat teknike të aksesoreve që shoqërojnë artikullin “Kemisha mëngë të gjata” si produkt të gatshëm .

Të gjitha përcaktimet teknike të këtij specifikimi teknik duhen të zbatohen detyrimisht saktë nga prodhuesi.

Për procedurë vlerësimi dhe miratimi nga perdoruesi, ofertuesi është i detyruar të paraqesi si ofertë teknike të realizuar sipas kërkesave të këtij specifikimi teknik :

- 1 (një) copë kemishë me nr jake 40.
- 1 (një) pjesë puplinë me permasa 50 x 50 cm.
- Fletë-analize laboratorike të treguesve fiziko-mekanik e kimik të lëndës së parë të perdorur nga prodhuesi.

Copa e mostres, lëndës së parë dhe ajo që i bashkëngjitet raport-analizes duhet të jenë detyrimisht të njëjta.

Kemishes dhe lëndës së parë u qepet nga një etikete tekstili në të cilën shkruhet: moster “kemishe me mëngë gjata”, emri i ofertuesit, data dhe vula e ofertuesit.

Mungesa e mostres, lëndës së parë dhe fletë analizes që shoqëron ato është kusht skualifikues.

LËNDËT E PARA : Tekstil me ngjyrë e bardhë me përbërje (+/-3%) : 80% pambuk 20% poliester

THURJA: Garniturë.

MASA: 120 gr/m² (±3%)

DENDËSIA fijeve në 10 cm: Në bazë 450+/-10, në ind 300+/-10.

Qëndrushmeria në kg: në bazë 70, në ind 40.

Qëndrushmeria e ngjyrës : shumë e mirë

Materialet Ndihmëse: që duhet të përdoren për prodhimin e artikullit “Kemishë me mëngë të gjata” janë :

- **Fortesë** jake me kollaritje të plotë, fortesë mansheti për mëngët me kollaritje të plotë
- **Frazelinë**
- **Kopsa plastike** (11 copë), me përbërje 100% poliester, me ngjyrë të bardhë , me diametër 12mm, me katër vrima
- **Penj qepje**, Nm 120, 100% PES me ngjyrë të bardhë

Elementet Velcro femër (me ngjyrë të bardhë) për vëndosjen:

- **E shenjës së mbiemrit:** Siper në gjoksin e djathtë vendoset velkrof femër në formë drejtëkëndeshi 8.5 cm x 2.5 cm, me ngjyrë të përtaft me tekstilin e kemishës për vëndosjen e mbiemrit.
- **E Stemes së Republikës dhe Stemes së Gardës**, velkrof femër në mëngë, me përmasa 7.5 cm x 6 cm +/-0.1 cm, pjesa e sipërme është e drejte ndersa e pjesa e poshtme në formë ovale (shqyti) me distancë rreth 7-8 cm nga gavatura e mëngës

Këmishë me mëngë të gjata uniforme, kompletohet me:

- **Steme e Republikës** me velkrof mashkull (sipas specifikimeve të dhëna)
- **Steme Garde** me velkrof mashkull (sipas specifikimeve të dhëna)

Në lëndën e parë nuk lejohen difekte të pamjes së jashtme njolla të ndryshme, tonacione ngjyrë, oksidime, rrudhosje , mungesë apo trashim fijesh në ind e në bazë, lekundje të gjëresisë etj.

Kemishat janë me jaka të mbyllura me kollaritje të plotë.

Mëngët e gjata bëhen me kapake janë të hapur anash. Kapaket janë me kollaritje. 7-8 cm poshte qepjes se bashkimit të mëngëve me trupin e matur nga pika me e larte e supit i vendosen velkrof femer në ngjyrë të bardhë për ngjitjen e “Stema e Republikës” (sipas specifikimeve teknike te saj bashkelidhur) dhe “Stema e Gardes”(sipas specifikimeve teknike te saj bashkelidhur).

Bashkimi i mëngëve dhe fjongove anesore bëhet me syzator.

Kemishat kanë nga 11 vrima, 7 në përparesen e majtë, nga një në kapaket e xhepave dhe nga një në kapaket e mëngëve.

Kopsat qepen me makinë.

Pjesa e shpines është me supanjë me gjatësi 10-12 cm nën jakë. Supanja është e ndertuar me dy copa një në pjesen e brëndëshme dhe një në pjesen e jashtme. Supanja ka dy penca të cilat janë të barazlanguara nga dy anesoret e mëngëve.

Në të dy anesoret e fjongove kemishat janë të shkurtera 4-5 cm duke formuar një hark në anësore. Pjesa fundore e kemishes përshkohet nga një tegel i thjeshtë. Çdo fillim e mbarim tegeli të jetë i forcuar. Tegelat të jenë të drejtë e pa nderprerje.

Gjoksi - Kemishat te jene pa bordure perpara. Mberthimi i kemishes behet me 7 kopsa plastike te qepura ne perparesen e djathte te cilave u korespondojne vrimat ne perparesen e majte per meshkujt dhe te qepura ne perparsen e majte dhe me vrimat koresponduse ne perparsen e djathte per femrat. Kopsa e pare qepet ne kthimin e jakes dhe jane te baraslarguara nga njera tjetra 0.9 -10.5 cm (ne varsi të numerit të këmishës).

Xhepat në gjoksin e këmishës janë pllakë me permasa 14 x 16 cm. Xhepat ne te dy anet poshte jane me cepa me forme te prere. Xhepat ne mes kane nje palosje me gjeresi 3 cm ne mesin e te ciles lart vendoset nje kopse e vogel plastike me ngjyre të bardhë, qe sherben per mbylljen e xhepit. Xhepave u kalohet nje tegel zbukurimi 0.5 cm larg buzeve. Xhepat mbyllen me kapak.

Kapaket jane ne forme drejtkendeshi dhe me nje vrimë ne mes. Kapaket perbehen nga pjesa e sipërme dhe e poshtme. Pjeses se sipërme te kapakut per perforcim i vendoset kollaritje (material tekstili ngjites ne ngjyre te bardhe). Duhet bere kujdes qe cepat e kapakut te mos jene te rrumbullakta por me kende te drejte dhe te kene pamje estetike. Kapakut i kalohet nje tegel zbukurimi 5 mm larg buzeve.

Mbi kapakun e xhepit te djathte ne qender vendoset velkrof femer ne ngjyre te bardhë ne forme drejtekendshi me permasa 8.5 cm x 2.5 cm qe do te sherbeje per vendosjen e mbiemrit.

Në supe vendosen dy ylyqe per montimin e gradave te supit ne forme spalette.

Ylyqet me permasa 4 x 1 cm qepen ne menyre te tille qe mesi i ylykut te jete mbi tengelin e bashkimit te shpines me gjoksin. Ylyku i pare qepet 1 cm nga tengeli i rrethit te menges (gavatura). Ylyku i dyte qepet 8 cm nga ylyku i pare.

Qepja e kemishës të jetë speciale e realizuar në linje industriale të mekanizur.

Numrat e kemishëve të jenë nga 35 deri 45.

Sasia sipas numerave do të bëhet në bazën e kërkesave të Gardës me lidhjen e kontratës me prodhuesin.

Përmasat e kemishëve janë:

EMERTIMI	NUMRAT E JAKES							
	35	36	37	38	39	40	41	Shmangia
Gjatësia e kemishës në cm.	80	80	82	84	84	84	84	1.5
Gjatësia e mëngës në cm	58	58	58	62	62	62	62	1
Rrethi i gjoksit në cm	50	52	54	56	58	58	60	1.5
Shpatulla në cm	42	43	44	44.5	45.8	45.8	47.2	1

STEMA E REPUBLIKËS (Shenjë krah)

Lëndët e para e ndihmëse:

Material i hollë e reziztent tekstili i qendisur me penjë sipas ngjyrave të çdo elementi të stemës.

Stemës mbas qendisjes i qepet velkrof mashkull, me të njejtat permasa , duke e realizuar si një trup të vetem.

Qendrueshmeria e ngjyrave dhe rezistenca në keputje të jete e lartë.

Elementët përbërës të stemës.

Stema është në formen e një mburoje me permasa 7.5 x 6 cm +/-0.1 cm.

Pjesa e sipërme është e drejtë ndersa e pjesa e poshtme në formë ovale (shqyti). Fusha është në ngjyrë të kuqe në mes të së cilës gjëndet shqiponja dykrenare e qendisur me penj me ngjyrë

të zezë mbi të cilën në qendër vëndoset perkrenarja e Skenderbeut qëndisur me penj ngjyrë ari, në profil me pamje nga e djathta.

Stema rrethohet me një kornizë qëndisur me penj ngjyrë ari të vijeuar me gjerësi 2 mm. Stema në terësi si dhe gjithë elementët përbërës të saj të jenë rezistente ndaj gjithë faktoreve atmosferike. Po kështu dhe qëndrueshmëria e ngjyrave të jetë shumë e mirë. Stema vëndoset në krahun e majtë me anë të një velkrofi femer- mashkull.



STEMA E GARDËS SË REPUBLIKËS (Shenjë krah)

Lëndët e para e ndihmëse:

Material i hollë e rezistent tekstili i qëndisur me penjë sipas ngjyrave të çdo elementi të stemës.

Stemës mbas qëndisjes i qepet velkrof mashkull, me të njëjtat permasa, duke e realizuar si një trup të vetëm.

Qëndrueshmëria e ngjyrave dhe rezistenca në keputje të jete e lartë.

Elementët përbërës të stemës.

Stema është në formën e një mburoje (shqyti) me permasa 7.5cm x 6 cm +/-0.1 cm. Pjesa e sipërme është e drejtë ndërsa e pjesa e poshtme në formë ovale (shqyti).

Stema rrethohet me një kornizë ngjyrë ari, me gjëresi 2 mm, në qendër të saj është vëndosur shqiponja e zezë dykrenare, e përdorur si simbol në krijimin e këtij formacioni. Mbi shqiponjë qëndron perkrenarja e Heroit tonë kombëtar, Skënderbeut, në ngjyrë të artë. Perkrenarja e Skënderbeut është vëndosur në pamje ballore.

Duke qenë se stema shërben edhe si shenjë krah për gardistët në pjesën harkore të shqytit, është shkruar me gërma kapitale, në ngjyrë të artë, me shkrim “Arial” bold, me lartësi 6 mm “GARDA E REPUBLIKËS”.

Stema në terësi si dhe gjithë elementet përbërës të saj të jenë rezistentë ndaj gjithë faktoreve atmosferike. Po kështu dhe qëndrueshmëria e ngjyrave e copës dhe penjëve të përdorur të jetë shumë e mirë.



Amballazhimi, marketimi, etiketimi.

Çdo kemishë pasi të jetë pastruar mirë nga penjtë, paiset me një etiketë të qepur në pjesën e brëndshme të saj në bashkimin e jakës me shpinën e cila përmban numrin e jakës. Gjithashtu ka një etiketë që përmban trajtimin e kemishës (larje hekurosje etj) me shenja konvencionale. Çdo kemishë ndërmjet shpinës e gjysmës së trupit nga mbrapa deri poshtë jakes nga poshtë u vendoset karton, po kështu rreth e qark qafes vendoset shirit plastik i fortë i fiksuar në kopsen e parë. Kemishat mberthehen me gjilpera me kokë, palosen dhe futen në qese të tejdukshme pastaj futen në kuti kartoni në ato sasi që përcaktohen në kontratë. Kutite paisen me etiketa ku shenohet emertimi, numri i jakes, sasia .

Afati i lëvrimit: Brenda 90 ditëve nga lidhja e kontratës, por jo më vonë se data 20 dhjetor e vitit planifikues.

KOLAUDIMI MARRJA NE DORZIM

Pranimi i të gjithë sasisë së artikullit “Kemishë me mëngë të gjata” të përcaktuar në kontratë dhe të dorëzuar në magazinën e Gardës, do të bëhet vetëm në bazë të rezultateve që do të marrën gjatë procesit të Kolaudit për të gjithë sasinë e produktit të gatshëm të dorëzuar në magazinë. Kolaudimi do të bëhet mbi bazën e rezultateve të Fletë-analizave laboratorike të lëshuara nga Laboratore të Akredituar të Tekstil-Konfeksioneve, që shoqërojnë mallin, të sjella nga kontraktuesi, sipas përcaktimeve në kontratë, dhe ekzaminimit të mallit të furnizuar, që do të bëjë “Komisioni i pritjes, kontrollit dhe pranimi të mallit të Gardës së Republikës”, i cili kryen direkt matjet e vlersimet organo-leptike të sasisë së mallit të dorëzuar dhe bën krahasimin e të gjithë këtyre rezultateve me kërkesat dhe të dhënat teknike të këtij specifikimi teknik.

Gjithashtu, komisioni nëse e shikon të arsyeshme dërgon mostra e kryen analiza laboratorike pranë laboratorëve të akredituar, duke i krahasuar rezultatet e tyre me rezultatet e analizave të sjella nga OE furnizues.

Artikulli konsiderohet teknikisht i pranuar kur ai ploteson të gjitha kërkesat e këtij Specifikimi Teknik.

SPECIFIKIME - TEKNIKE

OBJEKTI: 10. “Pelerinë shiu” për punonjësit e Gardës së Republikës.

Ky specifikim teknik në mënyrë të detajuar paraqet kërkesat themelore teknike të domosdoshme të artikullit “Pelerin shiu”. Në këtë specifikim teknik përcaktohen gjithashtu dhe kërkesat teknike të aksesoreve që shoqërojnë artikullin “Pelerin shiu” si produkt i gatshëm .

Të gjitha përcaktimet teknike të këtij specifikimi teknik duhen të zbatohen detyrimisht saktë nga prodhuesi.

Për procedurë vlerësimi dhe miratimi nga perdoruesi, ofertuesi është i detyruar të paraqesi si ofertë teknike të realizuar sipas kërkesave të këtij specifikimi teknik :

- 1 (një) copë “pelerin shiu” me masë gjoksi M.

Mostra duhet të kenë vulë dhe etikete origjinale të fabrikes prodhuese.

- 1 (një) pjesë Pelhurë impermeable (tekstil i gomuar) 100 % poliamid me lluster nga brënda, mostër me permasa 50 x 50 cm.

- Fletë-analize laboratorike të treguesve fiziko-mekanik e kimik të lëndës së parë të perdorur nga prodhuesi.

Copa e mostres, lëndës së parë dhe ajo që i bashkëngjitet raport-analizes duhet të jenë detyrimisht të njejta.

Pelerinës si dhe lendes parë u qepet nga një etiketë tekstili në të cilën shkruhet: muster “pelerin shiu”, emri i ofertuesit, data dhe vula e ofertuesit.

Mungesa e mostres, lëndës parë dhe fletë analizes që shoqeron ato është kusht skualifikues.

Karakteristikat e përgjithëshme

Ngjyra : E zezë.

Lenda e pare : Material ngjyrë e zezë 100 % nylon e veshur me shtresë poliuretani nga brenda.

Masa : 130 gr /m² (±3%)

Thurja : Oxford.

Depërtueshmëria e ujit dhe aftësi ajërosëse e tekstilit mbi 20,000mm / 15,000 gr

Qendrueshmëria në kg : Në bazë: jo më pak se 90.

Në ind: jo më pak se 85.

Qendrueshmëria e ngjyrës: Shumë e mirë,

Tekstili nuk duhet të ketë aroma të pakëndshme dhe nuk duhet të jetë i ashpër.

MATERIALET NDIHMESE :

- Penj qepje polyester ngjyre e zeze,
- kopsa ebaniti të zeza,
- susta (butona femer-mashkull),
- ngjites.
- Llastik tubolar me element plastikë me ngjyrë të zezë, 100% polyester, me perimenter 3 mm, për kapuçin e mushamasë.

Materiali (lenda e pare) që përdoret për pelerinen e shiut të jete i padepertueshem nga uji, nuk lejohen tonacione ngjyrash ose defekte të tjera në sipërfaqe si njolla të ndryshme, oksidime, rrudhosje, mungese apo trashim fijesh etj.

Materiali të jete rezistent ndaj agjenteve të ndryshme atmosferike (temperatures etj.)

Pelerina behen me minge të gjata dhe kapuç.

Prodhiimi i artikullit “**Pelerine shiu**” duhet të realizohet sipas një procesi teknologjik të përcaktuar mbi bazën e kërkesave dhe kushteve teknologjike të sakta në secilën fazë të realizimit të tij. Prodhiimi ndahet në tre faza kryesore të cilat janë :

- përpunimi përgatitor
- konfeksionimi (procesi i qepjes)
- Ambalazhimi, marketimi dhe etiketimi

Përpunimi përgatitor ka të bëjë me kontrollimin e lendeve të para dhe ndihmese, skicimin, prerjen në prestari, marketimin dhe kontrollin e pjesëve të pelerines.

Konfeksionimi ka të bëjë me qepjen e pjesëve të pelerines sipas një procesi linear të përcaktuar. Në fazën e ndërmjetme të këtij procesi do të kryhet hekurosja dhe presimi me avull i gjysëm produkteve. Në përfundim kryhet dhe hekurosja e produktit të gatshëm.

Ambalazhimi ka të bëjë me etiketimin, ambalazhimin për çdo produkt dhe ambalazhimin total të gjithë sasisë të produktit të gatshëm dhe përgatitjen e tij për lehtësimin drejt magazinave të përdoruesit.

Skicimi

Ky proces duhet të realizohet me metodat matematikore të programimit linear të cilat sigurojnë një shenim të sakte të prerjeve dhe shenjave sipas vizatimeve duke pasur kujdes që detajet e pelerinës duhet të jenë në drejtim të fijeve të bazës.

Prerja

Procesi i prerjes duhet të bëhet me shumë kujdes që të mos të ketë devijime në fletet e fundit të dyshekut i cili është mirë që të mos të kalojë 80 flete. Kujdes duhet të bëhet dhe në pjesët e harkuara të detajeve dhe buzët e prera të mos jenë me dhembje.

Marketimi

Ky proces është shumë i rëndësishëm sepse eliminon qepjen e detajeve të pelerinës me tonacione të ndryshme duke siguruar një llojshmeri në ngjyrë të artikullit.

NDERTIMI I PELERINËS (mushamasë)

Pelerina e shiut duhet të ketë prerje pardsyje dhe duhet të qepet me tekstil prej najloni të padepërtueshëm nga uji dhe era.

Pjesët përbërëse të pelerinës:

- Dy pjesët e përparme
- Pjesa e pasme
- Jaka
- Dy mëngë të gjata të tipit *raglan*
- Një kapuç i lëvizshëm

Të gjithë tegelat qepës të pelerinës duhet të përforcohen me shirita me termosaldim.

Jaka e pelerinës duhet të jetë 10 cm e lartë. Ajo duhet të jetë me gjuhëz dhe mbyllja e saj duhet të bëhet me element velcro femer/mashkull. Përmasat e gjuhëzës duhet të jenë 10 x 2.5 cm, ndërsa ato të elementit velcro 4 x 2 cm.

Mbyllja e pelerinës duhet të bëhet me anë të 5 perçinave metalike. Bordura e perçinave duhet të jetë e mbuluar me kapak me gjerësi 6 cm. Buza e kapakut duhet të përshkohet nga një tegel linear një gjilpërësh me distancë 5 mm.

Mbi kapak duhet qepur shiriti reflektiv me gjerësi 5 cm.

Xhepat. pelerina duhet të pajiset me dy xhepa të brendshëm me kapak me gjerësi 19 cm. Përmasat e astarit të xhepit duhet të jenë 19 x 20 cm.

Kapuçi duhet të kapet tek jaka me 3 perçina metalike. Kapuçi duhet të jetë i pajisur me llastik tubular dhe me rregullator plastik për shtrëngimin e tij.

Mëngët duhet të jenë të llojit *raglan* dhe të qepen me trupin me tegel linear një gjilpërësh. Mëngët duhet të pajisen me perçina tek parakrahët për shtrëngim.

Tek zona e manshetave duhet të qepet shiriti reflektiv me gjerësi 5 cm.

Mëngët dhe fundi i pelerinës duhet të mbyllen me një palosje të brendshme me lartësi 2 cm me tegel linear një gjilpërësh.

Çanta e pelerinës Çdo pelerinë pajiset me çante me kapak që mbyllet me velkrof ose ylyk me kopse. Çanta bëhet prej të njëjtit material me përmasa 20 x 20 + 3 cm kapak.

Çanta në anën e pasme ka një verigë me gjatësi 10 cm dhe gjerësi 3 cm e cila shërben për vendosjen e saj në rripin e mesit gjatë kohës që nuk është në përdorim. Nga ana e brendshme, në bashkimin e perparseve, shpines, jakës e kapuçit i vihet shirit nga i njëjti material me ngjytje për mosdepertimin e ujit në vendet e qepura.

Pelerina e shiut duhet te jete simetrik ne te gjithë elementet perberes te saj.

Pelerina e shiut ne model eshte e njejte si per **meshkuj** ashtu dhe per **femra**.

Tegelat e qepjes te elementeve perberes te pelerines duhet te jene dysh te realizuara me dygjilperesh dhe me hap **30** shpime ne **5 cm**. Tegelat duhet te jene te forte, uniforme, te mos kene vende te shqepura, te jene simetrike, te rregullt dhe te drejte. Tegelat duhet jene te forte ne menyre te tille qe te mos hapen nen ushtrimin e forces se duarve. Fortesia e tegelave te jete mbi **12 kG**. Tegelat duhet te jene te perforcuar ne fund. Peri qe do te perdoret per qepje duhet te jete i forte dhe me ngjyre te zezë me **Nm 80/2 ,100 % PES**.

MARKETIMI :

Çdo pelerine pajiset me etikete te qepur ne pjesen e brendshme te saj, ku te kete te shenuar numrin e gjoksit dhe prerjen.

AMBALLAZHIMI :

Çdo pelerine paloset ne madhesine e çantes , futet ne te. Vendosen ne kuti kartoni me 20 cope secila. Ne çdo kuti vendosen pelerina te nje numri.

Artikulli **“Pelerine shiu”** prodhohet dhe porositet nga perdoruesi ne sasite perkatese sipas masave te gjokseve **S , M , L , XL , XXL** te cilat subjekti prodhues eshte i detyruar ta respektojë saktesisht. Permasat e duhura te elementeve te cilat bejne pjese ne ndertimin e artikullit **“Pelerine shiu”** jepen ne pershkrimet, tabelat dhe figurat e meposhteme.

Pelerine shiu permasat produkt i gatshem (cm) jepen ne kete table :

Gjatesia e trupit	Prerja	Iniciali prerjes	Gjatesia e pelerines produkt i gatshem
150 – 165	e pare	I	120
166 – 176	e dyte	II	126
177 - 190	e trete	III	132

Sasia sipas numerave do bëhet mbi bazën e kërkesave të Gardës me lidhjen e kontratës me prodhuesin.

Afati i lëvrimit: Brenda 90 ditëve nga lidhja e kontratës, por jo më vonë se data 20 dhjetor e vitit planifikues.

Kolaudimi e marrja në dorzim.

Pranimi i te gjithë sasise te artikullit “Pelerinë shiu” të përcaktuar në kontratë dhe të dorëzuar në magazinën e Gardës, do të bëhet vetëm në bazë të rezultateve që do të merrën gjatë procesit të Kolaudit për të gjithë sasinë e produktit të gatshëm të dorëzuar në magazinë. Kolaudimi do të bëhet mbi bazën e rezultateve të Fletë-analizave laboratorike të lëshuara nga Laboratore te Akredituar te Tekstil-Konfeksioneve, që shoqërojnë mallin, të sjella nga kontraktuesi, sipas përcaktimeve në kontratë, dhe ekzaminimit e të mallit të furnizuar, që do të bëjë “Komisioni i pritjes, kontrollit dhe pranimit të mallit të Gardës së Republikës”, i cili kryen direkt matjet e vlersimet organo-leptike të sasise së mallit të dorëzuar dhe bën krahasimin e të gjithë këtyre rezultateve me kërkesat dhe të dhënat teknike të ketij specifikimi teknik.

Gjithashtu, komisioni nëse e shikon të aryeshme dërgon mostra e kryen analiza laboratorike pranë laboratorëve të akredituar, duke i krahasuar rezultatet e tyre me rezultatet e analizave të sjella nga OE furnizues.

Artikulli konsiderohet teknikisht i pranuar kur ai ploteson te gjitha kerkesat e ketij specifikimi teknik.

SPECIFIKIME - TEKNIKE

OBJEKTI: 11. “Rrip mesi” për punonjësit e Gardës së Republikës

Specifikimi teknik i artikullit, “**Rrip mesi**” për punonjësit e Gardës së Republikës paraqet kerkesat themelore teknike te domosdoshme si dhe kerkesat cilesore të ketij artikulli.

Për procedure vleresimi dhe miratimi nga perdoruesi, ofertuesi është i detyruar të paraqesi si ofertë teknike të realizuar sipas kerkesave të ketij specifikimi teknik :

- 1 (një) copë “Rrip mesi”

Rripit i qepet një etikete tekstili në të cilen shkruhet: moster “Rrip mesi”, emri i ofertuesit, data dhe vula e ofertuesit.

Mungesa e mostres është kusht skualifikues

• KARAKTERISTIKA TE PËRGJITHSHME

Ngjyra : E zezë

Përbërja: Materiali tekstil i perforcuar ”Cordura” poliamid, me trashesi 5 mm.

Gjatësia: 145 (± 3 cm).

Gjerësia: 4.5 cm.

• KARAKTERISTIKAT E PËRBËRËSEVE TË RRIPIT

- Karakteristikat e Cordura 1100 :

Poliamid 100% me rrahje 10 fill 12 për MT. 302

Ngarkesa në shkatrrim në drejtim horizontal (të bazës) - 840 kg/Pa

Ngarkesa në shkatrrim në drejtim vertikal (të indit) - 700 kg/Pa

Zgjatueshmeria në tërheqje në drejtim horizontal e vertikal L e T 140%

- Karakteristikat e Rezine acetallike (Materiali plastic i togzes)

Qëndrueshmeria në keputje në 23 °C	MPa	64
Zgjatimi në keputje në 23 °C	%	24
Modulet e perkuljes	MPa	2800
Tempratura mesatare	°C	- 40/+100 °C
Përthithja e lageshtires	%	0.65
Rezistenca mekanike e një materiali ndaj ushtrimit të një trupi me peshë të caktuar.	MPa	143

- **Ngjitsi velcrof** - Velcro

- **Filli qepes** - GERAL 100% poliesther.

Mbërthimi i rripit të realizohet me togëz ebaniti me ngjyrë te zezë. Togza përbëhet nga dy elemente (një mashkull dhe një femer) që nderfuten të njeri-tjetri dhe realizojne mbylljen e rripit. Ky sistem është i thjeshte dhe menaxhueshm gjithashtu lejon dhe një zberthim të shpejte në rast nevojje.

Rripi në të gjithë gjatësinë e tij ka një shtresë perforcuese "Cordura" poliamid, me trashësi 5 mm. Ai duhet të jetë i manovrueshëm në shterngimin apo lirimin e gjatësisë së rripit e cila realizohet nëpërmjet velkrofeve femër – mashkull me gjatësi 25 cm secila të vendosura në të dy ekstremet e rripit, dhe dy unaza (rripa sigures) të levizshme që sigurojnë mbylljen e rripit sipas gjatësisë së nevojshme.

Rripi, rreth e qark tij ka një veshje tekstili të butë, të qepur me një tegel me fill qepes GERAL 100% poliestër.

Mbërthimi dhe zberthimi i pjesës së togzës të jetë i lehtë e funksional gjatë përdorimit.

Amballazhimi në kuti kartoni me etiketa përkatëse të firmës furnizuese.

Afati i lëvrimit: Brenda 90 ditëve nga lidhja e kontratës, por jo më vonë se data 20 dhjetor e vitit planifikues.

Kolaudimi marrja në dorëzim.

Pranimi i të gjithë sasisë të artikullit "Rip mesi" të përcaktuar në kontratë dhe të dorëzuar në magazinën e Gardës, do të bëhet vetëm në bazë të rezultateve që do të merrën gjatë procesit të Kolaudit për të gjithë sasinë e produktit të gatshëm të dorëzuar në magazinë. Kolaudimi do të bëhet mbi bazën e rezultateve të Fletë-analizave laboratorike të lëshuara nga Laboratore të Akredituar të Tekstil-Konfeksioneve, që shoqërojnë mallin, të sjella nga kontraktuesi, sipas përcaktimeve në kontratë, dhe ekzaminimit të mallit të furnizuar, që do të bëjë "Komisioni i pritjes, kontrollit dhe pranimi të mallit të Gardës së Republikës", i cili kryen direkt matjet e vlersimit organo-leptike të sasisë së mallit të dorëzuar dhe bën krahasimin e të gjithë këtyre rezultateve me kërkesat dhe të dhënat teknike të këtij specifikimi teknik.

Gjithashtu, komisioni nëse e shikon të arsyeshme dërgon mostra e kryen analiza laboratorike pranë laboratorëve të akredituar, duke i krahasuar rezultatet e tyre me rezultatet e analizave të sjella nga OE furnizues.



Artikulli konsiderohet teknikisht i pranuar kur ai plotëson të gjitha kërkesat e këtij specifikimi teknik.

OBJEKTI: 12. “Rrip pantallonash” për punonjësit e Gardes së Republikës

Specifikimi teknik i artikullit, “Rrip pantallonash” për punonjësit e Gardës të Republikës paraqet kërkesat themelore teknike të domosdoshme si dhe kërkesat çilesore të këtij artikulli.

Për procedurë vlerësimi dhe miratimi nga perdoruesi, ofertuesi është i detyruar të paraqesi si ofertë teknike të realizuar sipas kërkesave të këtij specifikimi teknik :

- 1 (një) copë “Rrip pantallonash“

Rripit i qepet një etiketë tekstili në të cilën shkruhet: moster “ Rrip pantallonash ”, emri i ofertuesit, data dhe vula e ofertuesit.

Mungesa e mostres është kusht skualifikues

NGJYRA : E zezë, togeza ngjyre e artë.

PERBERJA: Materiali të jetë 100% sintetik, fill i thurur.

GJATESIA: 120 cm (± 1 cm)

GJERESIA: 3 cm (± 0.2 cm)

Mberthimi i rripit të mezit realizohet me togez metalike ngjyrë të artë rezistent ndaj koruzionit.

Në njërën ana vendoset togeza ndersa na anen tjetër vendoset një fletë metalike e dhembzuar e cila është fiksuar në togez, që shërben për shterngimin apo lirim të gjatësisë së rripit duke patur edhe pjese siguruese për funksionimin e saj.

Mberthimi dhe zberthimi i pjesës së togzës të jetë i lehtë e funksional gjatë përdorimit.

Afati i lëvrimit: Brenda 90 ditëve nga lidhja e kontratës, por jo më vonë se data 20 dhjetor e vitit planifikues.

KOLAUDIMI MARRJA NE DORZIM

Pranimi i të gjithë sasisë të artikullit “Rrip pantallonash” të përcaktuar në kontratë dhe të dorëzuar në magazinën e Gardës, do të bëhet vetëm në bazë të rezultateve që do të marrin gjatë procesit të Kolaudit për të gjithë sasinë e produktit të gatshëm të dorëzuar në magazinë. Kolaudi do të bëhet mbi bazën e rezultateve të Fletë-analizave laboratorike të lëshuara nga Laboratore të Akredituar të Tekstil-Konfeksioneve, që shoqërojnë mallin, të sjella nga kontraktuesi, sipas përcaktimeve në kontratë, dhe ekzaminimit të mallit të furnizuar, që do të bëjë “Komisioni i pritjes, kontrollit dhe pranimit të mallit të Gardës së Republikës”, i cili kryen direkt matjet e vlerësimeve organoleptike të sasisë së mallit të dorëzuar dhe bën krahasimin e të gjithë këtyre rezultateve me kërkesat dhe të dhënat teknike të këtij specifikimi teknik.

Gjithashtu, komisioni nëse e shikon të arsyeshme dërgon mostra të kryen analiza laboratorike pranë laboratorëve të akredituar, duke i krahasuar rezultatet e tyre me rezultatet e analizave të sjella nga OE furnizues.

Artikulli konsiderohet teknikisht i pranuar kur ai plotëson të gjitha kërkesat e këtij specifikimi teknik.

SPECIFIKIMET- TEKNIKE

OBJEKTI: 13. “Krevatë uniforme” për punonjësit e Gardës së Republikës

Ky specifikim teknik paraqet kërkesat themelore teknike të domosdoshme për artikullin “Krevatë uniforme”

Të gjitha përcaktimet teknike të këtij specifikimi teknik duhen të zbatohen detyrimisht saktë nga prodhuesi.

Për procedurë vlerësimi dhe miratimi nga përdoruesi, ofertuesi është i detyruar të paraqesi si ofertë teknike të realizuar sipas kërkesave të këtij specifikimi teknik :

- 1 (një) copë krevatë uniforme.

Mostra duhet të ketë vule dhe etikete origjinale të fabrikës prodhuese.

- Fletë-analizë laboratorike të treguesve fiziko-mekanik e kimik të lëndës së parë të përdorur nga prodhuesi.

Copa e mostrës, lëndës së parë dhe ajo që i bashkëngjitet raport-analizës duhet të jenë detyrimisht të njëjta.

Mos plotësimi nga subjekti prodhues (ofertues) në procedurë vlerësimi i tre kërkesave të mësipërme do të konsiderohet skualifikim teknik.

Krevates dhe lëndës së parë u qepet nga një etiketë tekstili në të cilën shkruhet: muster “Krevate uniforme”, emri i ofertuesit, data dhe vula e ofertuesit.

Mungesa e mostrës, lëndës parë dhe fletë analizës që shoqëron ato është kusht skualifikues.

Ngjyra : E zezë

Lenda: Poliester 100%

Masa: 110 gr/m² (±3%)

Karakteristikat e përgjithshme : Krevata ka gjatësi prej 150 cm dhe gjerësi 7-8 cm

Krevate uniforme ka dy faqe dhe kanavas përforcues të qepur brenda për ta mbajtur drejt dhe që të mos paloset.

Afati i lëvrimit: Brenda 90 ditëve nga lidhja e kontratës, por jo më vonë se data 20 dhjetor e vitit planifikues.

KOLAUDIMI MARRJA NE DORZIM

Pranimi i të gjithë sasisë të artikullit “Krevatë uniforme” të përcaktuar në kontratë dhe të dorëzuar në magazinën e Gardës, do të bëhet vetëm në bazë të rezultateve që do të marrin gjatë procesit të Kolaudit për të gjithë sasinë e produktit të gatshëm të dorëzuar në magazinë. Kolaudimi do të bëhet mbi bazën e rezultateve të Fletë-analizave laboratorike të lëshuara nga Laboratore të Akredituar të Tekstil-Konfeksioneve, që shoqërojnë mallin, të sjella nga kontraktuesi, sipas përcaktimeve në kontratë, dhe ekzaminimit të mallit të furnizuar, që do të bëjë “Komisioni i pritjes, kontrollit dhe pranimi të mallit të Gardës së Republikës”, i cili kryen direkt matjet e vlerësimeve organoleptike të sasisë së mallit të dorëzuar dhe bën krahasimin e të gjithë këtyre rezultateve me kërkesat dhe të dhënat teknike të këtij specifikimi teknik.

Gjithashtu, komisioni nëse e shikon të arsyeshme dërgon mostra e kryen analiza laboratorike pranë laboratorëve të akredituar, duke i krahasuar rezultatet e tyre me rezultatet e analizave të sjella nga OE furnizues.

Artikulli konsiderohet teknikisht i pranuar kur ai plotëson të gjitha kërkesat e këtij Specifikimi Teknik.

SPECIFIKIM TEKNIK

OBJEKTI : 14. “Pulover uniformë” për punonjësit e Gardës së Republikës.

Specifikimi teknik i artikullit “**Pullover uniformë**” për truprojen e nderit të Gardës së Republikës, paraqet kërkesat themelore teknike të domosdoshme për prodhimin e tij.

Në këtë specifikim teknik përcaktohen gjithashtu dhe kërkesat teknike të aksesoreve që shoqërojnë artikullin “**Pullover uniformë**” si produkt i gatshëm.

Të gjitha përcaktimet teknike të këtij specifikimi teknik duhen të zbatohen detyrimisht saktë nga prodhuesi.

Për procedurë vlerësimi dhe miratimi nga perdoruesi, ofertuesi është i detyruar të paraqesi si ofertë teknike të realizuar sipas kërkesave të këtij specifikimi teknik :

- 1(një) “**Pullover uniformë**” masa M

- 1 (nje) pjese tekstil trikotazhi me permasa 50 x 50 cm.

- Fletë-analizat laboratorike të treguesve fiziko-mekanik e kimik të lëndëve të para të përdorur nga prodhuesi.

Mungesa e mostres, lendeve te para dhe flete analizave qe shoqerojne ato, eshte kusht skualifikues.

LËNDËT E PARA: Materiali bazë që duhet të përdoret për prodhimin e artikullit “**Pullover uniformë**” duhet të jetë i cilësisë së parë, me këto të dhëna teknike:

Material me ngjyrë të zezë, me përbërje ($\pm 3\%$): 50% lesh dhe 50% akrilik

Thurja: Trupi - Interlock dhe Jaka - punim llastik 1:1

Masa: 550 gr/m² ($\pm 3\%$) në trup dhe 600 gr/m² ($\pm 3\%$) në jakë

Qëndrueshmëria në fërkim: mbi 15000 cikle

Efekti pilling (kokërrzimi): nota 4—5

Qëndrueshmëria e ngjyrës: Ngjyrosja duhet të jetë në fije - nota 4—5

Materialët ndihmese :

Materiali i dytë bazë që do të përdoret për prodhimin e artikullit “**Pullover uniformë**” duhet të jetë i cilësisë së parë me këto të dhëna teknike:

Material me ngjyrë të zezë, me përbërje ($\pm 3\%$): 50% pambuk dhe 50% poliestër

Thurja: Diagonal

Masa gr/m² : 250 gr/m² ($\pm 3\%$)

Dendësia: Në bazë - 300 fije/ 10 cm; Indi- 200 fije/10cm

Qëndrueshmëria e ngjyrës: nota 4—5

Penj qepje të zi Nm 80/2 për qepje industriale me përbërje 100 % PES

“Pullover uniformë” kompletohet:

- **Elementet Velcro femër për vendosjen:**

E Stemës së Republikës dhe Stemës së Gardës, velkrof femer në mençe, me permasa 7.5 cm x 6 cm ± 0.1 cm, pjesa e sipërme është e drejtë ndërsa e pjesa e poshtme në formë ovale (shqyti) me distancë rreth 7-8 cm nga gavatura e mëngës.

E shenjës së mbiemrit : Siper në gjoksin e djathtë vendoset velkrof femër 8.5 cm x 2.5 cm, në formë drejtëkëndeshi, për vendosjen e mbiemrit.

- **Grada & Shenja dalluese**

Stemë e Republikës me velkrof mashkull (sipas specifikimeve të dhëna)

Stemë Garde me velkrof mashkull (sipas specifikimeve të dhëna)

PËRPUNIMI DHE PËRGATITJA E MATERIALEVE BAZË

Prodhimi i artikullit “Pulover uniformë” duhet të realizohet sipas një procesi teknologjik të përcaktuar mbi bazën e kërkesave dhe kushteve teknologjike të sakta në secilën fazë të realizimit të tij.

Përpunimi përgatitor

Përgatitja e lëndës së parë dhe materialeve ndihmëse në mënyrë të saktë dhe të drejtë është bazë për një ecuri cilësore të proceseve teknologjike të mëtijshme gjatë prodhimit me cilësi të artikullit “**Pulover uniformë**”

Përgatitja e fijeve për prodhimin e pulovrit në makineri trikotazhi

Filli për prodhimin e pulovrit duhet të jetë i njëtrajtshëm në strukturë dhe në ngjyrë. Ai duhet të jetë i lyer me ngjyrën e specifikuar në këtë dokument. Filli duhet të jetë i cilësisë së parë dhe të mos pësojë dëmtime gjatë proceseve të tjera përgatitore.

Përgatitja e modelit

Modelimi i pulovrit duhet të kryhet me anë të programeve kompjuterike të përshtatshme për operimin e makinerive të trikotazhit.

Ambalazhimi ka të bëjë me etiketimin, ambalazhimin për çdo produkt dhe ambalazhimin total të gjithë sasisë të produktit të gatshëm dhe përgatitjen e tij për levrimin drejt magazinave të përdoruesit

NDËRTIMI I PULOVRI

Pulovri duhet të ndërtohet me anë të makinerive të trikotazhit.

Filli duhet të ketë përbërje të përzierë leshi dhe akriliku.

Jaka e pulovrit duhet të jetë —V.

Pjesët përbërëse të pulovrit:

- Pjesa e përparme
- Pjesa e pasme
- Jaka
- Mëngët e gjata
- Yllyqet (dy për çdo sup)
- Dy pjesët e tekstit që duhet të qepen në pjesën e supëve
- Dy pjesët e tekstit që duhet të qepen tek mëngët
- Një xhep që duhet të qepet në mëngën e majtë

TRIKOTIMI DHE QEPJA

Trikotimi (prodhimi) i menjeve, të gjoksit, të shpines, të bordurës dhe jakes të pulovres kryhet në makinat e posaçme të trikotimit.

Jaka e pulovres është e hapur dhe ka formë V-je. Bordura e jakes duhet të jetë trikotazh methurje llastik 1+1. Gjeresia e bordurës së jakes të montuar në trupin e pulovres duhet të jetë 3 cm (+/- 1 mm). Gjatësia e brinjës së trekëndëshit të bordurës së jakës duhet të jetë 16 - 18 cm (sipas numerave). Bordura e jakës duhet të jetë e bashkuar dhe e palosur me trupin e pulovrit me anë të makinerive të posaçme të trikotazhit.

Pjesa e përparme dhe e pasme duhet të ndërtohen të plota (pa prerje), me punim trikotazhi methurje llastik 1:1 në 6-6.5 cm e para dhe theturje *interlock* në të gjithë pjesën tjetër.

Thurja llastik 1:1 duhet të jetë elastike dhe të mos zgjerohet apo deformohet gjatë përdorimit. Pjesa e përparme dhe e pasme duhet të qepen me njëra-tjetrën me anë të tegelit syzator pesëfijësh.

Pulovri duhet të jetë i gjatë deri sipër vitheve.

Gjoksi, shpina dhe menget perbehen nga pjesa kryesore dhe brezi i poshtem (per mengjen doreza). Pjesa kryesore e gjoksit, shpines dhe menges duhet te jete trikotazh methurje interlok.

Brezi i poshtem dhe doreza e menges duhet te jene me gjeresi 6-6.5 cm dhe thurja e trikotazhit ne keto pjese duhet te jete me e ngjeshur pra e realizuar me thurje llastik 1:1 por madhesia e sythit ne keto pjese duhet te jete me e vogel ne raport me madhesine e sythit ne pjeset e siperme kryesore.

Per nje shtrengim sa me te forte ne rradhen e fundit te sytheve te brezit te poshtem te gjoksit, te shpines dhe te dorezes se menges duhet te jete i pershkruar gjate gjithë gjatesise nje fill i holle llastiku. Mëngët duhet të qepen me trupin me anë të tegelit syzator pesëfijesh.

Gjate procesit te trikotimit duhet bere shume kujdes per te eliminuar tonacione te ngjyres se fillit qe do te perdoret per trikotim, mungese ose kapercim te sytheve, mosbarazi te sytheve si dhe vrime ne siperfaqe te trikotazhit etj.

Ne krahun e majte dhe te djathte vendosen velkrofet femer ne ngjyre te zeze, ne te cilat, krahun e majte lart vendoset stema e flamurit kombetar kurse ne krahun e djathte stema e Gardes te Republikes. Siper ne gjoksin e djathte vendoset velkrof femer ne forme drejte kendeshi me ngjyre zeze. Jaka ne forme V-je, menget, shpina dhe gjoksi jane te pergatitura me ane te procesit te trikotimit.

Mengeve iu montohen me qepje fortesat prej material me ngjyre të zezë, me përbërje (±3%): 50% pambuk dhe 50% polyester, ne pjesen e brylit te cilat duhet te shtrihen duke u puthitur mire dhe pa rrudha me siperfaqen e trikotazhit. Fortesa prej doku duhet te mbuloje ne menyre simetrike te gjithë siperfaqen e brylit.

Arnat e supeve

Arnat duhet të kenë formë drejtkëndore me përmasa 13.5 cm gjatësia (sa gjatësia e gradave) dhe me gjërësi 12-14 cm sipas masës së pulovrit. Për pulovrin e meshkujve masa M, përmasat e arnës duhet të jenë 13.5 cm x 12 cm. Arnat duhet të jenë me tekstil tezgjahu me përbërje të përzierë pambuku dhe poliestre.

Në supe vendosen dy ylyqe per montimin e gradave te supit ne forme spalette.


Ylyqet me permasa 4 x 1 cm qepen ne menyre te tille qe mesi i ylykut te jete mbi tengelin e bashkimit te shpines me gjoksin. Ylyku i pare qepet 1 cm nga tengeli i rrethit te menges (gavatara). Ylyku i dyte qepet 8 cm nga ylyku i pare.

Arnat e mëngëve

Në pjesën e pasme të parakrahëve duhet të qepen arnat me formë drejtkëndore me kulme të rrumbullakosura. Përmasat e arnave duhet të jenë 10-12 cm x 18-20 cm në varsi të numerave. Ato duhet të qepen në një distancë rreth 13 cm larg nga punimi llastik i mëngës dhe të arrijnë deri tek brrylat. Përmasat e arnave duhet të janë standarde për të gjitha masat e pulovrave. Arnat duhet të jenë me tekstil tezgjahu me përbërje të përzierë pambuku dhe poliestre.

Xhepi i mëngës

Pulovrat duhet të kenë nga një xhep me formë drejtkëndore të qepur ne mëngën e majtë. Xhepi duhet të ketë dy ndarje vertikale me gjerësi 3 cm secila dhe duhet të përbëhet nga dy shtresa tekstili të mbivendosura me këto përmasa: **Shtresa e parë** lartësi 13.5 cm x gjerësi 7.5 cm, **Shtresa e dytë** lartësi 11 cm x gjerësi 7.5 cm.



Artikulli “Pulover uniformë” prodhohet dhe porositet nga perdoruesi në sasi të përkatëse sipas masave të gjokseve S , M , L , XL , XXL të cilat subjekti prodhues është i detyruar ta respektojë saktësisht.

Pulovra zeze produkt i gatshem prodhohet me permasat (cm) te dhena ne tabelat si me poshte :

Tabelen Nr.2

masa	S	M	L	XL	XXL	tol.
permasa						+/- cm
c	14.5	15	15.5	16	17	0.5
d	43	45	47	49	51	1
e	45	49	53	57	61	0.5
f	32	34	36	39	42	1
g	20	21	22	24	26	0.5
h	8	8.5	9	9.5	10	0.5
n	16	16.5	17	17.5	18	0.5
m	18.5	19	19.5	20	20.5	0.5

c -- gjatesia e supit e matur nga supi deri te bashkimi i jakes

d -- gjeresia e shpines e matur mbrapa lart tek shpatullat

e -- gjeresia e gjoksit

f -- gjeresia e pulovres tek brezi ne fund

g -- gjeresia e menges lart

h -- gjeresia menges poshte tek doreza

n -- hapja lart e jakes

m -- lartesia e jakes

Tabelen Nr.2

Gjatesia e trupit	permasa	a	b	p	o
	prerja				
150 - 165	I	64	58	18	10
166 - 176	II	68	62	19	11
177 - 190	III	72	65	20	12
	tol. +/- cm	1	1	0.5	0.5

-
- a -- gjatesia e pulovres e matur nga jaka e qafes deri ne fund
 - b -- gjatesia e menges e matur nga pika me e larte e tegelit te supit deri ne fund
 - p -- gjatesia e forteses te vendosur tek bryli
 - o -- gjeresia e forteses te vendosur tek bryli

Sasia sipas numerave do bëhet mbi bazën e kërkesave të Gardës me lidhjen e kontrates me prodhuesin.

Pulovra duhet te jete simetrike ne te gjithë elementet e saj.
Pulovra zeze eshte e njejte ne model si per meshkuj ashtu dhe per femra.

Amballazhimi dhe etiketimi

Pulovri duhet të pajiset me një etiketë prej tekstili, në të cilën duhet të shkruhet emri i fabrikës, viti i prodhimit, përmasa, përbërja, dhe instruksionet e mirëmbajtjes.
Etiketa duhet të qepet në brendësi të pulovrit, në anën e majtë, rreth 12 cm nga fundi.

STEMA E REPUBLIKËS (Shenjë krah)

Lëndët e para e ndihmëse:

Material i hollë e reziztent tekstili i qendisur me penjë sipas ngjyrave të çdo elementi të stemës.

Stemës mbas qendisjes i qepet velkrof mashkull, me të njejtat permasa , duke e realizuar si një trup të vetem.

Qendrueshmeria e ngjyrave dhe rezistenca në keputje të jete e lartë.

Elementët përbërës të stemës.

Stema është në formen e një mburoje me permasa 7.5 x 6 cm +/-0.1 cm.

Pjesa e sipërme është e drejtë ndersa e pjesa e poshtme në formë ovale (shqyti). Fusha është në ngjyrë të kuqe në mes të së cilës gjëndet shqiponja dykrenare e qendisur me penj me ngjyrë të zezë mbi të cilën në qendër vëndoset perkrenarja e Skenderbeut qëndisur me penj ngjyrë ari,në profil me pamje nga e djathta.

Stema rrethohet me një kornizë qendisur me penj ngjyrë ari të vijeuar me gjeresi 2 mm. Stema në terësi si dhe gjithë elementët përbërës të saj të jenë rezistente ndaj gjithë faktoreve atmosferike. Po kështu dhe qendrueshmeria e ngjyrave të jetë shumë e mirë. Stema vendoset në krahun e majtë me anë të një velkrofi femer- mashkull.



STEMA E GARDËS SË REPUBLIKËS (Shenjë krah)

Lëndët e para e ndihmëse:

Material i hollë e reziztent tekstili i qendisur me penjë sipas ngjyrave të çdo elementi të stemës.

Stemës mbas qendisjes i qepet velkrof mashkull, me të njejtat permasa , duke e realizuar si një trup të vetem.

Qendrueshmeria e ngjyrave dhe rezistenca në keputje të jete e lartë.

Elementët përbërës të stemës.

Stema është në formën e një mburoje (shqyti) me permasa 7.5cm x 6 cm +/-0.1 cm. Pjesa e sipërme është e drejtë ndersa e pjesa e poshtme në forme ovale (shqyti).

Stema rrethohet me një kornizë ngjyrë ari, me gjëresi 2 mm, në qendër të saj është vendosur shqiponja e zezë dykrenare, e përdorur si simbol në krijimin e këtij formacioni. Mbi shqiponjë qëndron përkrenarja e Heroit tonë kombëtar, Skënderbeut, në ngjyrë të artë. Përkrenarja e Skënderbeut është vendosur në pamje ballore, për të bërë të mundur leximin e shkronjave “BT”, ”IN”, duke respektuar semantiken, rregullat dhe stilet araldike të kurorave, e duke bërë më të lexueshme çfarë përfaqëson kjo përkrenare. Ajo i shmanget kopjimit përsëritës të saj, duke e bërë të vecantë për këtë institucion. Në këtë pozicion shikohet karakteri i saj laik e qytetar, fisnik e ushtarak. Emblema evidenton ndërthurjen e madhështisë me bukurinë që paraqet ky element në fushën e sematikës Shqiptare.

Duke qenë se stema shërben edhe si shenjë krahu për gardistët në pjesën harkore të shqytit, është shkruar me gërma kapitale “GARDA E REPUBLIKËS”.

Stema në teresi si dhe gjithë elementet përbërës të saj të jenë rezistentë ndaj gjithë faktoreve atmosferike. Po kështu dhe qendrueshmeria e ngjyrave e copës dhe penjëve të përdorur të jetë shumë e mirë.



Afati i lëvrimit: Brenda 90 ditëve nga lidhja e kontratës, por jo më vonë se data 20 dhjetor e vitit planifikues.

KOLAUDIMI MARRJA NE DORZIM

Pranimi i të gjithë sasisë të artikullit “**Pulover uniformë**” të përcaktuar në kontratë dhe të dorëzuar në magazinën e Gardës, do të bëhet vetëm në bazë të rezultateve që do të merrën gjatë procesit të Kolaudimit për të gjithë sasinë e produktit të gatshëm të dorëzuar në magazinë. Kolaudimi do të bëhet mbi bazën e rezultateve të Fletë-analizave laboratorike të lëshuara nga Laboratore të Akredituar të Tekstil-Konfeksioneve, që shoqërojnë mallin, të sjella nga kontraktuesi, sipas përcaktimeve në kontratë, dhe ekzaminimit të mallit të furnizuar, që do të bëjë “Komisioni i pritjes, kontrollit dhe pranimit të mallit të Gardës së Republikës”, i cili kryen direkt matjet e vlersimet organo-leptike të sasise së mallit të dorëzuar dhe bën krahasimin e të gjithë këtyre rezultateve me kërkesat dhe të dhënat teknike të këtij specifikimi teknik.

Gjithashtu, komisioni nëse e shikon të aryeshme dërgon mostra e kryen analiza laboratorike pranë laboratorëve të akredituar, duke i krahasuar rezultatet e tyre me rezultatet e analizave të sjella nga OE furnizues.

Artikulli konsiderohet teknikisht i pranuar kur ai ploteson të gjitha kërkesat e këtij Specifikimi Teknik.

Shenim: Ky Specifikim Teknik, kampioni, modeli dhe ngjyra e artikullit “**Pullover uniformë**” janë pronë e Gardës së Republikës dhe për nga qëllimi i përdorimit ato i perkasin vetëm strukturave të saj. Nuk lejohet shumfishimi dhe realizimi i këtij specifikimi teknik, kampionit, modelit dhe ngjyrës së artikullit “Pullover uniformë”.

SPECIFIKIM TEKNIK

OBJEKTI: 15. “Pantollona vere” për punonjësit e Gardës së Republikës.

Ky specifikim teknik në mënyrë të detajuar paraqet kërkesat themelore teknike të domosdoshme për prodhimin në linjë industriale mbi bazën e proceseve teknologjike të artikullit “Pantollona vere teritali “. Në këtë specifikim teknik përcaktohen gjithashtu dhe kërkesat teknike të aksesoreve që shoqërojnë artikullin “Pantollona vere teritali” si produkt të gatshëm .

Te gjitha përcaktimet teknike të këtij specifikimi teknik duhen të zbatohen detyrimisht saktë nga prodhuesi.

Për procedurë vlerësimi dhe miratimi nga përdoruesi, ofertuesi është i detyruar të paraqesë si oferte teknike të realizuar sipas kërkesave të këtij specifikimi teknik :

- 1 (një) pale pantallona, me nr.50.
- 1 (një) pjesë teritali me ngjyrë të zeze nga i pantallonave me gjatësi 0,5 ml, gjeresi sa ajo e vet teritalit.
- Flet-analizat laboratorike të treguesve fiziko-mekanik e kimik të lëndës të pare teritali i zi të përdorur nga prodhuesi.

Teritali i pantallonave dhe copat e lëndës së pare që i bashkëngjiten raport-analizave të laboratorit, duhet të jenë detyrimisht të njëjta.

Pantallonave mostër dhe lëndeve të para (pjesëve të teritalit), u qepet me tegel makine nga një etiketë tekstili e bardhë, me permasa të përafërta 10x10cm, në të cilën shkruhet: mostër “Pantollona vere teritali”, emri i ofertuesit, data e tenderit, nënshkrimi dhe vula e ofertuesit.

Mungesa e mostres, lëndeve të para dhe flete analizave që shoqërojnë ato, është kusht skualifikues.

LËNDËT E PARA : Material me ngjyrë të zezë me përbërje (+/-3%) : 62% poliestër 35 % viskozë dhe 3% elastin

- | | | |
|--------------------------------|------------------------------|-----------------------|
| - ngjyra | e zezë | |
| - thurja | sarzh 2/1 | |
| - masa gr/m² | 210 gr/m ² (±3%). | |
| - dendësia fije/10 cm | D baze 340 +/- 10 fije | D ind 265 +/- 10 fije |
| - qendrueshmeria kG | Q baze 150 – 6 kG | Q ind 70 – 6 kG |
| - numri metrik | Nm baze 45/2 +/- 3 | Nm ind 52/1 +/-3 |
| - trashësia e tekstili | 0.3 - 0.5 mm | |

- **qendrueshmeria ne ferkim** mbi 2500 cikle
- **qendrueshmeria e ngjyres** Nota 4-5

Ne lenden e I-re tekstil viskoz me ngjyre te zeze qe duhet te perdoret per konfeksionimin e artikujve “Pantallona vere”, difekte te perhapura te pamjes se jashtme te cilat detyrimisht nuk lejohen do te konsiderohen : papastertite me origjine bimore,njolla te ndryshme vaji ose boje,tonacione te ngjyres,oksidime,rrudhosje,mungese te fijeve ne ind e ne baze,trashim te fijeve ne ind e ne baze,vrima ne siperfaqe, lekundje ne gjeresi etj.

Materialet ndihmese qe duhet te perdoren per ndertimin e artikujve “**Pantallona vere**” jane:

- Qemer i pergatitur
- Kopsa te zeza ebaniti
- Astar xhepi ne ngjyre te erret material tekstili 100 % viskoz.
- Penj qepje Nm 80/2,100 % PES ne ngjyre të zezë
- Flieseline e posacme per ngjitje dhe perforcimin e elementeve te pantallonit dhe fundit
- Kapse metalike mashkull-femer per mbylljen ne bel
- Shirit tekstili terital i kuq 3mm per fileto anesore
- Zinxhir me dhembeza plastike 18-22 cm per pantallonin dhe fundin
- **Prodhimi** i artikujve “Pantallona vere” duhet te realizohet sipas nje procesi teknologjik te percaktuar mbi bazen e kerkesave dhe kushteve teknologjike te sakta ne secilen faze te realizimit te tij.Prodhimi ndahet ne tre faza kryesore te cilat jane :
- perpunimi pergatitor
- konfeksionimi (procesi i qepjes)
- Ambalazhimi,marketimi dhe ektiketimi

Perpunimi pergatitor ka te beje me kolaudimin e lendeve te para dhe ndihmese,skicimin,prerjen ne prestari,marketimin dhe kollaritjen e pjeseve perberese te pantallonit dhe fundit.

Konfeksionimi ka te beje me qepjen e pjeseve perberese te pantallonit sipas nje procesi linear te percaktuar.Ne faza te ndermjetme te ketij procesi do te kryhet hekurosja dhe presimi me avull i gjysemprodukteve.Ne perfundim kryhet dhe hekurosja e produktit te gatshem.**Ambalazhimi** ka te beje me etiketimin,amblazhimin per cdo produkt dhe amblazhimin total te gjithë sasise te produktit te gatshem dhe pergatitjen e tij per levrimin drejt magazinave te perdoruesit.

PERPUNIMI PERGATITOR

Kolaudimi i lendes se pare dhe materialeve ndihmese

Kolaudimi i lendes se pare dhe materialeve ndihmese ne menyre te sakte dhe te drejte eshte baze per nje ecure cilesore te procesve teknologjike te metejshme zinxhir per prodhimin me cilesi te “Pantallona vere”

Skicimi

Ky proces duhet te realizohet me metodat matematikore te programimit linear te cilat sigurojne nje shenim te sakte te prerjeve dhe shenjave sipas vizatimeve duke pasur kujdes qe detajet e pantallonit te jene ne drejtim te fijeve te bazes.

Prerja

Procesi i prerjes duhet te behet me shume kujdes qe te mos te kete devijime ne fletet e fundit te dyshekut i cili eshte mire qe te mos te kaloje 90 flete. Kujdes duhet te behet dhe ne pjeset e harkuara te detajeve dhe buzet e prera te mos jene me dhembza.

Marketimi

Ky proces eshte shume i rendesishem sepse eliminon qepjen e detajeve te pantallonit me tonacione te ndryshme duke siguruar njellojshmeri ne ngjyre te artikullit.

Kollaritja

Detajeve gjysem te gatshme te pantallonit dhe ngjitja e flieselines duhet te behet me prese speciale me avull ne Tem. 130-140 C, ne kohe 8-10 sek. ne presion 2 atm. Ky proces duhet te kryhet sa me i sakte ne menyre qe te mos kete asnje mundesi qe ne objekt te krijohen deformime gjate hekurosjes me avull, larjes dhe lagies nga shiu, te cilat bejne te mundur humbjen e pamjes fillestare. Kollaritja dhe ngjitja nuk lejohet me shtesa.

Flieselina ngjitet ne keto pjese si me poshte:

2 detaje tek qemeri i pantallonit, 1 detaj tek filetoja e pantallonit, 1 detaj tek kapaku i xhepit te pantallonit, 1 detaj tek sallkia, 1 detaj tek karshilleku.

KONFEKSIONIMI

Procesi i Qepjes

Pantalloni ka dy xhepa te pjerret perpara me fileto stofi me gjeresi **3 mm** dhe nje xhep mbrapa po me filet **3 mm** qe mbyllet me kapak me kopse ebaniti ne ngjyre te zeze. **Sallkia** eshte e me stof dhe fileto astari dhe per mbyllje i fiksohet nje zinxhir plastik me dhembza te vegjel. **Qemeri** ka 7 (shtate) mbajttese rripi. Mbyllja e pantallonave ne mes realizohet me kapese metalike mashkull – femer dhe me kopse. Ne mes te qemerit nga brenda vendoset etiketa me numrin dhe prerjen perkatese te pantallonit si dhe instruksioni i larjes, i pastrimit, i hekurosjes dhe i perdorimit. Pantalloni eshte me dy penca nga jashte. Xhepat anesore jane me astar permasat e te cilave jepen ne tabelen perkatese. Pantalloni ne dy anesoret ne bashkimin e perparseve me pjesen e prapme te tyre, pershkohet nga shirit i kuq 3 mm, nga qemeri deri ne fund te pantallonit.

Pantallonit ne fund lihet lisho ose i lihet 5 cm rezerve dhe ne fund te pales i vendoset fortese astari.

Per te qepur pantallonin ne fillim pergatiten pjeset ndihmese si : qemeri, filetot, astaret dhe kapaket e xhepave, mbajtset e rripit dhe sallkia.

Qemeri duhet te pergatitet ne menyre te tille qe te mos rrije as i shtreguar dhe as i lire. Gjeresia e qemerit perpara duhet te jete 4.5 cm ndersa mbrapa 3.5 cm. Qemeri duhet te jete i perforcuar me flieselina dhe nga brenda i qepet astar i posacem per qemer. Qemerit pergjate gjithë gjatesise se tij i kalohet tegel zbukurimi **1 mm** larg buzës ne te dy anet. Qemeri ka 7 (shtate) mbajttese rripi te kthyer te pershkruara me tegela siper **1mm** larg buzës.

Kapaku i xhepit te pasem eshte me maje ne forme trekendeshi. Kapaku perbehet nga pjesa e siperme dhe e poshtme. Pjeses se siperme per perforcim i ngjitet flieselina, bashkohen me pjesen e poshtme, kthehet, i qepet astar nga mbrapa, hekuroset dhe i kalohet nje tegel zbukurimi **1mm** larg buzës. Gjate kthimit duhet bere kujdes qe cepat dhe majat e kapakut te mos dalin te rrumbullaket.

Hekurosja perfundimtare e pantallonit duhet bere me kujdes sidomos per formimin e vijes se hekurit ne menyre qe ajo te jete rrije drejt ne mes te kembes.

Pantalloni dhe fundi duhet te jene simetrik ne te gjithë elementet e tyre.

Numrat e pantallonave te jene sipas sasise ne tabelen e meposhtme.

Pantallona vere.	Numri									
	44	46	48	50	52	54	56	58	60	shuma
Sasia	10	40	60	60	50	40	30	10	-	300

Prerjet	Gjatesi/trupore	a	b	c	d	e	f	g	h	i
I	155-160	93	69.5	15	50	54	33	17	4	7.5
II	161-166	97	72.5	15	50	54	34	17	4	7.5
III	167-172	100	75	16	52	56	34	17	4	7.5
IV	173-178	103	78	16	54	58	34	17	4	7.5
V	179-184	106	81	17	56	60	35	17	4	7.5
VI	185-190	110	84	17	56	60	35	17	4	7.5
Devijimi+/-		1	0.5	0.2	0.5	0.5	0.5	0.5	0.2	0.2

a - gjatesia e pantallonit ne drejtim te qepjes anesore e matur nga qepja e qemerit deri ne fund.

b - gjatesia e kavallos.

c - hapja e xhepit anesor.

d - gjeresia e pantallonit ne fund.

e - gjeresia e pantallonit ne gju.

f - thellesia e qeses se xhepit anesor.

g - thellesia e qeses se xhepit prapa.

h - gjeresia e qemerit.

i - zbritja e xhepit prapa.

gjokset	44	46	48	50	52	54	56	58	Devijimi +/-
j	39	41	43	45	47	49	51	53	0.5
k	16	16	16	16.5	16.5	17	17	17	0.5
l	63	64	65	66	68	70	72	74	0.5
m	11	14	14	14.5	14.5	15	15	15	0.2

j – gjeresia e belit.

k – gjeresia e qeses se xhepit anesor ne fund.

l – gjeresia epantallonit e matur ne drejtim te kavallos.

m – gjeresia e qeses se xhepit prapa.

Per kontrollin cilesor ne procesin e prodhimit

Ky proces duhet të realizohet me metoda matematikore të ndërtimit të kallëpeve. Pjesët përbërëse të artikullit/produktit duhet të kenë përputhshmëri të saktë dhe mbi to duhet të shënohen shenjat e prerjes dhe të bashkimit me njëra-tjetrën. Të gjitha pjesët e artikullit duhet të pozicionohen në tekstil në drejtim të fijeve të bazës.

Prerja

Gjatë procesit të prerjes nuk duhet të ketë devijime në fletët e fundit të dyshekut. Rekomandohet që dysheku të mos ketë më shumë se 80 fletë. Kujdes duhet të bëhet dhe në pjesët e harkuara të detajeve që buzët e prera që të mos jenë me dhëmbëza.

Markimi i pjesëve përbërëse të artikullit



Ky proces duhet të garantojë që të gjitha detalet e produktit të kenë të njëjtën ngjyrë, pa tonacione të dukshme.

Aplikimi i frazelinës

Ngjitja e frazelinës duhet të bëhet me presë speciale në presion 2—3 bar, me avull, në temperaturën dhe kohëzgjatjen e caktuar për materialin përkatës. Ky proces duhet të kryhet sa më i saktë, në mënyrë që produkti mos të humbasë formën fillestare pas hekurosjes me avull, larjes dhe lagies nga shiu. Nuk lejohet ngjitja e frazelinës me shtesa. Kujdes të veçantë duhet t'i kushtohet prerjes së detaleve. Nuk duhet të mbeten shenja të hekurit/presës në tekstil. Adezivi nuk duhet të depërtojë në anën tjetër të tekstilit.

NDËRTIMI I PANTALLONAVE

Udhëzimet teknike të ndërtimit dhe prodhimit të pantallonave të dokut



Pantallona doku verore.

Pjesët përbërëse të pantallonave:

- Qemeri
- Dy pjesët e këmbëve
- Dy xhepat e përparmë
- Dy xhepat e këmbëve
- Dy xhepat e pasmë
- Dy arnat për gjunjë
- Arna në pjesën e vitheve
- Xhepat për vendosjen e mbrojtësve të gjunjëve dhe ijeve në pantallonat e motorristëve.

Qemeri

Lartësia e qemerit duhet të jetë 5 cm. Ai duhet të jetë i përbërë nga një shtresë tekstili e palosur më dysh, e përforcuar nga brenda me frazelinë termoadezive. Tek dy pjesët anësore (në të majtë dhe në të djathtë), qemeri duhet të jetë i pajisur me llastik.

Në anën e djathtë të veshur të qemerit duhet të hapet një vrimë me gjatësi 25 mm për kopsën, ndërsa në tjetrën duhet të qepet kopsa e pantallonave.

Qemeri duhet të përshkohet nga një tegel linear perimetral një gjilpërësh sipërfaqësorë me distancë 2 mm nga buzët. Tegeli i poshtëm duhet të bëjë edhe bashkimin e qemerit me pantallonat.

Llastikët e veshur me tekstin e qemerit duhet të përshkohen edhe nga dy tegela të tjerë linearë një gjilpërësh sipërfaqësorë paralel dhe të baraslarguar nga tegeli perimetral. Llastikët duhet të kufizohen tek ekstremitetet me pjesën e tjetër të qemerit me nga një tegel linear një gjilpërësh sipërfaqësor vertikal.

Kopsat duhet të jenë Nr. 34 (21 mm) me ngjyrë blu të errët. Qepja e kopsave duhet të bëhet kryq. Një kopsë rezervë duhet të qepet në pjesën e brendshme të qemerit, në anën e majtë.

Ylyqet. Pantallonat duhet të kenë 6 ylyqe me gjatësi 6.5 cm dhe gjerësi 2.5 cm: dy përpara dhe katër mbrapa. Ylyqet e përparme duhet të vendosen të baraslarguar nga xhepat anësorë në një distancë prej 2–3 cm, sipas masës. Ylyqet e pasme gjithashtu duhet të vendosen të baraslarguara nga njëra tjetra, sipas masës.

Ylyqet duhet të përbëhen nga një shtresë tekstili ngjyrë blu (si pantallonat) e palosur më dysh, të përforcuar nga brenda me frazelinë .

Ylyqet duhet të përshkohen nga dy tegela dy gjilpërësh gjatësorë me distancë 6 mm nga njëri tjetri dhe dy tegela linearë një gjilpërësh me distancë 2 mm nga buza e poshtme dhe e sipërme. Tegelat gjatësorë duhet të përforcohen me traveta tek ekstremitetet. Tegelat duhet të jenë të gjithë sipërfaqësorë.

Këmbët


Këmbët e pantallonave duhet të ndërtohen me katër pjesë: dy pjesët e përparme dhe dy pjesët e pasme.

Bashkimi i këmbëve të pantallonave duhet të bëhen me anë të një tegeli linear një gjilpërësh të profiluar me tegel syzator katër gjilpërësh (syzator 3 gjilpërësh + një tegel linear).

Bashkimi anësor i jashtëm, i brendshëm dhe bashkimi qendror duhet të përshkohen dhe me anë të një tegeli linear dy gjilpërësh sipërfaqësor.

Këmbët duhet përfundojnë me një palosje të brendshme 2 cm të qepur me tegel linear një gjilpërësh me distancë 2 cm nga buza.

Gjuhëza për shtrëngimin e këmbëve. Këmbët e pantallonave duhet të pajisen në fund, në anën e pasme, me një gjuhëz për efekt shtrëngues. Gjuhëza duhet të qepet midis dy pjesëve anësore të tekstilit të pantallonave. Ajo duhet të shtrëngohet me anë të elementëve *Velcro*.



Sallkia duhet të ndërtohet me dy pjesë: pjesa e mbuluar dhe kapaku i zinxhirit. Të dyja pjesët duhet të jenë prej tekstili të njëjtë si pantallonat.

Shtresa e dukshme e pjesës së mbuluar dhe shtresa e padukshme e kapakut duhet të jenë të përforcuara me frazelinë termoadezive.

Zinxhiri i sallkisë. Gjatësia e zinxhirit mund të ndryshojë sipas masave, nga 16–18 cm. Zinxhiri duhet të jetë me fiksion tek koka në mënyrë që të mos hapet vetë gjatë përdorimit. Ngjyra e zinxhirit duhet të jetë e njëjtë me ngjyrën e pantallonave.

Arnat përforcuese të gjunjëve duhet të jenë prej të njëjtit tekstil si pantallonat. Ato duhet të kenë formë trapezi dhe përmasat e tyre duhet të ndryshojnë në varësi të masës së pantallonave.

Buza e sipërme dhe e poshtme e arnës duhet të jenë të qepura me tegela linearë dy gjilpërësh sipërfaqësorë me distancë 2 dhe 8 mm nga buza. Buzët anësore të arnës duhet të qepen në tegelat qepës anësorë të pantallonave.

Arnat përforcuese të vitheve duhet të qepen në zonën e poshtme të vitheve. Ato duhet të jenë prej të njëjtit tekstil si pantallonat.

Arnat duhet të kenë formë gjysmë elipsi dhe përmasat e tyre duhet të ndryshojnë sipas masës së pantallonave. Qendrat e elipseve duhet të jetë tek pika ku bashkohen katër pjesët e këmbëve.

Anët e harkuara të arnave duhet të jenë të qepura tek pantallonat me tegel linear dy gjilpërësh me distancë 2 dhe 8 mm nga buza.

Anët e drejta (të brendshme) duhet të qepen bashkë me tegelat bashkues anësorë dhe qendror. Tegelat sipërfaqësorë përcaktojnë edhe thellësinë e palosjes së brendshme të tekstilit.

Xhepat e përparmë

Pantallonat duhet të pajisen me dy xhepa të përparmë diagonalë. Hapja e xhepit duhet të fillojë poshtë qemerit, në një distancë 5 cm nga tegeli anësor i pantallonave dhe të përfundojë po tek tegeli anësor.

Xhepat duhet të jenë 17 cm e gjatë. Ato duhet të përforcohen në të dy ekstremitetet e tyre me traveta.

Xhepat duhet të përshkohen gjatë gjithë gjatësisë nga një tegel linear dy gjilpërësh me distancë 2 mm dhe 8 mm nga buza.


Në pjesën e dukshme (mostra) xhepat duhet të jenë të veshur me tekstil të njëjtë me pantallonat.

Astari i xhepave duhet të ketë përmasa 30 x 16 cm.

Xhepat e këmbëve

Pantallonat duhet të pajisen me dy xhepa me kapak me elementë *velcro*, palë të puthitur dhe tegel sipërfaqësor linear dy gjilpërësh.

Xhepat dhe kapakët duhet të kenë formë drejtkëndore të rregullt. Përmasat e xhepave duhet të jenë 23 x 22 cm, ndërsa përmasat e kapakëve të xhepave duhet të jenë 22.5 x 7 cm.



Palë e xhepave duhet të jetë e tipit e puthitur: palë e dyanshme e përmbysur dhe e kufizuar me traveta. Përmasat e palës duhet të jenë 23 x 4 cm.

Hapja e palës nga jashtë duhet të jetë vetëm 14 cm e gjatë dhe e përforcuar me traveta horizontale tek ekstremitetet. Traveta e poshtme duhet të qepet në distancë 3 cm nga buza e poshtme, ndërsa traveta e sipërme duhet të qepet në distancë 6 cm nga buza e sipërme. Pjesa tjetër e hapjes së palës duhet të jetë e qepur.

Xhepat duhet të përshkohen në pjesën e sipërme nga një tegel linear një gjilpërësh me distancë 2.5 cm nga buza dhe të qepen në pantallona me anë të një tegeli sipërfaqësor linear dy gjilpërësh me distancë 2 mm dhe 8 mm nga buzët. Tek buza e sipërme, tegeli duhet të përforcohet me traveta.

Kapakët e xhepave duhet të përbëhen nga dy shtresa tekstili me përmasa të njëjta të përforcuara në brendësi me frazelinë termoadezive. Shtresa përforcuese prej frazelinë termoadezive duhet të bashkohet me shtresën e sipërme në tranxhë me avull të nxehtë.

Shtresat e kapakut duhet të bashkohet me njera-tjetrën me tegel sipërfaqësor linear dy gjilpërësh. Tegeli i sipërm duhet të bëjë qepjen e kapakut tek këmbët. Ai duhet të përforcohet edhe me dy traveta kryq në secilin ekstremitet.

Xhepat duhet të pozicionohen në anën e jashtme të kofshëve, sipër gjurit, ndërsa kapakët e xhepave duhet të qepen në një distancë rreth 2.5 cm mbi xhepa.

Mbyllja e kapakëve duhet të bëhet me anë të dy elementëve *velcro* mashkull/femër me përmasa 2 x 2.5 cm. Elementët *velcro* duhet të vendosen në dy cepat e xhepave, brenda tegelit perimetral.


Xhepat e pasmë

Pantallonat duhet të pajisen me dy xhepa të pasmë me fileto, kapak dhe mbyllje me elementë *velcro*, të pozicionuar rreth 5.5 cm poshtë qemerit. Kapakët dhe filetот duhet të përforcohen me frazelinë termoadezive.

Kapakët e xhepave duhet të kenë përmasa 14.5 cm x 5 cm, ndërsa filetот duhet të kenë përmasa 14.5 x 1.5 cm.

Kapakët duhet të përshkohet nga tre anët e lira me tegela perimetrale lineare dy gjilpërësh sipërfaqësorë me distancë 2 dhe 8 mm nga buzët, ndërsa rreth e përqark filetove, në një distancë prej 1 mm nga buza, duhet të qepet një tegel linear një gjilpërësh sipërfaqësor.

Mbyllja e kapakëve duhet të bëhet me anë të dy elementëve *velcro* mashkull/femër me përmasa 2.5 x 2 cm. Elementët *velcro* duhet të vendosen në dy cepat e xhepave, brenda tegelit perimetral.



Kujdes! Përmasat dhe pozicionimi i xhepave mund të ndryshojnë tek masat e vogla ose të mëdha të pantallonave por pa prishur raportet e specifikuara tek ilustrimi teknik.

KUSHTE TË DOMOSDOSHME

-Produkti përfundimtar duhet të jetë identik me kampionin e aprovuar gjatë procedurave të vlerësimit.

- Filli qepës duhet të ketë ekzakt karakteristikat e përcaktuara tek *Specifikimet Teknike*.
 - Tegelat e qepjes së pantallonave duhet të jenë me hap 3 shpime në 1 cm.
 - Tegelat duhet të jenë të drejtë, uniformë, simetrik, me elasticitetin e duhur dhe nuk duhet të kenë shqepje ose defekte.
 - Tegelat duhet të jenë të fortë dhe nuk duhet të shqepen nëse tërhiqen me duar. Fortësia e tegelave duhet të jetë mbi 12N.
 - Tegelat duhet të jenë të përforcuar në ekstremitete.
- Të gjithë elementët e pantallonave duhet të jenë simetrik.
- Përpara se të fillojë prodhimi i artikujve, prodhuesi duhet të bëjë testimin e stabilitetit dimensional (aftësinë e tekstilit për të ruajtur formën fillestare pas prerjes, qepjes, larjes, hekurosjes, etj.)
- Në varësi të llojit, tekstilet nuk duhet të lahen ose hekurosen në temperatura që kalojnë kufijtë e specifikuar nga prodhuesi në skedën teknike sipas EN ISO3758 ose që janë specifikuar në këtë dokument. Gjithashtu tekstili nuk duhet të fitojë shkëlqim gjatë hekurosjes.
- Tekstili duhet të ketë rezistencë të lartë ndaj rrezatimit Ultraviolet.
- Tekstili duhet të ketë rezistencë maksimale ndaj përdorimit dhe konsumit.
- Kufiri i lejuar i gabimit tek përmasat e pantallonave është $\pm 2\%$.
- Elementëve *Velcro* nuk duhet t'u dalin fijet anësore gjatë përdorimit të shpeshtë.
- Tekstilet që do të bien në kontakt me lekurën duhet të jenë të buta dhe nuk duhet të irritojnë ose dëmtojnë lëkurën.
- Artikujt duhet të jenë të punuar me kujdes në mënyrë të tillë që mos të ketë pjesë të ashpra, të mprehta ose me majë që mund të shkaktojnë plagë në lëkurë.
- Tekstilet, materialet dhe aksesoret e përdorur në prodhimin e këtij artikulli nuk duhet të përmbajnë substanca të dëmshme për shëndetin e njeriut apo AZO ngjyruës. Për produktin e gatshëm duhet të paraqiten rezultatet e këtyre testeve sipas standardeve:

-
- a. EN ISO 14362-1:2017
 - b. EN ISO 14362-3:2017
 - c. EN ISO 3071:2006 (vlera limit e pH për veshjet që kanë kontakt direkt me lëkurën është 4.0 - 7.5 dhe për veshjet që nuk kanë kontakt direkt me lëkurën është 4.0 - 9.0)
- Prodhuesi i artikullit të mësipërm duhet të jetë i pajisur me certifikatën e standardit ISO 9001.

Amballazhimi,marketimi,etiketimi.

Çdo pantallon pasi të jete pastruar mire nga penjet, paiset me nje etikete te qepur ne pjesen e brendshme te qemerit e cila permban numrin dhe fraksionin e prerjes sipas gjatesive trupore. Gjithashtu ka nje tjeter etikete qe permban trajtimin e tekstilit (larje hekurosje etj) me shenja konvencionale. Pantallonat futen ne qese plasmasi 2 pale ne secilen qese dhe vendosen ne kuti kartoni ne ato sasi qe percaktohen ne kontrate.Kutite paisen me etiketa ku shenohet emertimi,,numri, prerja,sasia .

Afati i lëvrimit: Brenda 90 ditëve nga lidhja e kontratës, por jo më vonë se data 20 dhjetor e vitit planifikues.

KOLAUDIMI MARRJA NE DORZIM

Pranimi i të gjithë sasisë së artikullit “Pantallona doku veror” të përcaktuar në kontratë dhe të dorëzuar në magazinën e Gardës, do të bëhet vetëm në bazë të rezultateve që do të marrën gjatë procesit të Kolaudit për të gjithë sasinë e produktit të gatshëm të dorëzuar në magazinë. Kolaudi do të bëhet mbi bazën e rezultateve të Fletë-analizave laboratorike të lëshuara nga Laboratore të Akredituar të Tekstil-Konfeksioneve, që shoqërojnë mallin, të sjella nga kontraktuesi, sipas përcaktimeve në kontratë, dhe ekzaminimit të mallit të furnizuar, që do të bëjë “Komisioni i pritjes, kontrollit dhe pranimi të mallit të Gardës së Republikës”, i cili kryen direkt matjet e vlersimet organo-leptike të sasisë së mallit të dorëzuar dhe bën krahasimin e të gjithë këtyre rezultateve me kerkesat dhe të dhënat teknike të këtij specifikimi teknik.

Gjithashtu, komisioni nëse e shikon të arsyeshme dërgon mostra e kryen analiza laboratorike pranë laboratorëve të akredituar, duke i krahasuar rezultatet e tyre me rezultatet e analizave të sjella nga OE furnizues.

.

Artikulli konsiderohet teknikisht i pranuar kur ai ploteson të gjitha kerkesat e këtij Specifikimi Teknik

Sipas Vendimit nr.653, date 03.11.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e paraqitjes, të formës dhe të specifikimeve teknike të gradave, si dhe për përcaktimin e simboleve, të uniformës, të shenjave dalluese dhe normave të veshmbathjes së punonjësve të Gardës së Republikës së Shqipërisë”:

Uniforma për efektivin shofer (makinë policie) dhe motoçiklist ceremonial, është e njëjtë me atë të Policisë së Shtetit (Policia Rrugore), me gradat e shenjat dalluese të Gardës së Republikës.

SPECIFIKIME TEKNIKE

OBJEKTI: 23. “Bluzë polo me mëngë të shkurtra për meshkuj, për efektivin shofer (makinë policie) dhe motoçiklist ceremonial, është e njëjtë me atë të Policisë së Shtetit (Policia Rrugore), me gradat e shenjat dalluese të Gardës së Republikës.

Për procedurë vlerësimi dhe miratimi nga përdoruesi, ofertuesi është i detyruar të paraqesi si ofertë teknike të realizuar sipas kërkesave të këtij specifikimi teknik :

- 1 (një) copë **“Bluzë polo me mëngë të shkurtra për patrullat e Policisë së Shtetit”** me nr gjoksi 50.

Mostra duhet të ketë vulë dhe etikete origjinale të subjektit prodhues.

- 1 (një) pjesë trikotazhi me permasa 50 x 50 cm.

- Fletë-analizë laboratorike të treguesve fiziko-mekanik e kimik të lëndës së parë të përdorur nga prodhuesi.

Copa e mostrës, lëndës së parë dhe ajo që i bashkengjitet raport-analizes duhet të jenë detyruesisht të njëjta.

Mos plotësimi nga subjekti prodhues (ofertues) në procedurë vlerësimi i tre kërkesave të mësipërme do të konsiderohet skualifikim teknik.

Bluzës së pambukut dhe lëndës së parë u qepet nga një etiketë tekstili në të cilën shkruhet: moster **“Bluzë polo me mëngë të shkurtra për patrullat e Policisë së Shtetit”**, emri i ofertuesit, data dhe vula e ofertuesit.

Mungesa e mostres, lëndës së parë dhe fletë analizës që shoqëron ato është kusht skualifikues.

TË DHËNAT TEKNIKE PËR PRODHIMIN E ARTIKULLIT

Bluzë polo me mëngë të shkurtra për punonjësit e Gardës (për efektivin shofer me makinë policie dhe motoçiklist ceremonial) të njëjtë me **patrullat e Policisë së Shtetit** por me gradat e shenjat dalluese të Gardës së Republikës

a. **Materiali bazë** që duhet të përdoret për prodhimin e artikullit *bluzë polo me mëngë të shkurtra* duhet të jetë i cilësisë së parë, me këto të dhëna teknike:

Ngjyra (*trupi; **jaka dhe bordura e mëngës)	materiali 1*	blu e errët
	materiali 2**	blu e errët
Përbërja %	85% pambuk +15% polipropilen	
Thurja (*trupi; **jaka dhe bordura e mëngës)	materiali 1*	pique (syth irlandez)
	materiali 2**	punim lastik 1:1
Hollësia e fijes	Fibra pambuku	70/1 Nm +-5Nm
	Fibra polipropileni	65 x 1 dtex +-5 dtex
Masa gr/m ² (*trupi; **jaka dhe bordura e mëngës) (± 5%)	materiali 1*	150 -170 gr/m ²
	materiali 2**	660 gr/m ²
Dendësia e trikotazhit (± 10%) (*trupi; **jaka dhe bordura e mëngës)	materiali 1*	Kolonat (Dh) 14/1 cm Rreshtat (Dv) 26/1 cm

	materiali 2**	Kolonat (Dh) 7/1 cm Rreshtat (Dv) 12/1 cm
Qëndrueshmëria e ngjyrës	nota 4—5 (Shkalla gri)	Ngjyrosja duhet të jetë në fije.
Qëndrueshmëria e ngjyrës ndaj dritës (rrezatimit UV)	nota ≥ 6 (Shkalla Blu)	Tekstili duhet të ketë qëndrueshmëri të lartë
Qëndrueshmëria në fërkim	mbi 10000 cikle	
Efekti pilling (kokërrzimi)	Pas 7000 cikleve te vlerësimit ≥ 3	
Rezistenca ndaj shpimit	Aplikimi ≥ 400	
Ndryshimet dimensionale ne larjen ne 40°C	- 6.0 ne +3.0%(Max)	
Përcjellshmëria ne ajër ne nje sipërfaqe prej 20cm dhe nje presion prej 100 Pa(mm/s)	Aplikimi ≥ 600	
AZO ngjyrues	Nuk duhet te jene te pranishem	
pH	4.0 - 7.5	

Grupi i kontrollit të cilësisë nuk do të aprovojë përdorimin e tekstileve apo materialeve të tjera, në të cilat do të jenë të pranishme këto defekte :

- elementë *Velcro* që konsumohen shpejt gjatë përdorimit,
- papastërtitë me origjinë bimore,
- njolla vaji ose boje,
- tonalitete të ngjyrës,
- oksidime,
- rrudhosje,
- mungesë ose kapërcim të sytheve,
- trashim të fijeve,
- vrima në sipërfaqe,
- dhe çdo parregullsi tjetër që cenon anën funksionale dhe estetike të uniformës.

b. Materialet ndihmëse dhe aksesorët që duhet të përdoren për ndërtimin e artikullit bluzë polo me mëngë të shkurtra:

Frazelinë		
Shtresë termoadezive prej frazeline për përforcimin e bordurës së kopsave dhe vrimave.	Fortësi	e lehtë
	Pesha e përafërt	80gr/m ²
	Përbërja	100% pambuk
	Ngjyra	e errët
Frazelinë për qepjen e elementëve <i>Velcro</i> . Frazelina duhet të jetë e përshtatshme për tekstin e bluzës.		
Aksesorë të tjerë		
Fileto për përforcimin e bashkimit të jakës me trupin. 	Përbërja	100% pambuk
	Trashësia	1 cm
	Ngjyra	blu (njësoj me materialin 1)
	Përmasat <i>Velcro</i> të gjoksit (2 copë)	86 x 30 mm

Element <i>Velcro</i> femër për vendosjen e numrit të identifikimit/shenjës se mbiemrit dhe elementë <i>Velcro</i> me formën e stemës dhe shenjave që do të vendosen tek mëngët e bluzës. 	Përmasat <i>Velcro</i> të mëngëve (2 copë)		70 x 80 mm
	Përbërja	100% fibra poliamide	
	Trashësia	2.2 mm	
	Masa lineare	41 g/m ± 5 %	
	Ngjyra	njësoj si bluza	
	Qëndrueshmëria në temperatura ekstreme		
	E ftohtë	- 30 °C	
	E nxehtë	pika e dobësimit: 180 °C pika e shkrirjes: 210-250 °C	
	Qëndrueshmëria e ngjyrës		
	Në larje	jo më pak se 3	
Në ujë të nxehtë			
Në djersë			
Në fërkim			
Filli			
Fill qepës i përshtatshëm për të gjitha qepjet e trikotazhit (përfshi vrimat e kopsave).	Përbërja	100% poliestër	
	Dëndësia lineare	120 X 2 dTex	
	Qëndrueshmëria në tërheqje	jo më pak se 12 N	
	Zgjatueshmëria	≥ 15%	
	Ngjyra	njësoj si tekstili	
Kopsat			
Kopsa plastike 	3 copë Nr. 18 (d 11 mm) + 1 rezervë		
	Lloji	me 4 vrima	
	Ngjyra e kopsës	Blu e errët	
	Materiali	100% poliestër	
	Gdhendje në kopsë	POLICIA E SHETITIT	
	Ngjyra e shkrimit	njësoj si kopsa	
	Lloji i gërmës (font)	Myriad pro, bold	
	Qepja e kopsës	Kryq	
Etiketa			
Etiketë prej tekstili për mirëmbajtjen dhe lëndën e parë.	Përbërja	100% poliestër	
	Ngjyra	e bardhë	
Stampat			
Stampa POLICIA, përpara 	Stampim me material/bojë reflektive		
	Ngjyra	Gri fluoreshente	
	Përmasat referencë	8.6 x 1.7 cm	
	Lloji i gërmës	Myriad Pro Bold	
	Ky produkt duhet të jetë i certifikuar për aftësi të lartë reflektive sipas standardit ISO 20471:2013		
Materiali duhet t'i rezistojë mbi 105 cikleve të larjes në kushte shtëpie me temperaturë 60 °C.			
Stampa POLICIA, mbrapa	Stampim me material/bojë reflektive		
	Ngjyra	Gri fluoreshente	

	Përmasat referencë	meshkuj	35 x 7 cm
		femra	28 x 5.7 cm
	Lloji i germës	Myriad Pro Bold	
Ky produkt duhet të jetë i certifikuar për aftësi të lartë reflektive sipas standardit ISO 20471:2013			
	Materiali duhet t'i rezistojë mbi 105 cikleve të larjes në kushte shtëpie me temperaturë 60 °C.		

Shirit reflektiv (fluoreshent) me vija diagonale për pjesën e gjoksit dhe mëngëve të bluzës			
	Ngjyra	gri argjend	
	Përbërja	100% poliester	
	Përmasat	lartësia	≈ 3 cm
	Shiriti duhet të përbëhet nga lente retro-reflektive me kënd të gjerë që ngjiten në tekstil me temperaturë të lartë.		
	Ky produkt duhet të jetë i certifikuar për aftësi të lartë reflektive sipas standardit ISO 20471:2013		
	Stampa duhet të duket nga një distancë prej mbi 150 m		
	Stampa duhet të rezistojë mbi 105 cikle larjesh.		

c. Materialet që nevojiten për paketimin e artikullit *bluzë polo me mëngë të shkurtra*:

Fotografia e mëposhtme shërbejnë vetëm si shembull ilustrues.


1 qese polietileni për paketimin e bluzës
1 kuti kartoni për ruajtjen e bluzave

MASAT DHE SASIA E PRODHIMIT

Artikulli *bluzë polo me mëngë të shkurtra* do të porositet dhe do të prodhohet në masat S–XXL në sasi të që do të rezultojnë pas matjeve të punonjësve të Gardës që e përdorin këtë uniformë.

Marrja e masave trupore

Marrja e masave trupore të mëposhtme është e nevojshme për nxjerrjen e përmasave të këtij artikulli:



Meshkuj		
2	Perimetri i qafës	cm.
3	Perimetri i gjoksit	cm.
4	Perimetri i belit	cm.
5	Perimetri në pjesën e vitheve	cm.
6	Perimetri i muskullit të krahut	cm.
10	Gjatësia nga koka tek këmbët	cm.
12	Lartësia e trupit mbrapa (nga kocka cervikale në vijën e belit)	cm.
13	Gjatësia e shpatullës (mbrapa)	cm.
14	Gjatësia nga supi në brryl	cm.
15	Gjatësia e krahut, nga supi në kyçin e dorës	cm.
16	Lartësia perpara nga supi në vijën e belit	cm.
	Gjatësia e supit	cm.

Femra		
2	Perimetri i qafës	cm.
3	Perimetri i gjoksit	cm.
4	Perimetri i krahavorit (poshtë gjoksit)	cm.
5	Perimetri i belit	cm.
6	Perimetri në pjesën e barkut	cm.
7	Perimetri në pjesën e vitheve	cm.
8	Lartësia nga supi në gjoks	cm.
9	Distanca mes gjokseve	cm.
10	Perimetri i muskullit të krahut	cm.
12	Lartësia perpara nga supi në vijën e belit	cm.
13	Lartësia nga vija e belit në vijën e kockës abdominale	cm.
17	Lartësia e trupit mbrapa (nga kocka cervikale në vijën e belit)	cm.
19	Gjatësia e supit	cm.
20	Gjatësia nga supi në brryl	cm.
25	Gjatësia nga koka tek këmbët	cm.

3. NGJYRAT REFERENCE



Ngjyra blu spektri sipas CIELCH 18, 14.587, 295.349 për tekstin kryesor të bluzës, jakës dhe elementëve *Velcro*.

Ngjyra gri spektri sipas CIELCH 73, 0.743, 200.028 për shiritin dhe stampën reflektive (fluoreshent).

Ngjyrat e paraqitura në këtë dokument shërbejnë si referencë për prodhuesin. Aprovimi i tyre do të kryhet në momentin e dorëzimit të kampioneve.

Kujdes! Çdo zëvendësim, përshtatje apo ndryshim duhet të bëhet me miratimin paraprak të grupit të punës së specialistëve teknik, nëpërmjet një kërkesë zyrtare.

PËRPUNIMI DHE PËRGATITJA E MATERIALEVE BAZË

Përgatitja e lëndës së parë dhe materialeve ndihmëse në mënyrë të saktë dhe të drejtë është bazë për një ecuri cilësore të proceseve teknologjike të mëtijshme gjatë prodhimit me cilësi të artikullit *bluzë polo me mëngë të shkurtra*.

Modelimi (ndërtimi i kallëpeve)

Ky proces duhet të realizohet me metoda matematikore të ndërtimit të kallëpeve. Pjesët përbërëse të artikullit/produktit duhet të kenë përputhshmëri të saktë dhe mbi to duhet të shënohen shenjat e prerjes dhe të bashkimit me njëra-tjetrën. Të gjitha pjesët e artikullit duhet të pozicionohen në tekstil në drejtim të gjatësisë së sythave.

Relaksimi i tekstileve të trikotuara

Tekstili i trikotuar duhet të qendrojë i shtrirë për 24 orë para se të kalojë në procesin e prerjes.

Prerja

Gjatë procesit të prerjes nuk duhet të ketë devijime në fletët e fundit të dyshekut. Rekomandohet që dysheku të mos ketë më shumë se 60 fletë. Kujdes duhet të bëhet dhe në pjesët e harkuara të detajeve që buzët e prera që të mos jenë me dhëmbëza.

Markimi i pjesëve përbërëse të artikullit

Ky proces duhet të garantojë që të gjitha detalet e produktit të kenë të njëjtën ngjyrë, pa tonacione të dukshme.

Aplikimi i frazelinës

Ngjitja e frazelinës duhet të bëhet me presë speciale në presion 2—3 bar, me avull, në temperaturën dhe kohëzgjatjen e caktuar për materialin përkatës. Ky proces duhet të kryhet sa më i saktë, në mënyrë që produkti mos të humbasë formën fillestare pas hekurosjes me avull, larjes dhe lagies nga shiu. Nuk lejohet ngjitja e frazelinës me shtesa. Kujdes të veçantë duhet t'i kushtohet prerjes së detaleve. Nuk duhet të mbeten shenja të hekurit/presës në tekstil. Adezivi nuk duhet të depërtojë në anën tjetër të tekstilit.

NDËRTIMI I BLUZËS



Bluzë polo me mëngë të shkurtra për patrullat, për meshkuj

- Jaka
- Pjesa e përparme
- Pjesa e pasme (shpina)
- Dy mëngë të shkurtra
- Dy shirita lastik të mëngëve


JAKA

Jaka duhet të ndërtohet me tekstil trikotazh methurje lastik 1:1 me drejtim vertikal dhe lartësi standarde 8 cm.

Bashkimi i dy pjesëve të bluzës duhet të bëhet me anë të një filetoje prej pambuku me gjerësi rreth 1 cm. Qepja e filetos tek jaka dhe tek bluza duhet të bëhet me dy tegela lineare një gjilpërësh. Ajo duhet të fillojë dhe të mbarojë tek gjysma e gjerësisë së bordurave të kopsave dhe vrimave të kopsave.



Bordura e masës M për duhet të ketë 3.5 x 14 cm, femrat 2.5 x 13 cm.



pjesë në gjysëm rrethi me të njëjtin tekstil si bluza

kopsave të meshkujt përmasa ndërsa për

Bordura e vrimave dhe e kopsave duhet të jenë të dyja të përforcuara me frazelinë termoadezive.

Në pjesën e poshtme bordurat duhet të bashkohen me njëra-tjetrën me një qepje në formë drejtkëndore me përmasa 3.5 x 1 cm për meshkujt dhe 2.5 x 1 cm për femrat.

Tek meshkujt kopsat duhet të jenë në anën e djathtë ndërsa tek femrat kopsat duhet të jenë në anën e majtë. Ato duhet të jenë Nr. 18 (11 mm). Qepja e tyre duhet të bëhet kryq me fill me ngjyrë blu të errët.

Vrima e parë e kopsës duhet të jetë me drejtim horizontal. Ajo duhet të hapet në një distancë 1 cm nga buza e sipërme e bordurës. Vrimat e tjera duhet të jenë me drejtim vertikal dhe të baraslarguara me një distancë 4.5 cm nga njëra-tjetra. Vrimat e kopsave duhet të kenë gjatësi 18 mm.

PJESËT PËRPARA DHE MBRAPA

Si përpara ashtu edhe mbrapa bluza duhet të ndërtohet me nga një pjesë të vetme.

Pjesa e përparme e dhe ajo e pasme duhet të bashkohen me njëra-tjetrën me tegel linear një gjilpërësh të përforcuar nga brenda me tegel syzator.

Në linjën e supeve duhet qepur një fileto përforcuese për ruajtjen e formës së supeve.

Midis shpatullave të bluzës së meshkujve, në brendësi, duhet të qepet një shtresë përforcuese në formën e gjysmë rrethit me të njëjtin tekstil si bluza. Rrezja e rrethit duhet të jetë rreth 9 cm. Përmasa e saktë e rrethit duhet të ndryshojë sipas masës së bluzës.

Në fund bluza duhet të mbyllet me një palosje me lartësi rreth 2.5 cm. Palosja duhet të qepet me tegel syzator dy gjilpërësh.

Pjesët “e çara” duhet të jenë të larta 4 cm dhe duhet të përforcohen me tegel linear një gjilpërësh sipërfaqësor nga secila anë e buzës.

Fundi i bluzës duhet të jetë i drejtë dhe duhet të ketë të njëjtën gjatësi në të dyja anët.



E çara anësore në bluzë

MËNGËT

Mëngët duhet të përbëhen nga një pjesë të vetme tekstili.

Përmasat e mëngës duhet të ndryshojnë në varësi të masës së bluzës.

Mënga duhet të bashkohet me trupin e bluzës me 2 tegela: 1 tegel qepës linear dhe 1 tegel syzator 5 gjilpërësh.

Mënga duhet të mbyllet me tekstil trikotazh methurje “llastik” 1:1 me drejtim vertikal (i njëjtë me atë të jakës) me lartësi rreth 3 cm.

Tekstili trikotazh duhet të bashkohet me mëngën me tegel linear dy gjilpërësh dhe të përforcohet nga brenda me tegel syzator.

Përmasa të pandryshueshme për të gjitha masat e bluzës për femra dhe për meshkuj	
Lartësia e jakës	8 cm
Lartësia e shiritit llastik të mëngës	3 cm
Madhësia e çarjeve	4 cm
Lartësia e kthimit të palës së fundit të bluzës	2.5 cm

APLIKIMI I STAMPAVE DHE VELCRO –ve

SHIRITI REFLEKTIV

Bluzat duhet të stampohen me një shirit të vijëzuar reflektiv fluoreshent, lehtësisht të dallueshëm, me ngjyrë gri me lartësi rreth 3 cm. Shiriti duhet të stampohet përgjatë gjithë perimetrit të gjoksit dhe të mëngëve.

Shiriti duhet të jetë i cilësisë më të lartë. Stampimi nuk duhet të fshihet apo të humbasë efektin reflektiv gjatë përdorimit, nuk duhet të pësojë plasaritje apo dëmtime të tjera. Stampa duhet të stampohet drejt dhe të mos ketë pjesë të pa ngjitura mirë ose valëzime në të gjithë gjatësinë e saj.




SHKRIMI “POLICIA”, PËRPARA

Në pjesën e përparme të bluzës, në anën e djathtë të gjoksit, duhet të stampohet fjala POLICIA. Stampa duhet të pozicionohet 1 cm mbi elementin Velcro në të djathtë.


Përmasat e shkrimit duhet të jenë sipas ilustrimit teknik. Prerja e germave duhet të bëhet me precizion të lartë. Shkrimi nuk duhet të shtrembërohet ose të deformohet horizontalisht ose vertikalisht. Proporcionet e fjalës duhet të jenë rreptësisht sipas raporteve të përcaktuara tek lloji i gërmës. Germat duhet të jenë kapitale dhe lloji i gërmës duhet të jetë *Myriad Pro Bold*.

Stampimi duhet të jetë prej materiali reflektiv fluoreshent ngjyrë gri dhe i cilësisë më të lartë. Përmasat e shkrimit të vogël duhet të jenë për të dyja gjinitë njësoj, 8.6 x 1.7 cm.

Stampa duhet të jetë e rregullt, uniforme dhe e aplikuar sipas ilustrimit teknik. Ajo nuk duhet të fshihet apo të humbasë efektin reflektiv gjatë përdorimit, nuk duhet të pësojë plasaritje apo dëmtime të tjera.



SHKRIMI “POLICIA”, MBRAPA



Në pjesën e pasme të bluzës, në shpinë, duhet të vendoset shkrimi POLICIA. Shkrimi duhet të jetë i vendosur në distancë 10 cm poshtë jakës.

Përmasat e shkrimit duhet të jenë sipas ilustrimit teknik. Shkrimi nuk duhet të shtrembërohet ose të deformohet horizontalisht ose vertikalisht. Proportionet e fjalës duhet të jenë rreptësisht sipas raporteve të përcaktuara tek lloji i germës. Germat duhet të jenë kapitale dhe lloji i germës duhet të jetë *Myriad Pro Bold*.

Stampimi duhet të jetë i cilësisë më të lartë. Stampa duhet të jetë e rregullt, uniforme dhe e aplikuar sipas ilustrimit teknik. Ajo nuk duhet të fshihet apo të humbasë efektin reflektiv gjatë përdorimit, nuk duhet të pësojë plasaritje apo dëmtime të tjera.

ELEMENTËT VELCRO

Bluza duhet të pajiset me 4 elementë *Velcro* femër:

- 1 copë për vendosjen e gradës së gjoksit, me përmasa 8.6 x 3 cm.
- 1 copë për numrin e identifikimit, me përmasa 8.6 x 3 cm.
- 1 copë me përmasa 8 x 7 cm me formën e Stemës së Gardës në mëngën e majtë.

-
- 1 copë me përmasa 8 x 7 cm për vendosjen e shenjave në mëngën e djathtë.

Elementët *Velcro* në gjoks duhet të vendosen paralel me njëra-tjetrën dhe të barazlarguar nga bordura e kopsave. Elementi *Velcro* për vendosjen e shenjave në mëngë duhet të ketë një distancë rreth 6 cm nga gavatura e mëngës.

Elementët *Velcro* duhet të qepen me tegel linear perimetral me ngjyrë blu dhe të përforcohen me dy tegela diagonalë. Qepja e elementëve *Velcro* duhet të bëhet me ndihmën e shtresës përforcuese prej frazeline në mënyrë që të mos ketë dëmtime ose grisje të tekstit gjatë qepjes dhe gjatë përdorimit.

KUSHTE TË DOMOSDOSHME


- Produkti përfundimtar duhet të jetë identik me kampionin e aprovuar gjatë procedurave të vlerësimit.
- Filli qepës duhet të ketë ekzakt karakteristikat e përcaktuara tek *Specifikimet Teknike*.
 - Tegelat e qepjes së bluzës duhet të jenë me hap 30 shpime në 5 cm.
 - Tegelat duhet të jenë të drejtë, uniformë, simetrik, me elasticitetin e duhur dhe nuk duhet të kenë shqepje ose defekte.
 - Tegelat duhet të jenë të fortë dhe nuk duhet të shqepen nëse tërhiqen me duar. Fortësia e tegelave duhet të jetë mbi 12N.
 - Tegelat duhet të jenë të përforcuar në ekstremitete.
- Të gjithë elementët e bluzës duhet të jenë simetrik.
- Përpara se të fillojë prodhimi i artikujve, prodhuesi duhet të bëjë testimin e stabilitetit dimensional (aftësinë e tekstit për të ruajtur formën fillestare pas prerjes, qepjes, larjes, hekurosjes, etj.)
- Në varësi të llojit, tekstilet nuk duhet të lahen ose hekurosen në temperatura që kalojnë kufijtë e specifikuar nga prodhuesi në skedën teknike sipas EN ISO 3758 ose që janë specifikuar në këtë dokument. Gjithashtu tekstili nuk duhet të fitojë shkëlqim gjatë hekurosjes.
- Tekstili duhet të ketë rezistencë të lartë ndaj rrezatimit Ultraviolet.
- Tekstili duhet të ketë rezistencë maksimale ndaj përdorimit dhe konsumit.
- Shiriti reflektiv duhet t'i rezistojë mbi 105 cikleve të larjes në kushte shtëpie me temperaturë 60 °C.
- Kufiri i lejuar i gabimit tek përmasat e bluzave është $\pm 2\%$. Tek qepja e jakës nuk lejohet asnjë kufi gabimi.
- Qepja e kopsave në bluzë duhet të bëhet rreptësisht sipas përshkrimit tek *Specifikimet Teknike*.
- Kopsat plastike duhet të qepen me drejtim vertikal dhe shkrimi POLICIA E SHTETIT duhet të qëndrojë gjithmonë lart.
- Kopsat duhet të kenë pamje të rregullta. Nëse hidhen me forcë në tokë nga një lartësi prej 2 metrash, kopsat nuk duhet të thyhen, plasariten, gërvishten ose të pësojnë dëmtime të tjera.
- Elementëve *Velcro* nuk duhet t'u dalin fijet anësore gjatë përdorimit të shpeshtë.
- Tekstilet, materialet dhe aksesoret e përdorur në prodhimin e këtij artikulli nuk duhet të përmbajnë substanca të dëmshme për shëndetin e njeriut apo AZO ngjyrues. Për produktin e gatshëm duhet të paraqiten rezultatet e këtyre testeve sipas standardeve:
 - a. EN ISO 14362-1:2017
 - b. EN ISO 14362-3:2017
 - c. EN ISO 3071:2006 (vlera limit e pH për veshjet që kanë kontakt direkt me lëkurën është 4.0 - 7.5 dhe për veshjet që nuk kanë kontakt direkt me lëkurën është 4.0 - 9.0)

- Prodhuksi i artikullit të mësipërm duhet të jetë i pajisur me certifikatën e standardit ISO 9001.

AMBALLAZHIMI DHE ETIKETIMI

Bluza duhet të pajiset me një etiketë prej tekstili, në të cilën duhet të shkruhet emri i fabrikës, viti i prodhimit, përmasa, përbërja, dhe instruksionet e mirëmbajtjes. Kjo etiketë duhet të qepet në brendësi të bluzës, në anën e majtë, rreth 12 cm nga fundi i bluzës. Po në këtë etiketë duhet të vendoset edhe kopsa rezervë.

Bluza duhet të paloset duke e vendosur njërën nga mëngët në brendësi dhe tjetra përpara. Shiko foton për referencë



Bluza e palosur duhet të vendoset në qese polietileni. Në çdo kuti duhet të vendosen bluza të një numri dhe gjinie. Çdo kuti duhet të ketë sasi të barabartë bluzash.

Kartoni i kutive (me peshë rreth 600 gr/m²) duhet të jetë i përshtatshëm për transportin e sigurt të produkteve. Çdo kuti duhet të jetë e pajisur me një etiketë me adeziv, në të cilën duhet shënuar masa e bluzës, viti i prodhimit, sasia dhe emri i fabrikës prodhuese.

Kutitë duhet të jenë të padëmtuara dhe të izoluar me shirit ngjitës (natriban).

TRANSPORTI

Kutitë me artikullin *bluzë polo me mëngë të shkurtra* duhet të transportohen nga prodhuesi deri tek ambientet e Gardës. Transporti mund të bëhet me çdo lloj mjeti që garanton transport të sigurt të produktit.

Kujdes! Artikulli konsiderohet i pranuar vetëm kur plotëson të gjitha kërkesat e Specifikimeve Teknike.

Afati i lëvrim: Brenda 90 ditëve nga lidhja e kontratës, por jo më vonë se data 20 dhjetor e vitit planifikues.

Sipas Vendimit nr.653, date 03.11.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e paraqitjes, të formës dhe të specifikimeve teknike të gradave, si dhe për përcaktimin e simboleve, të uniformës, të shenjave dalluese dhe normave të veshmbathjes së punonjësve të Gardës së Republikës së Shqipërisë”:

Uniforma për efektivin shofer (makinë policie) dhe motoçiklist ceremonial, është e njëjtë me atë të Policisë së Shtetit (Policia Rrugore), me gradat e shenjat dalluese të Gardës së Republikës.

SPECIFIKIME- TE KN I KE

OBJEKTI: 24. Pelerine shiu për efektivin shofer (makinë policie) dhe motoçiklist ceremonial, është e njëjtë me atë të Policisë së Shtetit (Policia Rrugore), me gradat e shenjat dalluese të Gardës së Republikës.

Ky specifikim teknik në mënyrë të detajuar paraqet kërkesat themelore teknike të domosdoshme të artikullit “Pelerin shiu policia rrugore”. Në këtë specifikim teknik përcaktohen gjithashtu dhe kërkesat teknike të aksesoreve që shoqerojnë artikullin “Pelerin shiu policia rrugore”. si produkt i gatshëm .

Të gjitha përcaktimet teknike të këtij specifikimi teknik duhen të zbatohen detyrimisht saktë nga prodhuesi.

Për procedurë vlerësimi dhe miratimi nga perdoruesi, ofertuesi është i detyruar të paraqesi si oferte teknike të realizuar sipas kërkesave të këtij specifikimi teknik :

- 1 (një) copë “pelerin shiu” me masë gjoksi M.

Mostra duhet të kenë vulë dhe etikete origjinale të fabrikes prodhuese.

- 1 (një) pjesë Pelhurë impermeable (tekstil i gomuar) 100 % poliamid me Iluster nga brënda, mostër me permasa 50 x 50 cm.

- Fletë-analize laboratorike të treguesve fiziko-mekanik e kimik të lëndës së parë të përdorur nga prodhuesi.

Copa e mostres, lëndës së parë dhe ajo që i bashkëngjitet raport-analizes duhet të jenë detyrimisht të njëjta.

Pelerinës si dhe lëndës së parë u qepet nga një etiketë tekstili në të cilën shkruhet: moster

“Pelerin shiu policia rrugore”. emri i ofertuesit, data dhe vula e ofertuesit.

Mungesa e mostres, lëndës parë dhe fletë analizes që shoqeron ato është kusht skualifikues.

Karakteristikat e përgjithëshme

Ngjyra : Blu e errët.

Lenda e pare : Material ngjyrë e blu e erret 100 % nylon e veshur me shtresë poliuretani nga brenda.

Masa: 130 gr/m²(±3%)

Thurja : Oxford.

Depërtueshmëria e ujit dhe aftësi ajërosëse e tekstilit mbi 20,000mm / 15,000 gr

Qendrueshmëria ne kg : Në bazë: jo me pak se 90.

Në ind: jo me pak se 85.

Qendrueshmëria e ngjyrës: Shumë e mire,

Tekstili nuk duhet të ketë aroma të pakëndshme dhe nuk duhet të jetë i ashpër.

MATERIALET NDIHMESE :

- Penj qepje polyester ngjyre e zeze,
- kopsa ebaniti te zeza,
- susta (butona femer-mashkull),
- ngjites.
- shirit reflektiv
- Llastik tubolar me element plastikë me ngjyrë të zezë, 100% polyester, me perimenter 3 mm, për kapuçin e mushamasë.

Materiali (lenda e pare) qe perdoret per pelerinen e shiut te jete i padepertueshem nga uji, nuk lejohen tonacione ngjyrash ose difekte te tjera ne sipërfaqe si njolla te ndryshme, oksidime, rrudhosje, mungese apo trashim fijesh etj.

Materiali te jete rezistent ndaj agjenteve te ndryshem atmosferike (temperatures etj.)

Prodhimi i artikullit “Pelerine shiu policia rrugore” duhet te realizohet sipas nje procesi teknologjik te percaktuar mbi bazen e kerkesave dhe kushteve teknologjike te sakta ne secilen faze te realizimit te tij. Prodhimi ndahet ne tre faza kryesore te cilat jane :

Perpunimi pergatitor

Konfeksionimi (procesi i qepjes)

Ambalazhimi, marketimi dhe ektiketimi

Perpunimi pergatitor ka te beje me kolaudimin e lendeve te para dhe ndihmese, skicimin, prerjen ne prestari, marketimin dhe kollaritjen e pjeseve perberese te pelerines.

Konfeksionimi ka te beje me qepjen e pjeseve perberese te pelerines sipas nje procesi linear te percaktuar. Ne faza te ndermjetme te ketij procesi do te kryhet hekurosja dhe presimi me avull i gjysem produkteve. Ne perfundim kryhet dhe hekurosja e produktit te gatshem.

Ambalazhimi ka te beje me etiketimin, amblazhimin per çdo produkt dhe amblazhimin total te gjithë sasise te produktit te gatshem dhe pergatitjen e tij per levrimin drejt magazinave te perdoruesit.

Skicimi

Ky proces duhet te realizohet me metodat matematikore te programimit linear te cilat sigurojne nje shenim te sakte te prerjeve dhe shenjave sipas vizatimeve duke pasur kujdes qe detajet e pelerines duhet te jene ne drejtim te fijeve te bases.

Prerja

Procesi i prerjes duhet te behet me shume kujdes qe te mos te kete devijime ne fletet e fundit te dyshekut i cili eshte mire qe te mos te kaloje 80 flete. Kujdes duhet te behet dhe ne pjeset e harkuara te detajeve dhe buzet e prera te mos jene me dhembeza.

Marketimi

Ky proces eshte shume i rendesishem sepse eliminon qepjen e detajeve te pelerines me tonacione te ndryshme duke siguruar njellojshmeri ne ngjyre te artikullit.

NDERTIMII PELERINES (mushamase)



Pelerina e shiut duhet të ketë prerje pardesyje dhe duhet të qepet me tekstil prej najloni të padepërtueshëm nga uji dhe era.

Pjesët përbërëse të pelerinës:

- Dy pjesët e përparme

- Pjesa e pasme

- Jaka

- Dy mëngë të gjata të tipit *raglan*

- Një kapuç i lëvizshëm

Të gjithë tegelat qepës të pelerinës duhet të përforcohen me shirita me termosaldim.

Mushamaja e shiut duhet të përmbushë standardet ndërkombëtare për përdorim nga punonjësit e policisë ose të sigurisë. Ajo duhet të jetë e pajisur me shirita fluoreshentë ngjyrë gri të hapur për vizibilitet të lartë tek trupi dhe krahët.

Jaka e pelerinës duhet të jetë 10 cm e lartë. Ajo duhet të jetë me gjuhëz dhe mbyllja e saj duhet të bëhet me element velcro femer/mashkull. Përmasat e gjuhëzës duhet të jenë 10 x 2.5 cm, ndërsa ato të elementit velcro 4x2 cm.

Mbyllja e pelerinës duhet të bëhet me anë të 5 perçinave metalike. Bordura e perçinave

duhet të jetë e mbuluar me kapak me gjerësi 6 cm. Buza e kapakut duhet të përshkohet nga një tegel linear një gjilpërësh me distancë 5 mm.

Mbi kapak duhet qepur shiriti reflektiv me gjerësi 5 cm.

Xhepat pelerina duhet të pajiset me dy xhepa të brendshme me kapak me gjerësi 19 cm.

Permasat e astarit të xhepit duhet të jenë 19 x 20 cm.

Kapuçi duhet të kapet tek jaka me 3 përgjina metalike. Kapuci duhet të jetë i pajisur me llastik tubular dhe me rregullator plastik për shtrengimin e tij.

Menget duhet të jenë të llojit *ruglan* dhe të qepen me trupin me tegel linear një gjilpërësh.

Mëngët duhet të pajisen me perçina tek parakrahët për shtrëngim.

Tek zona e manshetave duhet të qepet shiriti reflektiv me gjerësi 5 cm.

Menget dhe fundi i pelerines duhet të mbyllen me një palosje të brendshme me lartësi 2 cm me tegel linear një gjilpërësh.


Pelerina e shiut duhet të jetë simetrik në të gjithë elementet përberes të saj.

SHKRIMI “POLICIA”, MBRAPA

Në pjesën e pasme të mushamasë, në shpinë, duhet të vendoset shkrimi POLICIA. Shkrimi duhet të jetë i vendosur në një distancë rreth 20 cm poshtë jakës (kapuçi i ulur nuk duhet të mbulojë shkrimin). Përmasat e shkrimit duhet të jenë sipas ilustrimit teknik. Shkrimi nuk duhet të shtrembërohet ose të deformohet horizontalisht ose vertikalisht. Proporcionet e fjalës duhet të jenë rreptësisht sipas raporteve të përcaktuara tek lloji i gërmes. Germat duhet të jenë kapitale dhe lloji i gërmës duhet të jetë *Myriad Pro Bold*.

Stampimi duhet të jetë i cilësisë më të lartë. Stampa duhet të jetë e rregullt, uniforme dhe e aplikuar sipas ilustrimit teknik. Gjatë përdorimit të mushamasë stampa nuk duhet të pësojë plasaritje apo dëmtime të tjera.

Stampë reflektive mbrapa :



Tegelat e qepjes të elementeve përberes të pelerines duhet të jenë dysh të realizuara me dygjilpërësh dhe me hap 30 shpime në 5 cm. Tegelat duhet të jenë të forta, uniforme, të mos kenë vende të shqepura, të jenë simetrike, të rregullt dhe të drejta. Tegelat duhet të jenë të forta në mënyrë të tillë që të mos hapen nën ushtrimin e forcës së duarve. Fortesia e tegelave të jetë mbi **12 kG**. Tegelat duhet të jenë të forcuara në fund. Peri që do të përdoret për qepje duhet të jetë e fortë dhe me ngjyrë të zeze me **Nm 80/2**, 100 % **PES**.

KUSHTE TË DOMOSDOSHME

- Produkti përfundimtar duhet të jetë identik me kampionin e aprovuar gjatë procedurave të vlerësimit
- Filli i qepjes duhet të ketë ekzakt karakteristikat e përcaktuara tek *Specifikimet*

Teknike.

- Tegelat e qepjes te mushamase duhet te jene me hap 5 shpime ne 1 cm.
- Tegelat duhet te jene te drejte, uniforme, simetrike dhe nuk duhet te kene shqepje ose difekte.
- Tegelat duhet te jene te forte dhe nuk duhet te shqepen nese terhiqen me duar. Fortesia e tegelave duhet te jete mbi 12 N.
- Tegelat duhet te jene te perforcuar ne ekstremitete.
- Tegelat qepes duhet te iene me termosaldim.
- Te gjithë elementet e mushamase duhet te jene simetrike.
- Perpara se te filloje prodhimi i artikujve, prodhuesi duhet te beje testimin e stabilitetit dimensional (aftesine e tekstilit per te ruajtur formen fiUestare pas prerjes, qepjes, larjes, etj.)
- Tekstili duhet te kete rezistence maksimale ndaj rrezatimit Ultraviolet.
- Tekstili duhet te keteveti hidrofobike.
- Tekstili duhet te kete rezistence maksimale ndaj perdorimit dhe konsumit.
- Tekstili duhet te kete rezistence maksimale ndaj pershkueshmerise se eres dhe ujit dhe te siguroje ajerim te mire te trupit (EN 343 klasa 3)
- Mushamaja duhet te jete e lehte per tu mirembajtur.
- Artikulli duhet te prodhohet sipas permasave qe do te dalin nga procesi i matjeve te te gjithë personelit te *Policise se Shtetit*. Rezultatet e procesit te matjeve te personelit duhet te marrin aprovimin e grupit te kontrollit prane *Policise se Shtetit*.
- Kufiri i lejuar i gabimit tek permasat e mushamase eshte $\pm 2\%$.
- Elementeve *Velcro* nuk duhet t'u dalin fijet anesore gjate perdorimit te shpeshte.
- Tekstilet, materialet dhe aksesoret e perdorur ne prodhimin e ketij artikulli nuk duhet te permbajne substanca te demshme per shendetin e njeriut apo AZO ngjyrues.
- Prodhuesi i artikullit te mesiperm duhet te jete i pajisur me Zertifikaten e standardit ISO 9001- 2008.

MARKETIMI:

Çdo pelerine pajiset me etikete te qepur ne pjesen e brendshme te saj, ku te kete te shenuar numrin e gjoksit dhe prerjen.

AMBALLAZHIMI:

Çdo pelerine paloset ne madhesine e çantes , futet ne te. Vendosen ne kuti kartoni me 20 cope secila. Ne çdo kuti vendosen pelerina te nje numri.

Artikulli “**Pelerine shin**” prodhohet dhe porositet nga perdoruesi ne sasite perkatese sipas masave te gjokseve **S , M , L , XL , XXL** te cilat subjekti prodhues eshte i detyruar ta respektojte saktesisht. Permasat e duhura te elementeve te cilat bejne pjese ne ndertimin e artikullit “**Pelerine shin**” jepen ne pershkrimet,tabelat dhe figurat e meposhteme.

Pelerine shin permasat produkt i gatshem (cm) jepen ne kete table :

Gjatesia e trupit	Prerja	Iniciali prerjes	Gjatesia e pelerines produkt i gatshem
150-165	e pare	I	120
166-176	e dyte	II	126
177- 190	e trete	III	132

Sasia sipas numerave do behet mbi bazen e kerkesave te Gardes me lidhjen e kontrates me prodhuesin.

Afati i levriminit: Brenda 90 diteve nga lidhja e kontrates, por jo me vone se data 20 dhjetor e vitit planifikues.

Kolaudimi e marrja ne dorzim.

Pranimi i te gjithes sasise te artikullit “Pelerine shiu *për patrullat e Policise së Shtetit*” te percaktuar ne kontrate dhe te dorezuar ne magazinën e Gardes, do te behet vetem ne baze te rezultateve qe do te merren gjate procesit te Kolaudimit per te gjithes sasine e produktit te gatshe me te dorezuar ne magazine. Kolaudimi do te behet mbi bazen e rezultateve te Flete-analizave laboratorike te leshuara nga Laboratore

te Akredituar te Tekstil-Konfeksioneve, qe shoqërojnë mallin, të sjella nga kontraktuesi, sipas përcaktimeve në kontratë, dhe ekzaminimit e të mallit të furnizuar, qe do të bëjë “Komisioni i pritjes, kontrollit dhe pranimi të mallit të Gardes së Republikës”, i cili kryen direkt matjet e vlersimit organo- leptike të sasise së mallit të dorëzuar dhe bën krahasimin e të gjithë këtyre rezultateve me kerkesat dhe të dhënat teknike të ketij specifikimi teknik.

Gjithashtu, komisioni nëse e shikon të aryeshme dërgon mostra e kryen analiza laboratorike pranë laboratorëve të akredituar, duke i krahasuar rezultatet e tyre me rezultatet e analizave të sjella nga OE furnizues.

Artikulli konsiderohet teknikisht i pranuar kur ai ploteson te gjitha kerkesat e ketij specifikimi teknik.

SPECIFIKIM TEKNIK

OBJEKTI: 25. Kostum ceremoniali vere për truprojen e nderit, (kapele, xhakete, pantallona, shirit dekorativ (fjongo), rrip mesi ceremonial) **të Gardës së Republikës.**

Specifikimi teknik i artikullit “Kostum ceremonial vere” për truprojen e nderit të Gardës së Republikës, paraqet kerkesat themelore teknike të domosdoshme për prodhimin e tij.

Në këtë specifikim teknik përcaktohen gjithashtu dhe kerkesat teknike të aksesoreve që shoqërojnë artikullin “Kostum ceremonial vere” si produkt i gatshe me.

Të gjitha percaktimet teknike të ketij specifikimi teknik duhen të zbatohen detyrimisht saktë nga prodhuesi.

Për procedurë vleresimi dhe miratimi nga perdoruesi, ofertuesi është i detyruar të paraqesi si ofertë teknike të realizuar sipas kërkesave të ketij specifikimi teknik :

- 1 (një) komplet kostumi të përfunduar (1 kapele, 1 xhakete, 1 palë pantallona, shirit dekorativ, rrip ceremonial). Kostumi i mosters me nr gjoksi 50.
- 1 (një) pjesë stofi me ngjyrë të kuqe nga i xhaketes, me përmasa 20 x20 cm.
- 1 (një) pjesë stofi me ngjyrë të zezë nga i pantallonave dhe kapeles, me përmasa 20 x20 cm.
- Fletë-analizat laboratorike të treguesve fiziko-mekanik e kimik të lëndëve të para (stofi i kuq dhe i zi) të përdorur nga prodhuesi.

Stofi i mostrës (kostumit), pjesët e stofit (lëndët e para) që shoqërojnë atë dhe copat e stofit që i bashkëngjiten raport-analizave të laboratorit, duhet të jenë detyrimisht të njëjta.

Kostumit mostër (Kapeles, xhaketes, pantallonave,) dhe lëndëve të para (pjesëve të stofit), u qepet me tegel makine nga një etiketë tekstili e bardhë, me permasa të përafërta 10 x 10 cm,

në të cilën shkruhet: mostër “Kostum ceremonial vere për truproje nderi Garde”, emri i ofertuesit, data e tenderit, nënshkrimi dhe vula e ofertuesit.

Mungesa e mostres, lendeve të para dhe flete analizave që shoqerojnë ato, është kusht skualifikues.

LËNDËT E PARA:

Stof teritali veror i kuq për xhaketën **dhe stof teritali veror i zi** për pantallonat e kapelen, me përbërje (+/-3 %), 70% lesh, 30% poliestër me masë 205 gr/m² (+/-3 %),

Qëndrueshmëria në këputje: në bazë 78 – 6, në ind 57 – 6.

Qëndrueshmëria e ngjyrës : shumë e mirë.

Thurja : Sarzh.

Dëndësia e fijeve në 10 cm: për xhaketen 180 +/-6 në bazë, 170+/-6 në ind, për pantallonin në bazë 320 +/- 6 , në ind 280 +/- 6 .

Hollesia e fillit: 10/1, 11/1 për xhaketën, 50/2, 54/2 për pantallonat.

Në lëndën e I-rë stof teritali veror që do të përdoret për konfeksionimin e artikullit “Kostum ceremonial vere” difekte të përhapura të pamjes së jashtme të cilat detyrimisht nuk lejohen do të konsiderohen: papastertite me origjinë bimorë, njolla të ndryshme vaji ose boje, tonacione të ngjyrës, oksidime, rrudhosje, mungesë të fijeve në ind e në bazë, trashim të fijeve në ind e në bazë, vrima në sipërfaqe, lekundje në gjërësi etj. (S.SH.1038 – 88)

M A T E R I A L E T N D I H M E S E :

Materialet ndihmëse që duhet të përdoren për prodhimin e artikullit “Kostum ceremoniali vere” janë:

- **Astar** imitim mëndafshi ngjyrë e zezë, për pantallonat e kapelen dhe i kuq për xhaketën, me përbërje 100 % PES
- **Merle** (flieselinë e posaçme për kostume) si material ngjitës përforcues special të pershtatshëm për xhaketën, pantallonin me përbërje 100 % PES
- **Shirit tekstili stof terital i kuq 3 mm** për fileto e kapeles, xhaketës dhe pantollonave sipas specifikimit
- **Fije ngjyre ari** për qendisjet në jakë e mëngët e xhaketës.
- **Fill i zi** për qendisjet në xhaketë.
- **Kanavace** cilësi e I-rë me përbërje 100 % lesh
- **Vata** të posaçme për kostume (materiali i vatave të mos jetë pambuk)
- **Astar xhepi** në ngjyrë sipas stofit, material tekstil me përbërje 100 % viskoz
- **Kopsa të medha Garde**, copë 18 + 2 rezervë (sipas specifikimeve)
- **Kopsa të vogla Garde** për kapelen, copë 2 + 1 rezervë (sipas specifikimeve)
- **Qemer** i përgatitur për pantallonat
- **Kopsa të vogla** të zeza ebaniti
- **Kapse metalike** mashkull –femer për mbylljen e pantalloneve
- **Zinxhir** me dhembëza plastike 22-24 cm për pantallonin
- **Penj qepje** sipas stofit me Nm 80/2 për qepje industriale me përbërje 100 % PES
- **Materialet** që duhet të përdoren për ndertimin e kapeles si: shirit tel çeliku petashuq, material ingeliti me vrima në sipërfaqe, shirit plastik i presuar me vrima, astar i zi me vrima për ajrim, strehe me ngjyrë të zezë me lluster,

Elementet Velcro femër (me ngjyrë të kuqe) për vendosjen:

- **E Stëmës së Republikës dhe Stëmës së Gardës**, velkrof femer në mençe, me permasa 7.5 cm x 6 cm +/-0.1 cm, pjesa e sipërme është e drejtë ndërsa e pjesa e poshtme në formë ovale (shqyti) me distancë rreth 7-8 cm nga gavatura e mëngës.

Grada & Shenja dalluese

- **Stemë e Republikës** me velkrof mashkull (sipas specifikimeve të dhëna)

- **Stemë Garde** me velkrof mashkull (sipas specifikimeve të dhëna)

Artikulli “Kostum ceremoniali vere” të prodhohet mbi bazën e matjeve trupore të personave të cilët do të furnizohen me këtë artikull, nga subjekti furnizues i cili është i detyruar ti respektoje saktësisht ato.

Prodhimi i artikullit “Kostum ceremoniali vere” duhet të realizohet sipas një procesi teknologjik të përcaktuar mbi bazën e kerkesave dhe kushteve teknologjike të sakta në secilën fazë të realizimit të tij. Prodhimi ndahet në tre faza kryesore të cilat janë:

- përpunimi pergatitor
- konfeksionimi (procesi i qepjes)
- ambalazhimi,marketimi dhe ektiketimi

Përpunimi pergatitor ka te beje me kolaudimin e lendeve te para dhe ndihmese,skicimin,prerjen ne prestari,marketimin dhe kollaritjen e pjeseve perberse te kostumit (xhaketes,pantallonit, dhe kapeles).

Konfeksionimi ka te beje me qepjen e pjeseve perberse te kostumit (xhaketes,pantallonit, dhe kapeles) sipas nje procesi linear te percaktuar.Ne faza te ndermjetme te ketij procesi do te kryhet hekurosja dhe presimi me avull i gjysemprodukteve.Ne perfundim kryhet dhe hekurosja e produktit te gatshem.

Ambalazhimi ka te beje me etiketimin,amblazhimin per cdo produkt dhe amblazhimin total te gjithë sasise te produktit te gatshem dhe pergatitjen e tij per levrimin drejt magazinave te perdoruesit

PERPUNIMI PERGATITOR

Kolaudimi i lendes se pare dhe materialeve ndihmese

Kolaudimi i lendes se pare dhe materialeve ndihmese ne menyre te sakte dhe te drejte eshte baze per nje ecuri cilesore te procesve teknologjike te metejshme zinxhir per prodhimin me cilesi te artikullit “Kostum ceremoniali vere”

Skicimi

Ky proces duhet te realizohet me metodat matematikore te programimit linear te cilat sigurojne nje shenim te sakte te prerjeve dhe shenjave sipas vizatimeve duke pasur kujdes qe detajet e kostumit duhet te jene ne drejtim te fijeve te bases.

Prerja

Procesi i prerjes duhet te behet me shume kujdes qe te mos te kete devijime ne fletet e fundit te dyshekut i cili eshte mire qe te mos te kaloje 30 flete.Kujdes duhet te behet dhe ne pjeset e harkuara te detajeve dhe buzet e prera te mos jene me dhembza.

Marketimi

Ky proces eshte shume i rendesishem sepse eliminon qepjen e detajeve te kostumit me tonacione te ndryshme duke siguruar njellojshmeri ne ngjyre te artikullit.

Kollaritja

Detajeve gjysem te gatshme te pantallonit, ngjitja e flieselines duhet te behet me prese speciale me avull ne Tem. 130-140 C,ne kohe 8-10 sek.ne presion 2 atm.Ky proces duhet te kryhet sa me i sakte ne menyre qe te mos kete asnje mundesi qe ne objekt te krijohen deformime gjate hekurosjes me avull,larjes dhe lagies nga shiu,te cilat bejne te mundur humbjen e pamjes fillestare. Kollaritja dhe ngjitja nuk lejohet me shtesa.

Merlja (flieseline e posacme per kostume) ngjitet ne perparsen e djathte e te majte te xhaketes,ne jaka dhe kapaket e xhepave.gjithashtu ,Merlja (flieseline e posacme per kostume) ngjitet ne keto pjese si me poshte:

4 detaje tek fundet e menges,4 detaje tek fundet e xhaketes mbrapa,2 detaje ne pjesen e shpines siper,2 detaje ne gavature,2 detaje tek mostra e xhepit brenda,2 detaje tek qemeri i pantallonit,1 detaj tek filetoja e pantallonit,1 detaj tek kapaku i xhepit te pantallonit,1 detaj tek sallkia,2 detaje tek kanavaca.

KONFEKSIONIMI (Procesi i Qepjes)

XHAKETA.

Xhaketa eshte dopjopet me jake te zeze te mbyllur, e cila ne anesore pershkohet nga nje shirit me ngjyre te kuqe 3 mm. Jaka ne gjithë gjatesine e saj, eshte e qendisur me fije ngjyre ari, me gjethe ne forme kurore, qe fillojne nga perpara e bashkohen ne mesin e jakes prapa. Xhaketa perpara mbyllet me 9 çifte kopsash te medha Garde nga te cilat vetem ato te perpareses se djathte jane funksionale te cilave u korespondojne vrimat ne perparesen e majte, ndersa kopsat e krahut te majte te qepura ne menyre simetrike me ato te krahut te djathte jane fallso(shih specifikimet teknike bashkelidhur).

Xhaketa tek supet ka dy spaleta pllake me ngjyre te arte.

Ne pjesen e perparme te mendeve eshte qendisur me fill te zi shqiponja, ne mesin e se ciles eshte qendisur me fill ngjyre ari, perkrenarja e Skenderbeut.

Xhaketa ne pjesen e brendeshme (perpara) deri ne fund ka te vendosur kanavac importi te perbere nga dy pjese , ose frazeline tekstil komplet dhe nje pjese kanavace ne gjoks.

Perparsja, shpina dhe menget jane te veshura me astar mendafshi me ngjyre te njellojte me stofin ose te perafert me te.

Xhaketa ne mengjen e djathte 7-8 cm poshte qepjes se bashkimit te menges me trupin e matur nga pika me e larte e supit ne qender qepet “Stema e Gardes” sipas specifikimeve teknike qe pershkruhen me poshte. Po keshtu ne mengjen e majte te xhaketes 7-8 cm poshte qepjes se bashkimit te menges me trupin e matur nga pika me e larte e supit ne qender qepet “Stema e Republikes” sipas specifikimeve teknike qe pershkruhen ne poshte.

Xhaketa duhet te jete simetrike ne te gjithë elementet perberes te saj.

Gjokseve te xhaketes u ngjitet merlja (flieseline e posacme per kostume) ne prese speciale. Pas ketij procesi gjokseve u ngjitet shirit fortese ne sup,ne gavature dhe ne pjesen fundore te gjokseve. Gjokseve u vendoset materiali perforcues kanavace. Kanavaca duhet te jete me dy fortesa. Fortesa e dyte duhet te jete rreth 10-12 cm me e shkurter se e para.Per ti dhene formen e plote te gjoksit kanavaces duhet ti behen 2-3 prerje. Pas fiksimit te kanavaces dhe mbylljeve te prerjes se saj behet kalimi ne procesin e hekurosjes me prese speciale me avull ku i jepet forma e gjoksit. Ky proces ka rendesi te vecante sepse jep formen e trupit prandaj duhet bere me shume kujdes qe rrudhat qe mund te krijohen te eliminohen duke i shtyre ne drejtim te qepjeve anesore te xhaketes.

Shpina eshte e drejte e paçare. Ne gavaturen e shpines vendoset nje fortese.Ne pjesen e supit tek koka e menges vendosen vatat speciale per kostum te cilat duhet te dalin 1-1.5 cm nga buza e supit. Vatata speciale per kostum vendosen me pak kend qe ti pershtaten formes se supeve. Gjate montimit te shpines me gjokset duhet bere shume kujdes ne menyre qe te mos krijohen diferenca ne gjatesi te gjokseve.

Astari i brendshem perbehet nga ai i perparses, i shpines dhe i mendeve. Prerja e astareve te gjokseve, te shpines dhe te mendeve duhet te jene ne po ate forme qe kane copat e prera te stofit me rezerven e duhur. Fiksimi i astarit ne trupin e xhaketes duhet te behet me kujdes ne menyre te tille qe te rri i shtrire mire dhe pa rrudha duke iu pershtatur pjeseve e xhaketes. Pas

fiksimit te astarit behet kthimi dhe palosja e fundit te xhaketes duke pasur kujdes qe astari te mos varet poshte duke dale jashte fundit te saj. Po keshtu dhe per astarin e mengeve.

Jaka. Jaka ne gjithe gjatesine e saj, ka te qendisur me fije ngjyre ari, gjethe ne forme kurore, qe fillojne nga perpara e bashkohen ne mesin e jakes prapa. Montimi duhet bere me kujdes qe jaka te jete uniforme dhe simetrike. Permasa e jakes duhet te jete e njejte dhe e shtrire mire ne te gjithe gjatesine e saj dhe ti pershtatet sa me mire qafes se perdoruesit, ne dy buzet e jakes nga brenda vendosen dy çifte kapse teli per te realizuar mbylljen e plote te jakes rreth qafes. Jaka gjate qepjes ne trupin e xhaketes kalohet 2 here ne hekurosje me prese speciale me avull.

Lart ne jake nga brenda qepet nje etikete e vogel qe tregon numrin me prerjen perkatese te gjoksit te kostumit dhe vendoset dhe nje fitil tekstili qe do sherbeje per te varur xhaketen.

Menget jane te perbera nga pjesa e sipërme dhe pjesa e poshtme. Ne fund te menges nga brenda me hekur vendoset shirit ngjites per thyerjen e menges. Mbyllja e supeve duhet bere ne menyre te atille qe buzet te mos kene rrudha apo vende te ngritura dhe te shtrihen mire. Modeli i mengeve eshte me supe te ngritura.

Bashkimi i mengeve. Per bashkimin e mengeve me trupin e xhaketes duhet qe thellesia e rrethit te sqetulles te perputhet me thellesine e menges. Gjate bashkimit te menges ne trupin e xhaketes, per te pasur nje bashkim te forte, te ngritur dhe te harkuar bukur, rreth e qark menges ne pjesen e bashkimit mbi vaten fiksohet nje fitil prej stofi. Bashkimi i mengeve me trupin e xhaketes duhet te jete simetrik. Bashkimi duhet te behet pa rrudha ne pjesen e sipërme te menges dhe te mos formoje terheqje apo pale ne pjesen e perparme dhe te pasme te saj. Spalinat jane pllake dhe vendosen ne te dy supet. Spalinat perbehen nga pjesa e sipërme dhe e poshtme. Pjeses se sipërme te spalines per perforcim i vendoset flieseline. Spalina ka gjatesi deri te bashkimi me jaken dhe gjeresi 5 cm.

Spalines 5 mm larg buzeve i kalohet nje tegel zbukurimi. Montimi i spalinave ne xhakete duhet te behet ne menyre te tille qe mesi i spalines te perputhet me tegelin e bashkimit te shpines me gjoksin. Spalinat duhen te shohin lart. Spalina nga ana e jakes behet me maje te rumbullaket dhe mberthehet me ane te nje velkrofi.

Ne fund te gjithe ketij procesi xhaketa kalon ne fazat e hekurosjes perfundimtare duke bere kujdes qe te ruhet forma e gjokseve dhe e xhepave. Mbas ketij procesi kalohet ne qepjen e kopsave.

Vrimat dhe kopsat duhen te vendosen ne distancat e percaktuara dhe te korrespondojne me njera-tjetren.

Pantalloni ka dy xhepa te pjerret perpara me fileto stofi me gjeresi 3 mm dhe nje xhep te brendshem mbrapa po me filet 3 mm qe mbyllet me kapak me kopse ebaniti ne ngjyre te zeze. Sallkia eshte me stof dhe fileto astari dhe per mbyllje i fiksohet nje zinxhir plastik me dhembeza te vegjel. Qemeri ka 7 (shtate) mbajtese rripi. Mbyllja e pantallonave ne mes realizohet me kapese metalike mashkull-femer dhe me kopse. Ne mes te qemerit nga brenda vendoset etiketa me numrin dhe prerjen perkatese te pantallonit si dhe instruksioni i larjes, i pastrimit, i hekurosjes dhe i perdorimit. Pantalloni eshte me dy penca nga jashte. Xhepat anesore jane me astar permasat e te cilave jepen ne tabelen perkatese. Pantalloni ne dy anesoret ne bashkimin e perparseve me pjesen e prapme te tyre, pershkohet nga shirit i kuq 3 mm, nga qemeri deri ne fund te pantallonit.

Pantallonit ne fund lihet lisho ose i lihet 5 cm rezerve dhe ne fund te pales i vendoset fortese astari.

Per te qepur pantallonin ne fillim pergatiten pjeset ndihmese si: qemeri, filetot, astaret dhe kapaket e xhepave, mbajteset e rripit dhe sallkia.

Qemeri duhet te pergatitet ne menyre te tille qe te mos rrije as i shtreguar dhe as i lire. Gjeresia e qemerit perpara duhet te jete 4.5 cm ndersa mbrapa 3.5 cm. Qemeri duhet te jete i perforcuar me flieseline dhe nga brenda i qepet astar i posacem per qemer. Qemerit pergjate gjithe

gjatesise se tij i kalohet tegel zbukurimi 1 mm larg buzës ne te dy anet. Qemeri ka 7 (shtate) mbajtese rripi te kthyer te pershkruara me tegela siper 1mm larg buzës.

Kapaku i xhepit te pasem eshte me maje ne forme trekendeshi. Kapaku perbehet nga pjesa e sipërme dhe e poshtme. Pjeses se sipërme per perforcim i ngjitet flieselina, bashkohen me pjesen e poshtme, kthehet, i qepet astar nga mbrapa, hekuroset dhe i kalohet nje tegel zbukurimi 1mm larg buzës. Gjate kthimit duhet bere kujdes qe cepat dhe majat e kapakut te mos dalin te rrumbullaket.

Hekurosja perfundimtare e pantallonit duhet bere me kujdes sidomos per formimin e vijes se hekurit ne menyre qe ajo te rrije drejt ne mes te kembes.

Tegelat e qepjes te xhaketes dhe pantallonit duhet te jene me hap 30 shpime ne 5 cm. Tegelat duhet te jene te forte, uniforme, te mos kene vende te shqepura, te jene simetrike, te rregullt dhe te drejte. Buzet e mbylljeve te brendeshme te behen me syzator me 3 fije dhe te jene te tilla qe te mos krijojne dhe lejojne daljen e fijeve. Tegelat duhet jene te forte ne menyre te tille qe te mos hapen nen ushtrimin e forces se duarve. Fortesia e tegelave te jete mbi 12 kG. Thellesia e tegelave ne qepje tek pantalloni te jete 1.5 cm. Tegelat duhet te jene te perforcuar ne fund. Peri qe do te perdoret per qepje duhet te jete i forte dhe me ngjyre te erret si ajo e stofit me Nm 80/2 ,100 % PES.

KAPELJA :

Per procesin e pergatitjes dhe qepjes se kapeles se kostumit nevojiten makina speciale qepjeje dhe punetore te specializuar sidomos per procesin e montimit dhe qepjen e strehes se kapeles. Materialet te cilat duhen te perdoren per ndertimin e kapeles jane:

- **Stof** i njejte me ate te pantallonit.
- **tel petashuq** shirit çeliku me gjeresi 2 - 3.5 mm qe vendoset ne brendesi rreth e qark tepelekut
- **shirit plastik** i presuar me vrime per ajrim me gjeresi 5.5 cm dhe trashesi 1-2 mm per perforcim si
- **fortese** rreth e qark qemerit
- **shirit** i zi 4.5–5.5 cm i gjere, material ingeliti me vrime per ajrim qe vendoset rreth e qark qemerit
- **astar** i zi i birosur per ajrim qe vendoset brenda kapeles, poshte tepelekut
- **Material** plastik i pathyshem, per fortese ku do te vendoset emblema
- **strehe** e zeze me lluster e perforcuar ne brendesi me karton prespan te presuar ose flete PVC e presuar me trashesi 1.5 – 2 mm

Permasat kryesore te kapeles jepen ne tabelen e meposhteme (ne cm) :

- **A** – lartesia e rrethit te kapeles sipas perimetrit te kokes

B – gjeresia e urave perpara

C – gjeresia e urave mbrapa

D – gjatesia ne qender e tepelekut te kapeles

E – gjeresia ne qender e tepelekut te kapeles

F – gjatesia e shiritit petashuq te celikut qe vendoset perreth tepelekut te kapeles

Nr. kapeles	53	54	55	56	57	58	59	60	61	62	tol. +/- cm
Permasa											
A	4.5	4.5	4.5	4.5	4.5	4.5	4.5	4.5	4.5	4.5	0.1
B	7	7	7	7	7	7	7	7	7	7	0.1
C	4.5	4.5	4.5	4.5	4.5	4.5	4.5	4.5	4.5	4.5	0.1
D	26.5	26.5	27.5	27.5	28	28	28.5	28.5	29	29	0.3
E	25.5	25.5	26	26	27	27	28	28	28.5	28.5	0.3
F	74	75	76	77.5	79	81	83	85	87	89	0.5

Numrat e Kapeleve do jenë sipas matjeve faktike që do t'u behen në vend personave që do të furnizohen me Kostum ceremonial vere.

Kapelja perbehet ne vetevete nga tepeleku, kater urat dhe qemeret. Brenda kapeles nga poshte siperfaqes se stofit te tepelekut vendoset i shtrire mire astar me vrime (material special) qe ka si veti kryesore lejimin e depertueshmerise se ajrit dhe avujve te kokes te perdoruesit.

Streha plastike eshte e veshur me stof si te kapeles mbi te cilen i ne pjesen e perparme ne gjithë gjatesine e saj ka te qendisur nje shirit ne forme gjethe lisi e punuar me fije me ngjyre ari. Kapelja ne bashkimin e tepelekut me rrethin, pershkohet nga nje shirit i kuq 3 mm.

Filetoja e tekstilit vendoset e shtrire mire ne menyre te dukshme siper tek tepeleku pergjate gjithë perimetrit te tij dhe ne te dy buzet siper dhe poshte perreth te gjithë perimetrit te qemerit. Urat perpara dhe mbrapa duhet te jene te perforcuara me fortese te kollaritur.

Streha e kapeles me trashesi 2.5-3.5 mm ne brendesi eshte e perforcuar me karton prespan te presuar ose i flete PVC e presuar me trashesi 1.5 – 2 mm. Ne pjesen e siperme streha mbulohet me nje flete PVC-je ne ngjyre te zeze. Streha ka forme gjysem hene ku harku i brendshem duhet te jete me rreze 230-240 mm nga e cila del masa 205 mm. Pjesa e perparme ne forme kurbe ne qender te strehes duhet te kete gjeresi 56-57 mm duke iu afruar te dy ekstremeve deri ne piken zero me harkun e pare.

Kujdes: Streha siper ka te montuar nje shirit ne forme gjethe lisi e punuar me fije metalike, ngjyre ari.



SPECIFIKIM TEKNIK : Kopsa të medha dhe të vogla Garde



1.Pershkrimi.

Janë me ngjyrë të artë për të gjitha llojet e gradave. Kopsat në qendër të tyre kanë të stampuar në relief shenjën dalluese përkrenaren e Skënderbeut në profil me pamje nga e djathta, ku shkruhet në mënyrë gjysëm rrethore me shkronja kapitale “GARDA E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”.

Trashësia e kopses në anë është 3.5 mm, në qendër është 5 mm.

Bishti i kopses është i derdhur së bashku me pjesën tjetër të saj me këto dimensione : gjatësi, gjatësi 5+/- 0.3 mm, trashësi 3+/-0.2 mm dhe me vrimë në mes.

Vrima të reziztoje forca në tërheqje dhe të jete e zmusuar.

2.Materiali

Kopsat janë të punuara me material metal të lehtë në një sasi të mjaftueshme në brendësi të stampave duke realizuar reliefet e vendosura dhe të kerkuara mbi kopsa.

Kopsat kalojnë në metalizim në ngjyrë të artë duke ruajtur efektin e punimeve të imta që kërkon modeli ashtu edhe për ruajtjen dhe shkelqimin e ngjyrës nga oksidimet eventuale që mund të vijnë nga agjentët atmosferik, kimik e mekanikë.

3.Ngjyrat

Ngjyra e artë pa shkelqim (mat), për të dy tipet e kopsave.

4.Punimi

Nuk lejohet punimi me ngjyrosje apo sprucim.

5.Dimensionet

Kopsa e madhe është në formë të rrumbullakët me diametër 2.2 cm.

Kopsa e vogël me diametër 1.4 cm.

6. PROVA TEKNIKE

Cilesia e kopsave provohet

- Rezistenca në ujë; Zhytet në ujë të distiluar 24 orë në 25 °C
- Rezistenca në detergjive ; Zhytet 24 orë në solucion sapuni marseje 3% në 25 °C.
- Rezistenca ndaj tretësve; Kampionet i kalojnë një shtresë alkool etilik dhe menjëherë me pas një shtresë benzine, të cilat nuk verifikojnë humbje të ngjyrave.
- Rezistenca në klorur sode; zhytet kampioni një orë në solucion klorur sode

SPECIFIKIM TEKNIK : Rripi ceremonial

Rripi ceremonial është material sintetik 100% sintetik, fill i thurur me ngjyre te arte. Permasat e rripit të jete, gjatesia 130 ± 1 cm dhe gjersia $5 \text{ cm} \pm 0.2 \text{ cm}$.

Mberthimi i rripit të mezit realizohet me togez metalike ngjyre te arte i cili ka të stampuar në qender shqiponjen e flamurit kombëtar, rezistent ndaj koruzionit.

Në njerën anë vendoset togeza ndërsa në anën tjetër vendoset një flete metalike e dhembëzuar e cila është fiksuar në togez, që shërben për shterngimin apo lirimin e gjatesisë së rripit duke patur edhe pjesë siguroese për funksionimin e saj.

Ai duhet të jetë i manovrueshem në shterngimin apo lirimin e gjatesisë së rripit duke patur edhe pjesë siguroese për funksionimin e saj. Mberthimi dhe zberthimi i pjesës së togzës të jetë i lehtë e funksional gjatë përdorimit.

SPECIFIKIM TEKNIK: Shirit dekorativ (fjongo)

1.Pershkrimi.

Shiriti dekorativ (fjongo) është prej fill pambuk-poliester, i thurur, me ngjyre ari, vendoset në krahun e majtë nën spaline, e varur poshtë në gjithë gjatësinë e tij dhe kapet me anë të një kapse në nivelin e kopses së parë të xhakës.

Shiriti është me dy kordone kryesore, të cilat mbylleen në pjesën fundore të tyre me një pjesë metalike zbukurimi të punuar, me ngjyre të arte me gjatësi 7 cm. Secili kordon shoqërohet me dy shiritë të hollë, që kanë trashësinë e një elementi që është thurur në formë gershëti shiriti kryesor.

2.Materiali

Fill i thurur me përzierje 70% poliéster dhe 30% pambuk

3.Ngjyrat

Ngjyra e arte me shkelqim.

4.Punimi

Nuk lejohet punimi me ngjyrosje

5.Dimensionet

Shiriti kryesor që rrotullon krahut e majtë nën spaline të jetë me gjatësi 80 cm.

Kordoni tjetër që i bashkëngjiten shiritit kryesor është me gjatësi 50 cm.



Etiketimi, ambalazhimi

Kostumit (kapeles, xhakës e pantallonit) në pjesën e brendshme të tyre u vendoset nga një etiketë e cila duhet të përmbajë : nr. i gjoksit, prerjen dhe shenjat konvencionale të trajtimit të stofit në larje hekurosje, nr. kapeles etj. Te xhaketa etiketa qepet në pjesën e brendshme të jakës në qender të saj ku bashkohet me shpinën, te pantalloni në pjesën e brendshme ku bashkohet qemeri me përparësën, te kapelja në pjesën e brendshme të tepelekut.

Kostumi kompletëhet xhakete dhe një palë pantallona, vendoset në varë rrobash (kremastar) dhe futet në qese transparente plasmasi.

STEMA E REPUBLIKËS (Shenjë krah)

Lëndët e para e ndihmëse:

Material i hollë e reziztent tekstili i qendisur me penjë sipas ngjyrave të çdo elementi të stemës.

Stemës mbas qendisjes i qepet velkrof mashkull, me të njejtat permasa , duke e realizuar si një trup të vetem.

Qendrueshmeria e ngjyrave dhe rezistenca në keputje të jete e lartë.

Elementët përbërës të stemës.

Stema është në formen e një mburoje me permasa 7.5 x 6 cm +/-0.1 cm.

Pjesa e sipërme është e drejtë ndersa e pjesa e poshtme në formë ovale (shqyti). Fusha është në ngjyrë të kuqe në mes të së cilës gjëndet shqiponja dykrenare e qendisur me penjë me ngjyrë të zezë mbi të cilën në qendër vëndoset perkrenarja e Skenderbeut qendisur me penjë ngjyrë ari,në profil me pamje nga e djathta.

Stema rrethohet me një kornizë qendisur me penjë ngjyrë ari të vijeuar me gjeresi 2 mm. Stema në terësi si dhe gjithë elementët përbërës të saj të jenë rezistente ndaj gjithë faktoreve atmosferike. Po kështu dhe qendrueshmeria e ngjyrave të jetë shumë e mirë. Stema vendoset në krahun e majtë me anë të një velkrofi femer- mashkull.



STEMA E GARDËS SË REPUBLIKËS (Shenjë krah)

Lëndët e para e ndihmëse:

Material i hollë e reziztent tekstili i qendisur me penjë sipas ngjyrave të çdo elementi të stemës.

Stemës mbas qendisjes i qepet velkrof mashkull, me të njejtat permasa , duke e realizuar si një trup të vetem.

Qendrueshmeria e ngjyrave dhe rezistenca në keputje të jete e lartë.

Elementët përbërës të stemës.

Stema është në formën e një mburoje (shqyti) me permasa 7.5cm x 6 cm +/-0.1 cm. Pjesa e sipërme është e drejtë ndersa e pjesa e poshtme në formë ovale (shqyti).

Stema rrethohet me një kornizë ngjyrë ari, me gjëresi 2 mm, në qendër të saj është vendosur shqiponja e zezë dykrenare, e përdorur si simbol në krijimin e këtij formacioni. Mbi shqiponjë qëndron perkrenarja e Heroit tonë kombëtar, Skënderbeut, në ngjyrë të artë. Perkrenarja e Skënderbeut është vendosur në pamje ballore, për të bërë të mundur leximin e shkronjave “BT”, ”IN”, duke respektuar semantiken, rregullat dhe stilet araldike të kurorave, e duke bërë më të lexueshme çfarë përfaqëson kjo perkrenare. Ajo i shmanget kopjimit përsëritës të saj, duke e bërë të vecantë për këtë institucion. Në këtë pozicion shikohet karakteri i saj laik e qytetar, fisnik e ushtarak. Emblema evidenton ndërthurjen e madhështisë me bukurinë që paraqet ky element në fushën e sematikës Shqiptare.

Duke qenë se stema shërben edhe si shenjë krahu për gardistët në pjesën harkore të shqytit, është shkruar me gërma kapitale “GARDA E REPUBLIKËS”.

Stema në teresi si dhe gjithë elementet përbërës të saj të jenë rezistentë ndaj gjithë faktoreve atmosferike. Po kështu dhe qëndrueshmëria e ngjyrave e copës dhe penjëve të përdorur të jetë shumë e mirë.



Afati i lëvrimit: Brenda 90 ditëve nga lidhja e kontratës, por jo më vonë se data 20 dhjetor e vitit planifikues.

KOLAUDIMI MARRJA NE DORZIM

Pranimi i të gjithë sasisë të artikullit “Kostum ceremoniali vere” të përcaktuar në kontratë dhe të dorëzuar në magazinën e Gardës, do të bëhet vetëm në bazë të rezultateve që do të merrën gjatë procesit të Kolaudit për të gjithë sasinë e produktit të gatshëm të dorëzuar në magazinë. Kolaudimi do të bëhet mbi bazën e rezultateve të Fletë-analizave laboratorike të lëshuara nga Laboratore të Akredituar të Tekstil-Konfeksioneve, që shoqërojnë mallin, të sjella nga kontraktuesi, sipas përcaktimeve në kontratë, dhe ekzaminimit të mallit të furnizuar, që do të bëjë “Komisioni i pritjes, kontrollit dhe pranimi të mallit të Gardës së Republikës”,

i cili kryen direkt matjet e vlersimet organo-leptike të sasisë së mallit të dorëzuar dhe bën krahasimin e të gjithë këtyre rezultateve me kërkesat dhe të dhënat teknike të këtij specifikimi teknik, kampionit të ofruar dhe modelit të miratuar. Gjithashtu, komisioni nëse e shikon të aryeshme dërgon mostra e kryen analiza laboratorike pranë laboratorëve të akredituar, duke i krahasuar rezultatet e tyre me rezultatet e analizave të sjella nga OE furnizues.

Artikulli konsiderohet teknikisht i pranuar kur ai ploteson të gjitha kërkesat e këtij Specifikimi Teknik.

Shenim: Ky Specifikim Teknik, kampioni, modeli dhe ngjyra e artikullit “Kostum ceremoniali vere”, janë pronë e Gardës së Republikës dhe për nga qëllimi i përdorimit ato i perkasin vetëm strukturave të saj. Nuk lejohet shumfishimi dhe realizimi i këtij specifikimi teknik, kampionit, modelit dhe ngjyrës së artikullit “Kostum ceremoniali vere”.

SPECIFIKIM TEKNIK

OBJEKTI: 26. Kostum ceremoniali dimri për truprojen e nderit, (kapele, xhaketë, pantallona, shirit dekorativ (fjongo), rrip mesi ceremonial) të Gardës së Republikës.

Ky specifikim teknik ne menyre te detajuar paraqet kerkesat themelore teknike te domosdoshme per prodhimin ne linje industriale mbi bazen e proceseve teknologjike te artikullit “Kostum ceremonial dimri”. Ne kete specifikim teknik percaktohen gjithashtu dhe kerkesat teknike te aksesoreve qe shoqerojne artikullin “Kostum ceremonial dimri” si produkt te gatshem .

Te gjitha percaktimet teknike te ketij specifikimi teknik duhen te zbatohen detyrimisht sakte nga prodhuesi.

Për procedurë vleresimi dhe miratimi nga perdoruesi, ofertuesi është i detyruar të paraqesi si ofertë teknike të realizuar sipas kërkesave të ketij specifikimi teknik :

- 1 (një) komplet kostumi të përfunduar (1 kapele, 1 xhakete, 1 palë pantallona, shirit dekorativ, rrip ceremonial). Kostumi i mosters me nr gjoksi 50.
- 1 (një) pjesë stofi me ngjyrë të kuqe nga i xhaketes, me përmasa 20 x20 cm.
- 1 (një) pjesë stofi me ngjyrë të zezë nga i pantallonave dhe kapeles, me përmasa 20 x20 cm.
- Fletë-analizat laboratorike të treguesve fiziko-mekanik e kimik të lëndëve të para (stofi i kuq dhe i zi) të përdorur nga prodhuesi.

Stofi i mostrës (kostumit), pjesët e stofit (lëndët e para) që shoqërojnë atë dhe copat e stofit që i bashkëngjiten raport-analizave të laboratorit, duhet të jenë detyrimisht të njëjta.

Kostumit mostër (Kapeles, xhaketes, pantallonave,) dhe lëndëve të para (pjesëve të stofit), u qepet me tegel makine nga një etiketë tekstili e bardhë, me përmasa të përafërta 10 x 10 cm, në të cilën shkruhet: mostër “Kostum ceremonial dimri për truproje nderi Garde”, emri i ofertuesit, data e tenderit, nënshkrimi dhe vula e ofertuesit.

Mungesa e mostres, lendeve te para dhe flete analizave qe shoqerojne ato, eshte kusht skualifikues.

LENDET E PARA:

Stof leshi dimeror i kuq per xhaketen, me perberje 70% lesh, 30% poliester (+/- 3%), me mase 280 gr/m² (+/- 3%).

Stof leshi dimëror, me ngjyrë të zezë per pantallonat e kapelen me përbërje (+/-3%), 70% lesh, 30% poliester, masa 240 gr/m² (+/-3%)

Qendrueshmeria ne keputje: ne baze 78 – 6, ne ind 57 – 6.

Qendrueshmeria e ngjyres : ne ferkim te thate e te njome, ne larje thate sode e ndaj djerses te jete shume e mire .

Thurja : Sarzh.

Dendesia e fijeve ne 10 cm: per xhaketen 180 +/-6 ne baze, 170+/-6 ne ind,per pantollonin ne baze 320 +/- 6 , ne ind 280 +/- 6 .

Hollesia e fillit: 10/1,11/1 per xhaketen, 50/2,54/2 per pantallonat.

Ne lenden e I-re stof leshi dimeror qe do te perdoret per konfeksionimin e artikullit “Kostum ceremonial dimri truproje nderi” difekte te perhapura te pamjes se jashtme te cilat detyrimisht nuk lejohen do te konsiderohen: papastertite me origjine bimore, njolla te ndryshme vaji ose boje, tonacione te ngjyres, oksidime, rrudhosje, mungese te fijeve ne ind e ne baze, trashim te fijeve ne ind e ne baze, vrime ne sipërfaqe, lekundje ne gjeresi etj. (S.SH.1038 – 88)

M A T E R I A L E T N D I H M E S E :

Materialet ndihmese qe duhet te perdoren per prodhimin e te dy llojeve te artikullit “Kostum ceremoniali dimri” jane:

- **Astar** imitim mendafshi ngjyre e zeze, per pantallonat e kapelen dhe i kuq per xhaketen, me perberje 100 % PES
- **Merle** (flieseline e posacme per kostume) si material ngjites perforcues special te pershtatshem per xhaketen, pantallonin me perberje 100 % PES
- **Shirit tekstili stof terital i kuq 3 mm** per fileto e kapeles, xhaketes dhe pantollonave sipas specifikimit
- **Fije ngjyre ari** per qendisjet ne jake e menget e xhaketes.
- **Fill i zi** per qendisjet ne xhakete.
- **Kanavace** cil I-re me perberje 100 % lesh
- **Vata** te posacme per kostum (materiali i vatave te mos jete pambuk)
- **Velkrofe femer** ne ngjyre te kuqe
- **Astar xhepi** ne ngjyre sipas stofit, material tekstil me perberje 100 % viskoz
- **Kopsa te medha Garde**, cope 18 + 2 rezerve (sipas specifikimeve)
- **Kopsa te vogla Garde** per kapelen, cope 2 + 1 rezerve(sipas specifikimeve)
- **Qemer** i pergatitur per pantallonat
- **Kopsa te vogla** te zeza ebaniti
- **Kapse metalike** mashkull –femer per mbylljen e pantallonave
- **Zinxhir** me dhembeza plastike 22-24 cm per pantallonin
- **Penj qepje** sipas stofit me Nm 80/2 per qepje industriale me perberje 100 % PES
- **Materiallet** qe duhet te perdoren per ndertimin e kapeles si: shirit tel çeliku petashuq, material ingeliti me vrima ne siperfaqe, shirit plastik i presuar me vrima, astar i zi me vrima per ajrim, strehe me ngjyre te zeze me lluster,
- **S teme Garde** me velkrof mashkull (sipas specifikimeve)
- **S teme Republike** me velkrof mashkull (sipas specifikimeve)

Artikulli “Kostum ceremoniali dimri” **do** te prodhohet mbi bazen e matjeve trupore te personave te cilet do te furnizohen me kete artikull, nga nje perfaqesues i subjektit furnizues i cili eshte i detyruar ta respektojte saktesisht ato.

Prodhimi i artikullit “Kostum ceremoniali dimeror” duhet te realizohet sipas nje procesi teknologjik te percaktuar mbi bazen e kerkesave dhe kushteve teknologjike te sakta ne secilen faze te realizimit te tij. Prodhimi ndahet ne tre faza kryesore te cilat jane :

- perpunimi pergatitor
- konfeksionimi (procesi i qepjes)
- Ambalazhimi,marketimi dhe ektiketimi

Perpunimi pergatitor ka te beje me kolaudimin e lendeve te para dhe ndihmese,skicimin,prerjen ne prestari,marketimin dhe kollaritjen e pjeseve perberse te kostumit (xhaketes,pantallonit, dhe kapeles).

Konfeksionimi ka te beje me qepjen e pjeseve perberse te kostumit (xhaketes,pantallonit, dhe kapeles) sipas nje procesi linear te percaktuar.Ne faza te ndermjetme te ketij procesi do te kryhet hekurosja dhe presimi me avull i gjysemprodukteve.Ne perfundim kryhet dhe hekurosja e produktit te gatshem.

Ambalazhimi ka te beje me etiketimin, amblazhimin per cdo produkt dhe amblazhimin total te gjithë sasise te produktit te gatshem dhe pergatitjen e tij per levrimin drejt magazinave te perdoruesit

PERPUNIMI PERGATITOR

Kolaudimi i lendes se pare dhe materialeve ndihmese

Kolaudimi i lendes se pare dhe materialeve ndihmese ne menyre te sakte dhe te drejte eshte baze per nje ecure cilesore te procesve teknologjike te metejshme zinxhir per prodhimin me cilesi te artikullit “Kostum ceremoniali”

Skicimi

Ky proces duhet te realizohet me metodat matematikore te programimit linear te cilat sigurojne nje shenim te sakte te prerjeve dhe shenjave sipas vizatimeve duke pasur kujdes qe detajet e kostumit duhet te jene ne drejtim te fijeve te bazes.

Prerja

Procesi i prerjes duhet te behet me shume kujdes qe te mos te kete devijime ne fletet e fundit te dyshekut i cili eshte mire qe te mos te kaloje 30 flete. Kujdes duhet te behet dhe ne pjeset e harkuara te detajeve dhe buzet e prera te mos jene me dhembza.

Marketimi

Ky proces eshte shume i rendesishem sepse eliminon qepjen e detajeve te kostumit me tonacione te ndryshme duke siguruar njellojshmeri ne ngjyre te artikullit.

Kollaritja

Detajeve gjysem te gatshme te pantallonit, ngjitja e flieselines duhet te behet me prese speciale me avull ne Tem. 130-140 C, ne kohe 8-10 sek. ne presion 2 atm. Ky proces duhet te kryhet sa me i sakte ne menyre qe te mos kete asnje mundesi qe ne objekt te krijohen deformime gjate hekurosjes me avull, larjes dhe lagies nga shiu, te cilat bejne te mundur humbjen e pamjes fillestare. Kollaritja dhe ngjitja nuk lejohet me shtesa.

Merlja (flieseline e posacme per kostume) ngjitet ne perparsen e djathte e te majte te xhaketes, ne jaka dhe kapaket e xhepave. Gjithashtu, Merlja (flieseline e posacme per kostume) ngjitet ne keto pjese si me poshte:

4 detaje tek fundet e menges, 4 detaje tek fundet e xhaketes mbrapa, 2 detaje ne pjesen e shpines siper, 2 detaje ne gavature, 2 detaje tek mostra e xhepit brenda, 2 detaje tek qemeri i pantallonit, 1 detaj tek filetoja e pantallonit, 1 detaj tek kapaku i xhepit te pantallonit, 1 detaj tek sallkia, 2 detaje tek kanavaca.

KONFEKSIONIMI (Procesi i Qepjes)

XHAKETA.

Xhaketa eshte dopjopet me jake te zeze te mbyllur, e cila ne anesore pershkohet nga nje shirit me ngjyre te kuqe 3 mm. Jaka ne gjithë gjatesine e saj, eshte e qendisur me fije ngjyre ari, me gjethe ne forme kurore, qe fillojne nga perpara e bashkohen ne mesin e jakes prapa. Xhaketa perpara mbyllet me 9 çifte kopsash te medha Garde nga te cilat vetem ato te perpareses se djathte jane funksionale te cilave u korespondojne vrimat ne perparesen e majte, ndersa kopsat e krahut te majte te qepura ne menyre simetrike me ato te krahut te djathte jane fallso (shih specifikimet teknike bashkelidhur).

Xhaketa tek supet ka dy spaleta pllake me ngjyre te arte.

Ne pjesen e perparme te mengeve eshte qendisur me fill te zi shqiponja, ne mesin e se ciles eshte qendisur me fill ngjyre ari, perkrenarja e Skenderbeut.

Xhaketa ne pjesen e brendeshme (perpara) deri ne fund ka te vendosur kanavac importi te perbere nga dy pjese , ose frazeline tekstil komplet dhe nje pjese kanavace ne gjoks. Perparsja, shpina dhe menget jane te veshura me astar mendafshi me ngjyre te njellojte me stofin ose te perafert me te.

Xhaketa ne mengjen e djathte 7-8 cm poshte qepjes se bashkimit te menges me trupin e matur nga pika me e larte e supit ne qender qepet “Stema e Gardes” sipas specifikimeve teknike qe pershkruhen me poshte. Po keshtu ne mengjen e majte te xhaketes 7-8 cm poshte qepjes se bashkimit te menges me trupin e matur nga pika me e larte e supit ne qender qepet “Stema e Republikes” sipas specifikimeve teknike qe pershkruhen ne poshte.

Xhaketa duhet te jete simetrike ne te gjithë elementet perberes te saj.

Gjokseve te xhaketes u ngjitet merlja (flieseline e posacme per kostume) ne prese speciale. Pas ketij procesi gjokseve u ngjitet shirit fortese ne sup,ne gavature dhe ne pjesen fundore te gjokseve. Gjokseve u vendoset materiali perforcues kanavace. Kanavaca duhet te jete me dy fortesa. Fortesa e dyte duhet te jete rreth 10-12 cm me e shkurter se e para. Per ti dhene formen e plote te gjoksit kanavaces duhet ti behen 2-3 prerje. Pas fiksimit te kanavaces dhe mbylljeve te prerjes se saj behet kalimi ne procesin e hekurosjes me prese speciale me avull ku i jepet forma e gjoksit. Ky proces ka rendesi te vecante sepse jep formen e trupit prandaj duhet bere me shume kujdes qe rrudhat qe mund te krijohen te eliminohen duke i shtyre ne drejtim te qepjeve anesore te xhaketes.

Shpina eshte e drejte e paçare. Ne gavaturen e shpines vendoset nje fortese. Ne pjesen e supit tek koka e menges vendosen vatat speciale per kostum te cilat duhet te dalin 1-1.5 cm nga buza e supit. Vatata speciale per kostum vendosen me pak kend qe ti pershtaten formes se supeve. Gjate montimit te shpines me gjokset duhet bere shume kujdes ne menyre qe te mos krijohen diferenca ne gjatesi te gjokseve.

Astari i brendshem perbehet nga ai i perparses, i shpines dhe i mengeve. Prerja e astareve te gjokseve, te shpines dhe te mengeve duhet te jene ne po ate forme qe kane copat e prera te stofit me rezerven e duhur. Fiksimi i astarit ne trupin e xhaketes duhet te behet me kujdes ne menyre te tille qe te rri i shtrire mire dhe pa rrudha duke iu pershtatur pjeseve e xhaketes. Pas fiksimit te astarit behet kthimi dhe palosja e fundit te xhaketes duke pasur kujdes qe astari te mos varet poshte duke dale jashte fundit te saj. Po keshtu dhe per astarin e mengeve.

Jaka. Jaka ne gjithë gjatesine e saj, ka te qendisur me fije ngjyre ari, gjethe ne forme kurore, qe fillojne nga perpara e bashkohen ne mesin e jakes prapa. Montimi duhet bere me kujdes qe jaka te jete uniforme dhe simetrike. Permasa e jakes duhet te jete e njejte dhe e shtrire mire ne te gjithë gjatesine e saj dhe ti pershtatet sa me mire qafes se perdoruesit, ne dy buzet e jakes nga brenda vendosen dy çifte kapse teli per te realizuar mbylljen e plote te jakes rreth qafes. Jaka gjate qepjes ne trupin e xhaketes kalohet 2 here ne hekurosje me prese speciale me avull.

Lart ne jake nga brenda qepet nje etikete e vogel qe tregon numrin me prerjen perkatese te gjoksit te kostumit dhe vendoset dhe nje fitil tekstili qe do sherbeje per te varur xhaketen.

Menget jane te perbera nga pjesa e sipërme dhe pjesa e poshtme. Ne fund te menges nga brenda me hekur vendoset shirit ngjites per thyerjen e menges. Mbyllja e supeve duhet bere ne menyre te atille qe buzet te mos kene rrudha apo vende te ngritura dhe te shtrihen mire. Modeli i mengeve eshte me supe te ngritura.

Bashkimi i mengeve. Per bashkimin e mengeve me trupin e xhaketes duhet qe thellesia e rrethit te sjetulles te perputhet me thellesine e menges. Gjate bashkimit te menges ne trupin e xhaketes, per te pasur nje bashkim te forte, te ngritur dhe te harkuar bukur, rreth e qark menges ne pjesen e bashkimit mbi vaten fiksohet nje fitil prej stofi. Bashkimi i mengeve me trupin e xhaketes duhet te jete simetrik. Bashkimi duhet te behet pa rrudha ne pjesen e sipërme te menges dhe te mos formoje terheqje apo pale ne pjesen e perparme dhe te pasme te saj.

Spalinat jane pllake dhe vendosen ne te dy supet. Spalinat perbehen nga pjese e sipërme dhe e poshtme. Pjeses se sipërme te spalines per perforcim i vendoset flieseline. Spalina ka gjatesi deri te bashkimi me jaken dhe gjeresi 5 cm.

Spalines 5 mm larg buzeve i kalohet nje tegel zburimi. Montimi i spalinave ne xhakete duhet te behet ne menyre te tille qe mesi i spalines te perputhet me tegelin e bashkimit te shpines me gjoksin. Spalinat duhen te shohin lart. Spalina nga ana e jakes behet me maje te rumbullaket dhe mberthehet me ane te nje velkrofi.

Ne fund te gjithë ketij procesi xhaketa kalon ne fazat e hekurosjes perfundimtare duke bere kujdes qe te ruhet forma e gjokseve dhe e xhepave. Mbas ketij procesi kalohet ne qepjen e kopsave.

Vrimat dhe kopsat duhen te vendosen ne distancat e percaktuara dhe te korrespondojne me njera-tjetren.

Pantalloni ka dy xhepa te pjerret perpara me fileto stofi me gjeresi 3 mm dhe nje xhep te brendshem mbrapa po me filet 3 mm qe mbyllet me kapak me kopse ebaniti ne ngjyre te zeze. Sallkia eshte me stof dhe fileto astari dhe per mbyllje i fiksohet nje zinxhir plastik me dhembza te vegjel. Qemeri ka 7 (shtate) mbajtese rripi. Mbyllja e pantallona ne mes realizohet me kapese metalike mashkull-femer dhe me kopse. Ne mes te qemerit nga brenda vendoset etiketa me numrin dhe prerjen perkatese te pantallonit si dhe instruksioni i larjes, i pastrimit, i hekurosjes dhe i perdorimit. Pantalloni eshte me dy penca nga jashte. Xhepat anesore jane me astar permasat e te cilave jepen ne tabelen perkatese. Pantalloni ne dy anesoret ne bashkimin e perparseve me pjesen e prapme te tyre, pershkohet nga shirit i kuq 3 mm, nga qemeri deri ne fund te pantallonit.

Pantallonit ne fund lihet lisho ose i lihet 5 cm rezerve dhe ne fund te pales i vendoset fortese astari.

Per te qepur pantallonin ne fillim pergatiten pjeset ndihmese si: qemeri, filetot, astaret dhe kapaket e xhepave, mbajteset e rripit dhe sallkia.

Qemeri duhet te pergatitet ne menyre te tille qe te mos rrije as i shtreguar dhe as i lire. Gjeresia e qemerit perpara duhet te jete 4.5 cm ndersa mbrapa 3.5 cm. Qemeri duhet te jete i perforcuar me flieseline dhe nga brenda i qepet astar i posacem per qemer. Qemerit pergjate gjithë gjatesise se tij i kalohet tegel zburimi 1 mm larg buzes ne te dy anet. Qemeri ka 7 (shtate) mbajtese rripi te kthjera te pershkruara me tegela siper 1mm larg buzes.

Kapaku i xhepit te pasem eshte me maje ne forme trekendeshi. Kapaku perbehet nga pjese e sipërme dhe e poshtme. Pjeses se sipërme per perforcim i ngjitet flieselina, bashkohen me pjesen e poshtme, kthehet, i qepet astar nga mbrapa, hekuroset dhe i kalohet nje tegel zburimi 1mm larg buzes. Gjate kthimit duhet bere kujdes qe cepat dhe majat e kapakut te mos dalin te rumbullaket.

Hekurosja perfundimtare e pantallonit duhet bere me kujdes sidomos per formimin e vijes se hekurit ne menyre qe ajo te rrije drejt ne mes te kembes.

Tegelat e qepjes te xhaketes dhe pantallonit duhet te jene me hap 30 shpime ne 5 cm. Tegelat duhet te jene te forte, uniforme, te mos kene vende te shqepura, te jene simetrike, te rregullt dhe te drejte. Buzet e mbylljeve te brendeshme te behen me syzator me 3 fije dhe te jene te tilla qe te mos krijojne dhe lejojne daljen e fijeve. Tegelat duhet jene te forte ne menyre te tille qe te mos hapen nen ushtrimin e forces se duarve. Fortesia e tegelave te jete mbi 12 kG. Thellesia e tegelave ne qepje tek pantalloni te jete 1.5 cm. Tegelat duhet te jene te perforcuar ne fund. Peri qe do te perdoret per qepje duhet te jete i forte dhe me ngjyre te erret si ajo e stofit me Nm 80/2 ,100 % PES.

KAPELJA :

Per procesin e pergatitjes dhe qepjes se kapeles se kostumit nevojiten makina speciale qepjeje dhe punetore te specializuar sidomos per procesin e montimit dhe qepjen e strehes se kapeles. Materialet te cilat duhen te perdoren per ndertimin e kapeles jane:

- **Stof** i njejte me ate te pantallonit.
- **tel petashuq** shirit çeliku me gjeresi 2 - 3.5 mm qe vendoset ne brendesi rreth e qark tepelekut
- **shirit plastik** i presuar me vrima per ajrim me gjeresi 5.5 cm dhe trashesi 1-2 mm per perforcim si
- **fortese** rreth e qark qemerit
- **shirit** i zi 4.5–5.5 cm i gjere, material ingeliti me vrima per ajrim qe vendoset rreth e qark qemerit
- **astar** i zi i birosur per ajrim qe vendoset brenda kapeles, poshte tepelekut
- **Material** plastik i pathyshem, per fortese ku do te vendoset emblema
- **strehe** e zeze me lluster e perforcuar ne brendesi me karton prespan te presuar ose flete PVC e presuar me trashesi 1.5 – 2 mm

Permasat kryesore te kapeles jepen ne tabelen e meposhteme (ne cm) :

- **A** – lartesia e rrethit te kapeles sipas perimetrit te kokes
B – gjeresia e urave perpara
C – gjeresia e urave mbrapa
D – gjatesia ne qender e tepelekut te kapeles
E – gjeresia ne qender e tepelekut te kapeles
F – gjatesia e shiritit petashuq te celikut qe vendoset perreth tepelekut te kapeles

Nr. kapeles	53	54	55	56	57	58	59	60	61	62	tol. +/- cm
Permasa											
A	4.5	4.5	4.5	4.5	4.5	4.5	4.5	4.5	4.5	4.5	0.1
B	7	7	7	7	7	7	7	7	7	7	0.1
C	4.5	4.5	4.5	4.5	4.5	4.5	4.5	4.5	4.5	4.5	0.1
D	26.5	26.5	27.5	27.5	28	28	28.5	28.5	29	29	0.3
E	25.5	25.5	26	26	27	27	28	28	28.5	28.5	0.3
F	74	75	76	77.5	79	81	83	85	87	89	0.5

Kapelet do jene te numrave nga 55-60 ne sasite e meposhtme.

Nr	55	56	57	58	59	60	Shuma
%	12	14	16	8	8	2	60

Kapelja perbehet ne vetevete nga tepeleku, kater urat dhe qemeret. Brenda kapeles nga poshte siperfaqes se stofit te tepelekut vendoset i shtrire mire astar me vrima (material special) qe ka si veti kryesore lejimin e depertueshmerise se ajrit dhe avujve te kokes te perdoruesit. Streha plastike eshte e veshur me stof si te kapeles mbi te cilen i ne pjesen e perparme ne gjithë gjatesine e saj ka te qendisur nje shirit ne forme gjethe lisi e punuar me fije me ngjyre ari. Kapelja ne bashkimin e tepelekut me rrethin, pershkohet nga nje shirit i kuq 3 mm.

Filetoja e tekstilit vendoset e shtrire mire ne menyre te dukshme siper tek tepeleku pergjate gjithë perimetrit te tij dhe ne te dy buzet siper dhe poshte perreth te gjithë perimetrit te qemerit. Urat perpara dhe mbrapa duhet te jene te perforcuara me fortese te kollaritur.

Streha e kapeles me trashesi 2.5-3.5 mm ne brendesi eshte e perforuar me karton prespan te presuar ose i flete PVC e presuar me trashesi 1.5 – 2 mm. Ne pjesen e sipërme streha mbulohet me nje flete PVC-je ne ngjyre te zeze. Streha ka forme gjysem hene ku harku i brendshem duhet te jete me rreze 230-240 mm nga e cila del masa 205 mm. Pjesa e perparme ne forme kurbe ne qender te strehes duhet te kete gjeresi 56-57 mm duke iu afruar te dy ekstremeve deri ne piken zero me harkun e pare.

Kujdes: Streha siper ka te montuar nje shirit ne forme gjethe lisi e punuar me fije metalike, ngjyre ari.



SPECIFIKIM TEKNIK : Kopsa të medha dhe të vogla Garde



E madhe Ø 22 mm



E vogël Ø 1,4 mm

1.Pershkrimi.

Janë me ngjyrë të artë për të gjitha llojet e gradave. Kopsat në qendër të tyre kanë të stampuar në relief shenjën dalluese përkrenaren e Skënderbeut në profil me pamje nga e djathta, ku shkruhet në mënyrë gjysëm rrethore me shkronja kapitale “GARDA E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”.

Trashësia e kopses në ane është 3.5 mm, në qendër është 5 mm.

Bishti i kopses është i derdhur së bashku me pjesën tjetër të saj me këto dimensione : gjatësi , gjeresi 5+/- 0.3 mm, trashësi 3+/-0.2 mm dhe me vrimë në mes.

Vrima të reziztoje forca të tërheqjeje dhe të jete të zmusuar.

2.Materiali

Kopsat janë të punuara me material metal të lehtë në një sasi të mjaftueshme në brendësi të stampave duke realizuar reliefet e vendosura dhe të kerkuara mbi kopsa.

Kopsat kalojnë në metalizim në ngjyrë të artë duke ruajtur efektin e punimeve të imta që kërkon modeli ashtu edhe për ruajtjen dhe shkelqimin e ngjyrës nga oksidimet eventuale që mund të vijnë nga agjentët atmosferik, kimik e mekanikë.

3.Ngjyrat

Ngjyra e artë pa shkelqim (mat), për të dy tipet e kopsave.

4.Punimi

Nuk lejohet punimi me ngjyrosje apo sprucim.

5.Dimensionet

Kopsa e madhe është në formë të rrumbullakët me diametër 2.2 cm.

Kopsa e vogël me diametër 1.4 cm.

6. PROVA TEKNIKE

Cilesia e kopsave provohet

- Rezistenca në ujë; Zhytet në ujë të distiluar 24 orë në 25 °C
- Rezistenca në detergjive ; Zhytet 24 orë në solucion sapuni marseje 3% në 25 °C.
- Rezistenca ndaj tretësve; Kampionet i kalojnë një shtresë alkool etilik dhe menjëherë me pas një shtresë benzine, të cilat nuk verifikojnë humbje të ngjyrave.
- Rezistenca në klorur sode; zhytet kampioni një orë në solucion klorur sode

SPECIFIKIM TEKNIK : Rripi ceremonial

Rripi ceremonial është material sintetik 100% sintetik, fill i thurur me ngjyrë të artë. Permasat e rripit të jenë, gjatësia 130 ± 1 cm dhe gjersia $5 \text{ cm} \pm 0.2$ cm.

Mberthimi i rripit të mezit realizohet me togez metalike ngjyrë të artë i cili ka të stampuar në qendër shqiponjën e flamurit kombëtar, rezistent ndaj koruzionit.

Në njërën anë vendoset togeza ndërsa në anën tjetër vendoset një fletë metalike e dhembëzuar e cila është fiksuar në togez, që shërben për shterngimin apo lirimin e gjatësisë së rripit duke patur edhe pjesë sigurouese për funksionimin e saj.


Ai duhet të jete i manovrueshem në shterngimin apo lirimin e gjatësisë së rripit duke patur edhe pjesë sigurouese për funksionimin e saj. Mberthimi dhe zberthimi i pjesës së togzës të jete i lehtë e funksional gjatë përdorimit.

SPECIFIKIM TEKNIK: Shirit dekorativ (fjongo)

1.Pershkrimi.

Shiriti dekorativ (fjongo) është prej fill pambuk-poliester, i thurur, me ngjyre ari, vendoset ne krahun e majte nen spaline, e varur poshte ne gjithe gjatesine e tij dhe kapet me ane te nje kapse ne nivelin e kopses se pare te xhaketes.

Shiriti është me dy kordone kryesore, te cilat mbyllen ne pjesen fundore te tyre me nje pjese metalike zbukurimi te punuar, me ngjyre te arte me gjatesi 7 cm.Secili kordon shoqerohet me dy shiritita me te holl,qe kane trashesine e nje elementi qe është thurur ne forme gersheti shiriti kryesor.



2.Materiali

Fill i thurur me perberje 70% poliéster dhe 30% pambuk

3.Ngjyrat

Ngjyra e arte me shkelqim.

4.Punimi

Nuk lejohet punimi me ngjyrosje

5.Dimensionet

Shiriti kryesor qe rrotullon krahut e majte nen spaline te jete me gjatesi 80 cm.

Kordoni tjetër qe i bashkengjiten shiritit kryesor është me gjatesi 50 cm.

Etiketimi, amballazhimi

Kostumit(kapeles, xhaketes e pantallonit) ne pjesen e brendeshme te tyre u vendoset nga nje etikete e cila duhet te permbaje : nr. i gjoksit, prerjen dhe shenjat konvencionale te trajtimit te stofit ne larje hekurosje, nr. kapeles etj. Te xhaketa etiketa qepet ne pjesen e brendshme te jakes ne qender te saj ku bashkohet me shpinen, te pantalloni ne pjesen e brendshme ku bashkohet qemeri me perparesen, te kapelja ne pjesen e brendshme te tepelekut.

Kostumi kompletohet xhakete dhe nje pale pantallona , vendoset ne varse rrobash (kremastar) dhe futet ne qese transparente plasmasi.

STEMA E REPUBLIKËS (Shenjë krahu)

Lëndët e para e ndihmëse:

Material i hollë e reziztent tekstili i qendisur me penjë sipas ngjyrave të çdo elementi të stemës.

Stemës mbas qendisjes i qepet velkrof mashkull, me të njëjtat permasa , duke e realizuar si një trup të vetem.

Qendrueshmeria e ngjyrave dhe rezistenca në keputje të jete e lartë.

Elementët përbërës të stemës.

Stema është në formen e një mburoje me permasa 7.5 x 6 cm +/-0.1 cm.

Pjesa e sipërme është e drejtë ndersa e pjesa e poshtme në formë ovale (shqyti). Fusha është në ngjyrë të kuqe në mes të së cilës gjëndet shqiponja dykrenare e qendisur me penj me ngjyrë të zezë mbi të cilën në qendër vëndoset perkrenarja e Skenderbeut qëndisur me penj ngjyrë ari,në profil me pamje nga e djathta.

Stema rrethohet me një kornizë qendisur me penj ngjyrë ari të vijeuar me gjerësi 2 mm. Stema në tërësi si dhe gjithë elementët përbërës të saj të jenë rezistente ndaj gjithë faktoreve atmosferike. Po kështu dhe qendrueshmeria e ngjyrave të jetë shumë e mirë. Stema vendoset në krahun e majtë me anë të një velkrofi femer- mashkull.



STEMA E GARDËS SË REPUBLIKËS (Shenjë krahu)

Lëndët e para e ndihmëse:

Material i hollë e reziztent tekstili i qendisur me penjë sipas ngjyrave të çdo elementi të stemës.

Stemës mbas qendisjes i qepet velkrof mashkull, me të njejtat permasa , duke e realizuar si një trup të vetem.

Qendrueshmeria e ngjyrave dhe rezistenca në keputje të jete e lartë.

Elementët përbërës të stemës.

Stema është në formën e një mburoje (shqyti) me permasa 7.5cm x 6 cm +/-0.1 cm. Pjesa e sipërme është e drejtë ndersa e pjesa e poshtme në forme ovale (shqyti).

Stema rrethohet me një kornizë ngjyrë ari, me gjëresi 2 mm, në qendër të saj është vendosur shqiponja e zezë dykrenare, e përdorur si simbol në krijimin e këtij formacioni. Mbi shqiponjë qëndron përkrenarja e Heroit tonë kombëtar, Skënderbeut, në ngjyrë të artë. Përkrenarja e Skënderbeut është vendosur në pamje ballore, për të bërë të mundur leximin e shkronjave “BT”, ”IN”, duke respektuar semantiken, rregullat dhe stilet araldike të kurorave, e duke bërë më të lexueshme çfarë përfaqëson kjo përkrenare. Ajo i shmanget kopjimit përsëritës të saj, duke e bërë të vecantë për këtë institucion. Në këtë pozicion shikohet karakteri i saj laik e qytetar, fisnik e ushtarak. Emblema evidenton ndërthurjen e madhështisë me bukurinë që paraqet ky element në fushën e sematikës Shqiptare.

Duke qenë se stema shërben edhe si shenjë krahu për gardistët në pjesën harkore të shqytit, është shkruar me gërma kapitale “GARDA E REPUBLIKËS”.

Stema në teresi si dhe gjithë elementet përbërës të saj të jenë rezistentë ndaj gjithë faktoreve atmosferike. Po kështu dhe qendrueshmeria e ngjyrave e copës dhe penjëve të përdorur të jetë shumë e mirë.



Afati i lëvrimit: Brenda 90 ditëve nga lidhja e kontratës, por jo më vonë se data 20 dhjetor e vitit planifikues.

KOLAUDIMI MARRJA NE DORZIM

Pranimi i të gjithë sasisë të artikullit “Kostum ceremoniali dimri” të përcaktuar në kontratë dhe të dorëzuar në magazinën e Gardës, do të bëhet vetëm në bazë të rezultateve që do të marrën gjatë procesit të Kolaudimit për të gjithë sasinë e produktit të gatshëm të dorëzuar në magazinë. Kolaudimi do të bëhet mbi bazën e rezultateve të Fletë-analizave laboratorike të lëshuara nga Laboratore të Akredituar të Tekstil-Konfeksioneve, që shoqërojnë mallin, të sjella nga kontraktuesi, sipas përcaktimeve në kontratë, dhe ekzaminimit të mallit të furnizuar, që do të bëjë “Komisioni i pritjes, kontrollit dhe pranimi të mallit të Gardës së Republikës”,

i cili kryen direkt matjet e vlersimet organo-leptike të sasisë së mallit të dorëzuar dhe bën krahasimin e të gjithë këtyre rezultateve me kërkesat dhe të dhënat teknike të këtij specifikimi teknik, kampionit të ofruar dhe modelit të miratuar. Gjithashtu, komisioni nëse e shikon të aryeshme dërgon mostra e kryen analiza laboratorike pranë laboratorëve të akredituar, duke i krahasuar rezultatet e tyre me rezultatet e analizave të sjella nga OE furnizues.

Artikulli konsiderohet teknikisht i pranuar kur ai ploteson të gjitha kërkesat e këtij Specifikimi Teknik.

Shenim: Ky Specifikim Teknik, kampioni, modeli dhe ngjyra e artikullit “Kostum ceremoniali dimri”, janë pronë e Gardës së Republikës dhe për nga qëllimi i përdorimit ato i perkasin vetëm strukturave të saj. Nuk lejohet shumfishimi dhe realizimi i këtij specifikimi teknik, kampionit, modelit dhe ngjyrës së artikullit “Kostum ceremoniali dimri”.

Çdo standard i kërkuar apo çdo referencë marke të mallrave objekt prokurimi, autoriteti kontraktor do të pranojë edhe ekuivalentin e tij.

Shtojca 7.*(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)**(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti/enti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)***FORMULARI I SASISË DHE GRAFIKUT TË LËVRIMIT****Sasia e mallit që kërkohet:**

Nr.	Emertimi i artikujve	Njesia matese	Sasia e pritshme	Destinacioni	Periudha e dorëzimit
1	Kostum uniforme	Komplet	170	Garda Republikes	36 muaj marrëveshje kuadër
2	Kostum sherbimi e stervitje	Komplet	1250	Garda Republikes	36 muaj marrëveshje kuadër
3	Xhup $\frac{3}{4}$ me veshje të ngrohtë	Copë	800	Garda Republikes	36 muaj marrëveshje kuadër
4	Xhakovento	Copë	120	Garda Republikes	36 muaj marrëveshje kuadër
5	Kemishë me mëngë të shkurtëra	Copë	420	Garda Republikes	36 muaj marrëveshje kuadër
6	Bluzë mëngë të shkurtëra me tre kopsa	Copë	3310	Garda Republikes	36 muaj marrëveshje kuadër
7	Bluzë e brendshme pambuku mëngë të shkurtëra	Copë	1600	Garda Republikes	36 muaj marrëveshje kuadër
8	Bluzë e brendshme pambuku mëngë të gjata	Copë	1400	Garda Republikes	36 muaj marrëveshje kuadër
9	Kemishë me mëngë të gjata	Copë	600	Garda Republikes	36 muaj marrëveshje kuadër
10	Pelerinë shiu	Copë	120	Garda Republikes	36 muaj marrëveshje kuadër
11	Rrip mesi	Copë	900	Garda Republikes	36 muaj marrëveshje kuadër
12	Rrip pantalloni	Copë	100	Garda Republikes	36 muaj marrëveshje kuadër

13	Krevatë uniforme	Copë	100	Garda Republikës	36 muaj marrëveshje kuadër
14	Pulover uniforme	Copë	160	Garda Republikës	36 muaj marrëveshje kuadër
15	Pantallona vere	Palë	400	Garda Republikës	36 muaj marrëveshje kuadër
16	Doreza të bardha ceremoniali	Palë	300	Garda Republikës	36 muaj marrëveshje kuadër
17	Grada gjoksi	Copë	1400	Garda Republikës	36 muaj marrëveshje kuadër
18	Grada supi	Palë	400	Garda Republikës	36 muaj marrëveshje kuadër
19	Shenjë emri	Copë	2625	Garda Republikës	36 muaj marrëveshje kuadër
20	Emblemë e vogël	Copë	1250	Garda Republikës	36 muaj marrëveshje kuadër
21	Kostum dimëror (xhup, pantallona, kapele sport) policia rrugore	komplet	20	Garda Republikës	36 muaj marrëveshje kuadër
22	Pantallona doku ripstop + kapele (policia rrugore)	palë	60	Garda Republikës	36 muaj marrëveshje kuadër
23	Bluzë pambuku me 3 kopsa, me mëngë të shkurtra (policia rrugore)	copë	80	Garda Republikës	36 muaj marrëveshje kuadër
24	Pelerin shiu (policia rrugore)	copë	20	Garda Republikës	36 muaj marrëveshje kuadër
25	Kostum ceremonial vere (kapele, xhaketë, pantallona, shirit dekorativ (fjongo), rrip mesi ceremonial)	komplet	30	Garda Republikës	36 muaj marrëveshje kuadër
26	Kostum ceremonial dimri (kapele, xhaketë, pantallona, shirit dekorativ (fjongo), rrip mesi ceremonial)	komplet	30	Garda Republikës	36 muaj marrëveshje kuadër

Afatet e lëvrimit: -Afati i marrëveshjes kuadër është 36 (tridhjetë e gjashtë) muaj nga data e nënshkrimit dhe afati i lëvrimit të mallit është brenda 90 (nëntëdhjetë) ditëve nga data e nënshkrimit të kontratës përkatëse, por jo më vonë se data 20 dhjetor e vitit planifikues.

Vendi i dorëzimit të mallit është pranë magazinave të Gardës së Republikës

Shtojca 8.

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

OFERTUESI DEKLARON SE:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënua për ndonjë veprë penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënua ose nuk ka qenë i dënua nga një vendim i gjykatës i formës së prerë për çdo veprë penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi;
- dh) nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të Pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.
- j) ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.
- k) zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 9.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet/Entet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti/Enti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet:

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.
- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit ose entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 9;

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Referuar pikës 1 të shtojcës 8, ofertuesi duhet të deklarojë se përmbush kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit. Këto kritere duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 9.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

1. Për të provuar se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën, duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2021, 2022, 2023), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **jo më e vogël se vlera e fondit limit**. Kërkesa për plotësimin e

kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

2. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të çertifikuara të bilanceve të viteve: (2021, 2022, 2023) të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me raportet e auditimit ligjor të pasqyrave financiare vjetore, të kryera, nga auditues ligjorë ose shoqëri audituese. Kriteri konsiderohet i përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

2.3 Kapaciteti teknik:

1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, **në vlerën jo më pak se 40% e vlerës së fondit limit**. Këto furnizime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

- a. Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës dhe/ose faturat tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasitë e mallrave të furnizuara.
- b. Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasitë e mallrave të furnizuara.

2. Operatori ekonomik për realizimin e objektit të prokurimit duhet të ketë minimalisht 20 (njëzet) persona të punësuar, të cilët duhet të figurojnë në listpagesën e shoqërisë për 3 (tre) muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave.

- a. Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore për 3 muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave.
- b. Listpagesat e punonjësve të konfirmuara nga autoritetet përkatëse sipas formatit që kërkohej nga legjislacioni në fuqi për 3 muajt e fundit të deklaruar.

Shenim: Kriteri nr.2 konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit shtojca 9. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqiten në rast se operatori kualifikohet i pari, por përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

3. Operatori ekonomik për realizimin e objektit të prokurimit duhet të ketë staf teknik me kualifikimet si më poshtë, të cilët duhet të figurojnë në listpagesën e shoqërisë për 3 (tre) muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave;

Nr.	Profesioni	Numri punonjesve
1	Inxhinier tekstili	1
2	Stilist/Modelist veshjesh	1
3	Pergjegjes prodhimi/drejtues linje	1
4	Prestarë veshjesh/teknik prestarie	1
5	Rrobaqepës për qepje	15
6	Shofer	1

Për punonjësit me profesionet e mësipërme, Operatori Ekonomik duhet të paraqesë:

a) Për inxhinierin e tekstilit te paraqitet:

- Diplomën, që të vërteton kualifikimin profesional të mësipërm.
- Kontrate pune e vlefshme
- Inxhinieri i tekstilit duhet të kenë minimalisht 2 (dy) vite eksperiencë pune në këtë profesion, vërtetuar me librezë pune ose cdo dokument tjetër të barazvlefshëm.

b) Për stilist/modelist veshjesh, prestarë veshjesh/teknik prestarie dhe Pergjegjes prodhimi/drejtues linje te paraqitet për secilin:

- Diplome/dëshmi/certifikate kualifikimi profesional
- Kontrate pune e vlefshme.
- Stilist/modelist veshjesh, prestarë veshjesh/teknik prestarie dhe pergjegjes prodhimi/drejtues linje duhet të kenë minimalisht 1 (nje) vit eksperiencë pune në këtë profesion, vërtetuar me librezë pune ose cdo dokument tjetër të barazvlefshëm.

c) Për rrobaqepesin te paraqitet:

- Kontrate pune e vlefshme.
- Rrobaqepësi duhet të ketë minimalisht 1 (një) vit eksperiencë pune në këtë profesion, vërtetuar me librezë pune ose cdo dokument tjetër të barazvlefshëm.

ç) Per punonjesit shofer te paraqitet:

- Leje drejtimi mjeti e vlefshme.
- Kontrate pune e vlefshme ose kontratë shërbimi.

- Listëpagesat e punonjësve për 3 muajt e fundit, të deklaruar në organet tatimore nga data e hapjes së ofertave, sipas formës së parashikuar nga legjislacioni tatimor në fuqi.

Shënim: Duke qenë se mjetet e transportit, të kërkuara në këto dokumente mund të jenë edhe me qera ose në huapërdorje, përveçse në pronësi, është gjykuar e arsyeshme që punonjësit “Shofer” mund të diponohen edhe me kontraktim.

Shënim: Kriteri nr.3 konsiderohet i permbushur me plotesimin e formularit te vetedeklarimit shtojca 9. Dokumentet e kerkuara me siper do te paraqiten ne rast se operatori kualifikohet i pari, por perpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe nisjes se afateve te ankimit ose nese kerkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

4. Operatori ekonomik duhet të paraqesë: i. mostrat e artikujve, ii. mostrat e lëndës së parë dhe iii. fletë-analizë laboratorike të treguesve fiziko-mekanik e kimik të lëndës së parë të

perdorur nga prodhuesi, të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, të cilat vërtejnë se artikujt e ofruar janë në përputhje me specifikimet teknike të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Fletë analiza do të paraqitet nëpërmjet sistemit elektronik të prokurimit.

Mostrat e artikujve, lëndës së parë dhe fletë analizat do të paraqiten për artikujt si më poshtë:

1. Kostum uniforme (kapele, xhakete, pantallona ose fund për punonjëset) për punonjësit e Gardës së Republikës.

- 1 (një) komplet kostumi të perfunduar (kapele, xhakete, pantallona, fund) me nr gjoksi 50.
- 1 (një) pjesë stofi gjatësi 0,5 ml, gjërësi sa ajo e vet stofit.
- Fletë-analizë laboratorike të treguesve fiziko-mekanik e kimik të lëndës së parë të përdorur nga prodhuesi.

Copa e mostres, lëndës së parë dhe ajo që i bashkëngjitet raport-analizes duhet të jenë detyruesisht të njëjta.

Kostumit dhe lëndës së parë u qepet nga një etiketë tekstili të bardhë në të cilën shkruhet: moster “Kostum uniforme”, emri i ofertuesit, data e tenderit, nënshkrimi dhe vula e ofertuesit.

Mungesa e mostres, lëndës së parë dhe fletë analizës që shoqëron ato është kusht skualifikues.

2. Kostum sherbimi e stërvitje (1 xhakete, 1palë pantallona, beretë për e 1/2 sasisë së kostumëve, Kapele tip sport për 1/2 e sasisë së kostumëve) për punonjësit e Gardës së Republikës.

- 1 (një) komplet kostumi të përfunduar (xhakete, pantallona, kapele sport dhe beretë,) me nr gjoksi 50.
- 1 (një) pjesë tekstili 50 x50 cm.
- Fletë-analizë laboratorike të treguesve fiziko-mekanik e kimik të lëndës së parë të përdorur nga prodhuesi.

Copa e mostrës, lëndës së parë dhe ajo që i bashkëngjitet raport-analizes duhet të jenë detyruesisht të njëjta.

Kostumit dhe lëndës së parë u qepet nga një etiketë tekstili të bardhë në të cilën shkruhet: moster “Kostum sherbimi e stërvitje”, emri i ofertuesit, data e tenderit, nënshkrimi dhe vula e ofertuesit.

Mungesa e mostres, lëndës së parë dhe fletë analizës që shoqëron ato është kusht skualifikues.

3. “Xhup $\frac{3}{4}$ me veshje të ngrohtë” për punonjësit e Gardës së Republikës.

- 1 (një) copë “Xhup $\frac{3}{4}$ me veshje të ngrohtë” me nr gjoksi 50.
- 1 (një) pjesë pelhure impermeable gjatësi 0,5 ml, gjërësi sa ajo e vetë pelhurës impermeable.
- Fletë-analizë laboratorike të treguesve fiziko-mekanik e kimik të lëndës së parë të përdorur nga prodhuesi.

Copa e Xhupit moster, lëndës së parë (pelhurë impermeable) që shoqëron atë dhe ajo që i bashkëngjitet raport-analizës duhet të jenë detyruesisht të njëjta.

Xhupit $\frac{3}{4}$ dhe lëndës së parë, u qepet me tegel makine nga një etiketë tekstili e bardhë, me permasa të përafërta 10 x10 cm, në të cilën shkruhet: moster “Xhup $\frac{3}{4}$ me veshje të ngrohtë”, emri i ofertuesit, data e tenderit, nënshkrimi dhe vula e ofertuesit.

Mungesa e mostres, lëndës së parë dhe fletë analizës që shoqëron ato, është kusht skualifikues.

4. “Xhakovento” për punonjësit e Gardës të Republikës.

- 1 (një) copë “Xhakovento” me nr gjoksi 50.
- 1 (një) pjesë stof gjatësi 0,5 ml.
- Fletë-analize laboratorike të treguesve fiziko-mekanik e kimik të lëndës së parë të përdorur nga prodhuesi.

Copa e Xhakoventos moster, lëndës së parë që shoqëron atë dhe ajo që i bashkëngjitet raport-analizës duhet të jenë detyruesisht të njëjta.

Xhakoventos dhe lëndës së parë, u qepet me tegel makine nga një etiketë tekstili e bardhë, me permasa të përafërta 10 x10 cm, në të cilën shkruhet: moster “Xhakovento” emri i ofertuesit, data e tenderit, nënshkrimi dhe vula e ofertuesit.

Mungesa e mostres, lëndës së parë dhe fletë analizës që shoqëron ato është kusht skualifikues.

5. “Këmishë me mëngë të shkurtra” për punonjësit e Gardës së Republikës

- 1 (një) copë “Këmishë me mëngë të shkurtra” me nr gjoksi 50.
- 1 (një) pjesë pupline gjatësi 0,5 ml, gjërësi sa ajo e vet puplinës.
- Fletë-analize laboratorike të treguesve fiziko-mekanik e kimik të lëndës së parë të përdorur nga prodhuesi.

Copa e Këmishës moster, lëndës së parë (pjesë puplinë) dhe ajo që i bashkëngjitet raport-analizës duhet të jenë detyruesisht të njëjta.

Këmishës dhe lëndës së parë u qepet me tegel makine nga një etiketë tekstili i bardhë, me permasa të përafërta 10 x10 cm, në të cilën shkruhet: moster “Këmishë me mëngë të shkurta uniforme Garde”, emri i ofertuesit, data e tenderit, nënshkrimi dhe vula e ofertuesit.

Mungesa e mostrës, lëndës parë dhe fletë analizës që shoqëron ato është kusht skualifikues.

6. Bluzë mëngë të shkurta (me tre kopsa) për punonjësit e Gardës së Republikës.

- 1 (një) copë “Bluzë mëngë të shkurta (me tre kopsa)” me nr gjoksi 50.
Mostra duhet të ketë vulë dhe etikete origjinale të subjektit prodhues.
- 1 (një) pjesë trikotazhi me permasa 50 x 50 cm.
- Fletë-analizë laboratorike të treguesve fiziko-mekanik e kimik të lëndës së parë të përdorur nga prodhuesi.

Copa e mostrës, lëndës së parë dhe ajo që i bashkëngjitet raport-analizes duhet të jenë detyruesisht të njëjta.

Mos plotësimi nga subjekti prodhues (ofertues) në procedurë vlerësimi i tre kërkesave të mësipërme do të konsiderohet skualifikim teknik.

Bluzës së pambukut dhe lëndës së parë u qepet nga një etiketë tekstili në të cilën shkruhet: moster “Bluzë mëngë të shkurta me tre kopsa”, emri i ofertuesit, data e tenderit, nënshkrimi dhe vula e ofertuesit.

Mungesa e mostres, lëndës parë dhe fletë analizës që shoqëron ato është kusht skualifikues.

7. “Bluzë e brendshme pambuku mëngë të shkurta (jakë rrethore)” për punonjësit e Gardës së Republikës

- 1 (një) copë bluzë pambuku me nr gjoksi 50.

Mostra duhet të ketë vulë dhe etiketë origjinale të subjektit prodhues.

- 1 (një) pjesë trikotazhi me permasa 50 x 50 cm.
- Fletë-analize laboratorike të treguesve fiziko-mekanik e kimik të lëndës së parë të përdorur nga prodhuesi.

Copa e mostrës, lëndës së parë dhe ajo që i bashkëngjitet raport-analizës duhet të jenë detyruesisht të njëjta.

Mos plotësimi nga subjekti prodhues (ofertues) në procedurë vlerësimi i tre kërkesave të mësipërme do të konsiderohet skualifikim teknik.

Bluzës së pambukut dhe lëndës së parë u qepet nga një etiketë tekstili në të cilën shkruhet: moster “bluzë pambuku me mëngë të shkurta”, emri i ofertuesit, data e tenderit, nënshkrimi dhe vula e ofertuesit.

Mungesa e mostrës, lëndës së parë dhe fletë analizës që shoqëron ato është kusht skualifikues.

8. “Bluzë brendshme pambuku mëngë të gjata” për punonjësit e Gardës së Republikës

- 1 (një) copë “bluzë pambuku mëngë të gjata” me nr gjoksi 50.

Mostra duhet të kenë vulë dhe etikete origjinale të fabrikës prodhuese.

- 1 (një) pjesë trikotazhi me permasa 50 x 50 cm.
- Fletë-analizë laboratorike të treguesve fiziko-mekanik e kimik të lëndës së parë të përdorur nga prodhuesi.

Copa e mostrës, lëndës së parë dhe ajo që i bashkëngjitet raport-analizës duhet të jenë detyruesisht të njëjta.

Mos plotësimi nga subjekti prodhues (ofertues) në procedurë vlerësimi i tre kërkesave të mësipërme do të konsiderohet skualifikim teknik.

Bluzës së pambukut dhe lëndës së parë u qepet nga një etiketë tekstili në të cilën shkruhet: moster “bluzë pambuku me mëngë të gjata”, emri i ofertuesit, data e tenderit, nënshkrimi dhe vula e ofertuesit.

Mungesa e mostrës, lëndës së parë dhe fletë analizës që shoqëron ato është kusht skualifikues.

9. “Kemisha mëngë të gjata” për punonjësit e Gardës së Republikës.

- 1 (një) copë kemishë me nr jake 40.
- 1 (një) pjesë puplinë me permasa 50 x 50 cm.
- Fletë-analize laboratorike të treguesve fiziko-mekanik e kimik të lëndës së parë të përdorur nga prodhuesi.

Copa e mostrës, lëndës së parë dhe ajo që i bashkëngjitet raport-analizës duhet të jenë detyruesisht të njëjta.

Kemishe dhe lëndës së parë u qepet nga një etiketë tekstili në të cilën shkruhet: moster “kemishë me mëngë gjata”, emri i ofertuesit, data e tenderit, nënshkrimi dhe vula e ofertuesit.

Mungesa e mostrës, lëndës së parë dhe fletë analizës që shoqëron ato është kusht skualifikues.

10. “Pelerinë shiu” për punonjësit e Gardës së Republikës.

- 1 (një) copë “pelerin shiu” me masë gjoksi M.

Mostra duhet të kenë vulë dhe etikete origjinale të fabrikës prodhuese.

- 1 (një) pjesë Pelhurë impermeable (tekstil i gomuar) 100 % poliamid me lluster nga brënda, mostër me permasa 50 x 50 cm.

- Fletë-analize laboratorike të treguesve fiziko-mekanik e kimik të lëndës së parë të përdorur nga prodhuesi.

Copa e mostres, lëndës së parë dhe ajo që i bashkëngjitet raport-analizes duhet të jenë detyruesisht të njëjta.

Pelerinës si dhe lëndës së parë u qepet nga një etiketë tekstili në të cilën shkruhet: moster “pelerin shiu”, emri i ofertuesit, data e tenderit, nënshkrimi dhe vula e ofertuesit.

Mungesa e mostres, lëndës së parë dhe fletë analize që shoqëron ato është kusht skualifikues.

11. “Rrip mesi” për punonjësit e Gardës së Republikës

- 1 (një) copë “Rrip mesi”

Rripit i qepet një etiketë tekstili në të cilën shkruhet: moster “Rrip mesi”, emri i ofertuesit, data dhe vula e ofertuesit.

Mungesa e mostres është kusht skualifikues

12. “Rrip pantallonash” për punonjësit e Gardës së Republikës

- 1 (një) copë “Rrip pantallonash”

Rripit i qepet një etiketë tekstili në të cilën shkruhet: moster “ Rrip pantallonash ”, emri i ofertuesit, data e tenderit, nënshkrimi dhe vula e ofertuesit.

Mungesa e mostres është kusht skualifikues

13. “Krevatë uniforme” për punonjësit e Gardës së Republikës

- 1 (një) copë krevatë uniforme.

Mostra duhet të ketë vule dhe etiketë origjinale të fabrikës prodhuese.

- Fletë-analizë laboratorike të treguesve fiziko-mekanik e kimik të lëndës së parë të përdorur nga prodhuesi.

Copa e mostrës, lëndës së parë dhe ajo që i bashkëngjitet raport-analizës duhet të jenë detyruesisht të njëjta.

Mos plotësimi nga subjekti prodhues (ofertues) në procedurë vlerësimi i tre kërkesave të mësipërme do të konsiderohet skualifikim teknik.

Krevates dhe lëndës së parë u qepet nga një etiketë tekstili në të cilën shkruhet: moster “ Krevatë uniforme”, emri i ofertuesit, data e tenderit, nënshkrimi dhe vula e ofertuesit.

Mungesa e mostrës, lëndës së parë dhe fletë analizës që shoqëron ato është kusht skualifikues.

14. “Pulover uniformë” për punonjësit e Gardës së Republikës.

- 1(një) “**Pulover uniformë**” masa M

- 1 (një) pjesë tekstil trikotazhi me permasa 50 x 50 cm.

- Fletë-analizat laboratorike të treguesve fiziko-mekanik e kimik të lëndëve të para të përdorur nga prodhuesi.

Copa e mostrës, lëndës së parë dhe ajo që i bashkëngjitet raport-analizës duhet të jenë detyruesisht të njëjta.

Puloveres uniformë dhe lëndës së parë u qepet nga një etiketë tekstili në të cilën shkruhet: moster “Pulover uniformë” emri i ofertuesit, data e tenderit, nënshkrimi dhe vula e ofertuesit.

Mungesa e mostres, lendeve te para dhe flete analizave qe shoqerojne ato, eshte kusht skualifikues.

15. “Pantollona vere” për punonjësit e Gardës së Republikës.

- 1 (nje) pale pantallona, me nr.50.
- 1 (nje) pjese teritali me ngjyre te zeze nga i pantallonave me gjatesi 0,5 ml, gjeresi sa ajo e vet teritalit.
- Flet-analizat laboratorike te treguesve fiziko-mekanik e kimik te lendes te pare terital i zi te perdorur nga prodhuesi.

Teritali i pantallonave dhe copat e lendes se pare qe i bashkengjiten raport-analizave te laboratorit, duhet te jene detyrimisht te njejta.

Pantallonave moster dhe lendeve te para (pjeseve te teritalit), u qepet me tegel makine nga nje etikete tekstili e bardhe, me permasa te peraferta 10x10cm, ne te cilen shkruhet: moster “Pantollona vere teritali”, emri i ofertuesit, data e tenderit, nenshkrimi dhe vula e ofertuesit.

Mungesa e mostres, lendeve te para dhe flete analizave qe shoqerojne ato, eshte kusht skualifikues.

16. “Dorëza të bardha ceremoniali” për efektivin e truperojës së nderit të Gardës së Republikës.

- 1 (një) palë dorëza të bardha ceremoniali.

Dorëzave i qepet një etikete tekstili në të cilën shkruhet: moster “dorëza të bardha ceremoniali”, emri i ofertuesit, data e tenderit, nenshkrimi dhe vula e ofertuesit.

Mungesa e mostres është kusht skualifikues.

17. “Grada gjoksi” për punonjësit e Gardës së Republikës

- 4 (katër) copë Grada gjoksi të qendisura, nga një copë për secilin nivel.
Mostrat duhet të kenë të trapezuar vulë dhe etiketë origjinale të subjektit ofertues.
- Fletë-analize laboratorike të gradave.

Mos plotesimi nga subjekti prodhues (ofertues) në procedurë vleresimi i katër kerkesave të mesiperme do të konsiderohet skualifikim teknik.

Treguesit fiziko-mekanik e kimik të lëndës së I-rë tekstil për prodhimin e artikullit “Grada gjoksi ” duhet të rezultojnë të jenë domosdosmerisht në përputhje me specifikimet teknike.

Mungesa e mostres dhe flete analizave qe shoqerojne ato, eshte kusht skualifikues.

18. Grada supi për punonjësit e Gardës së Republikës.

- 4 (katër) copë Gradë supi në formë spaleti (nga një palë për secilen nivel). Mostrat duhet të kenë të trapezuar vulë dhe etiketë origjinale të subjektit ofertues.
- Fletë-analize laboratorike të gradave.

Mos plotësimi nga subjekti ofertues në procedurë vleresimi i kerkesave të mesiperme do të konsiderohet skualifikim teknik.

Treguesit fiziko-mekanik e kimik të lëndës së I-rë tekstil i punuar me fill me ngjyre të zezë për prodhimin e artikullit “Grada supi” duhet të rezultojnë të jenë domosdosmerisht në përputhje me Specifikimet Teknike.

Mungesa e mostres dhe flete analizave qe shoqerojne ato, eshte kusht skualifikues.

19. “Shenjë emri” për punonjësit e Gardës së Republikës

-
- 1 (një) copë “shenjë emri “

Mungesa e mostrës është kusht skualifikues

20. “Emblemë e vogël” për punonjësit e Gardës së Republikës.

- 1 (një) copë “emblemë të vogël “

Mungesa e mostres është kusht skualifikues.

21. Kostum dimëror (*xhup, pantallona dhe kapele sportive dimërore*) për efektivin shofer (makinë policie) dhe motoçiklist ceremonial, është e njëjtë me atë të Policisë së Shtetit (Policia Rrugore), me gradat e shenjat dalluese të Gardës së Republikës.

- 1 (një) komplet kostumi të përfunduar (*xhup, pantallota dhe kapele sportive dimërore*) me nr gjoksi 50.

- 1 (një) pjesë tekstili 50 x50 cm.

- Fletë-analize laboratorike të treguesve fiziko-mekanik e kimik të lëndës së parë të përdorur nga prodhuesi.

Copa e mostrës, lëndës së parë dhe ajo që i bashkëngjitet raport-analizes duhet të jenë detyruesisht të njëjta.

Kostumit dhe lëndës së parë u qepet nga një etiketë tekstili të bardhë në të cilën shkruhet: moster “Kostum dimëror policia rrugore”, emri i ofertuesit, data e tenderit, nënshkrimi dhe vula e ofertuesit.

Mungesa e mostres, lëndës së parë dhe fletë analizes që shoqëron ato është kusht skualifikues.

22. “Pantallona doku verore” dhe “Kapele sportive” e policisë, për efektivin shofer (makinë policie) dhe motoçiklist ceremonial, e njëjtë me atë të Policisë së Shtetit (Policia Rrugore), me gradat e shenjat dalluese të Gardës së Republikës.

- 1 (një) palë “**Pantallona doku verore**” e *patrullave të Policisë së Shtetit*

- 1 (një) “**Kapele sportive**” e *patrullave të Policisë së Shtetit*

Mostra duhet të ketë vulë dhe etikete origjinale të subjektit prodhues.

- 1 (një) pjesë trikotazhi me permasa 50 x 50 cm.

- Fletë-analizë laboratorike të treguesve fiziko-mekanik e kimik të lëndës së parë të përdorur nga prodhuesi.

Copa e mostrës, lëndës së parë dhe ajo që i bashkëngjitet raport-analizes duhet të jenë detyruesisht të njëjta.

Mos plotësimi nga subjekti prodhues (ofertues) në procedurë vlerësimi i tre kërkesave të mësipërme do të konsiderohet skualifikim teknik.

Bluzës së pambukut dhe lëndës së parë u qepet nga një etiketë tekstili në të cilën shkruhet: moster “**Pantallona doku verore**” dhe “**Kapele sportive**” *për patrullat e Policisë së Shtetit*”, emri i ofertuesit, data e tenderit, nënshkrimi dhe vula e ofertuesit.

Mungesa e mostres, lëndës së parë dhe fletë analizes që shoqëron ato është kusht skualifikues.

23. “Bluzë polo me mëngë të shkurtra për meshkuj, për efektivin shofer (makinë policie) dhe motoçiklist ceremonial, është e njëjtë me atë të Policisë së Shtetit (Policia Rrugore), me gradat e shenjat dalluese të Gardës së Republikës.

- 1 (një) copë **“Bluzë polo me mëngë të shkurtra për patrullat e Policisë së Shtetit”** me nr gjoksi 50.

Mostra duhet të ketë vulë dhe etikete origjinale të subjektit prodhues.

- 1 (një) pjesë trikotazhi me permasa 50 x 50 cm.

- Fletë-analizë laboratorike të treguesve fiziko-mekanik e kimik të lëndës së parë të përdorur nga prodhuesi.

Copa e mostrës, lëndës së parë dhe ajo që i bashkëngjitet raport-analizes duhet të jenë detyrimisht të njëjta.

Mos plotesimi nga subjekti prodhues (ofertues) në procedurë vleresimi i tre kerkesave të mësipërme do të konsiderohet skualifikim teknik.

Bluzës së pambukut dhe lëndës së parë u qepet nga një etiketë tekstili në të cilën shkruhet: moster **“Bluzë polo me mëngë të shkurtra për patrullat e Policisë së Shtetit”**, emri i ofertuesit, data e tenderit, nenshkrimi dhe vula e ofertuesit.

Mungesa e mostres, lëndës parë dhe fletë analizës që shoqëron ato është kusht skualifikues.

24. Pelerine shiu për efektivin shofer (makinë policie) dhe motoçiklist ceremonial, është e njëjtë me atë të Policisë së Shtetit (Policia Rrugore), me gradat e shenjat dalluese të Gardes së Republikës.

- 1 (një) copë “pelerin shiu” me masë gjoksi M.

Mostra duhet të kenë vulë dhe etikete origjinale të fabrikes prodhuese.

- 1 (një) pjesë Pelhurë impermeable (tekstil i gomuar) 100 % poliamid me Iluster nga brënda, mostër me permasa 50 x 50 cm.

- Fletë-analize laboratorike të treguesve fiziko-mekanik e kimik të lëndës së parë të përdorur nga prodhuesi.

Copa e mostres, lëndës së parë dhe ajo që i bashkëngjitet raport-analizes duhet të jenë detyrimisht të njëjta.

Pelerinës si dhe lëndës së parë u qepet nga një etiketë tekstili në të cilën shkruhet: moster “Pelerin shiu policia rrugore”, emri i ofertuesit, data e tenderit, nenshkrimi dhe vula e ofertuesit.

Mungesa e mostres, lëndës parë dhe fletë analizës që shoqëron ato është kusht skualifikues.

25. Kostum ceremoniali vere për truprojen e nderit, (kapele, xhakete, pantallona, shirit dekorativ (fjongo), rrip mesi ceremonial) **të Gardës së Republikës.**

- 1 (një) komplet kostumi të përfunduar (1 kapele, 1 xhakete, 1 palë pantallona, shirit dekorativ, rrip ceremonial). Kostumi i mosters me nr gjoksi 50.

- 1 (një) pjesë stofi me ngjyrë të kuqe nga i xhaketes, me permasa 20 x20 cm.

- 1 (një) pjesë stofi me ngjyrë të zezë nga i pantallonave dhe kapeles, me permasa 20 x20 cm.

- Fletë-analizat laboratorike të treguesve fiziko-mekanik e kimik të lëndëve të para (stofi i kuq dhe i zi) të përdorur nga prodhuesi.

Stofi i mostrës (kostumit), pjesët e stofit (lëndët e para) që shoqërojnë atë dhe copat e stofit që i bashkëngjiten raport-analizave të laboratorit, duhet të jenë detyrimisht të njëjta.

Kostumit mostër (Kapeles, xhaketes, pantallonave,) dhe lëndëve të para (pjesëve të stofit), u qepet me tegel makine nga një etiketë tekstili e bardhë, me permasa të përafërta 10 x 10 cm, në të cilën shkruhet: mostër “Kostum ceremonial vere për truproje nderi Gardë”, emri i ofertuesit, data e tenderit, nenshkrimi dhe vula e ofertuesit.

Mungesa e mostres, lendeve te para dhe flete analizave qe shoqerojne ato, eshte kusht skualifikues.

26. Kostum ceremoniali dimri për truprojen e nderit, (kapele, xhaketë, pantallona, shirit dekorativ (fjongo), rrip mesi ceremonial) të Gardës së Republikës.

- 1 (një) komplet kostumi të përfunduar (1 kapele, 1 xhakete, 1 palë pantallona, shirit dekorativ, rrip ceremonial). Kostumi i mosters me nr gjoksi 50.
- 1 (një) pjesë stofi me ngjyrë të kuqe nga i xhaketes, me përmasa 20 x20 cm.
- 1 (një) pjesë stofi me ngjyrë të zezë nga i pantallonave dhe kapeles, me përmasa 20 x20 cm.
- Fletë-analizat laboratorike të treguesve fiziko-mekanik e kimik të lëndëve të para (stofi i kuq dhe i zi) të përdorur nga prodhuesi.

Stofi i mostrës (kostumit), pjesët e stofit (lëndët e para) që shoqërojnë atë dhe copat e stofit që i bashkëngjiten raport-analizave të laboratorit, duhet të jenë detyrimisht të njëjta.

Kostumit mostër (Kapeles, xhaketes, pantallonave,) dhe lëndëve të para (pjesëve të stofit), u qepet me tegel makine nga një etiketë tekstili e bardhë, me përmasa të përafërta 10 x 10 cm, në të cilën shkruhet: mostër “Kostum ceremonial dimri për truproje nderi Garde”, emri i ofertuesit, data e tenderit, nënshkrimi dhe vula e ofertuesit.

Mungesa e mostres, lendeve te para dhe flete analizave qe shoqerojne ato, eshte kusht skualifikues.

-Mostrat do të paraqiten pranë Autoritetit Kontraktor Operatori i Blerjeve të Përqëndruara sh.a në datën dhe orën e hapjes se tenderit, me adresë: Rr “Reshit Çollaku”,Godina Nr.6/337, Tiranë (në krah të Gjykatës së Lartë).

5. Operatori ekonomik duhet të disponoje makinerite si më poshtë:

- Makina qepëse – minimalisht 15 copë
- Makineri hekurosje- minimalisht 1 copë

Për makineritë dhe pajisjet e deklaruar sipas kësaj pikë të provohet diponueshmëria e tyre në një nga mënyrat sipas legjislacionit në fuqi si më poshtë:

- fatura shit blerje **ose**
- kontrata shitblerje **ose**
- kontratë qeraje **ose**
- kontratë huapërdorje.

Shënim: Kriteri nr. 5 konsiderohet i permbushur me plotesimin e formularit te vetedeklarimit shtojca 9. Dokumentet e kerkuara me siper do te paraqiten ne rast se operatori kualifikohet i pari, por perpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe nisjes se afateve te ankimit ose nese kerkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

6. Operatori ekonomik duhet të paraqesë certifikata të lëshuara nga organizmat e vlerësimit të konformitetit, të akredituara nga organizmi kombëtar akreditues, ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, në përputhje me objektin e prokurimit, si më poshtë:

ISO 9001:2015 “Mbi sistemet e menaxhimit të cilësisë” (e vlefshme) ose ekuivalent;

ISO 14001:2015 “Mbi Sistemet e menaxhimit të mjedisit” (e vlefshme) ose ekuivalent;

ISO 45001:2018 ose të përditësuar ISO 45001:2023 “Për Sistemin e Menaxhimit të Shëndetit dhe Sigurisë në Punë” (e vlefshme) ose ekuivalent.

7. Operatori ekonomik duhet të paraqesë certifikatën OEKO-TEX standard 100 të tekstileve (ose ekuivalente) të prodhuesit të lëndës së parë të artikujve objekt prokurimi, për të vertetuar se lënda e parë e artikujve të ofruara nuk kane substanca të dëmshme për shëndetin dhe janë në përputhje me normativat e specifikuar të certifikimit OEKO-TEX ose ekuivalente.

8. Operatori ekonomik pjesëmarrës, për transportin e mallrave objekt prokurimit duhet të disponojë, mjetet e mëposhtme:

Mjete	Sasia	Gjendja
Mjet për transportin e mallrave	1 (një)	Pronësi / Me qera / Huapërdorje

a) Për mjetet me goma që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), plus certifikatën e kontrollit teknik (e vlefshme), siguracionin e mjetit (të vlefshme) dhe certifikatën e pronësisë së mjetit.

b) Për mjetet e siguruar me qera, duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e tij (leje qarkullimi), plus certifikatën e kontrollit teknik (e vlefshme), siguracionin e mjetit (të vlefshme), dhe certifikatën e pronësisë së mjetit duhet të shoqërohet me kontratën perkatese të qerave, ose të huapërdorjes (sipas rastit).

Shenim: Kriteri nr.8 konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit shtojca 9. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqiten në rast se operatori kualifikohet i pari, por përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

9. Operatori ekonomik duhet të lëshojë një deklaratë:

- Për periudhën minimale 1(një) vjeçare të garancisë së mallrave objekt prokurimi nga data e dorëzimit të mallit, gjatë së cilës merr përsipër zëvendësimin e artikujve veshmbathje, brenda afatit të garancisë, për defekte që vijnë si rrjedhojë e procesit teknologjik të lëndëve të para e ndihmëse që përdoren.

- Për periudhën minimale 2 (dy) vjeçare të garancisë për artikullin nr. 18 “Grada supi për punonjësit e Gardës së Republikës” në përputhje me specifikimet teknike në dokumentet e tenderit.

Shënim: Në rast të bashkimit të operatorëve ekonomikë, secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76, të LPP-së, dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare,

profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje.

Shënim: Bazuar në nenin 82 pika 4 të të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik" të ndryshuar, në rastin e operatorëve ekonomikë të huaj, dokumentet duhet të paraqiten në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit. Në raste të dokumenteve që nuk lëshohen në vendin e origjinës, ky fakt duhet të provohet prej operatorëve ekonomikë.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente me të dhëna të rreme ose të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Shtojca 9.

(Shtojcë për tu paraqitur nga operatori ekonomik)

FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT

I. Unë i nënshkruari _____ në cilësinë e _____ të operatorit ekonomik _____ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:

A. Pjesa I: Informacion në lidhje me Operatorin Ekonomik

Identifikimi	Përgjigja
Emri i operatorit ekonomik: (Ju lutemi renditni të gjithë operatorët ekonomikë nëse jeni një BOE. Ju lutemi tregoni rolin e operatorit ekonomik në BOE)	-----
Numri NIPT/et:	-----
Adresa postare: Qyteti / qyteti; Kodi postar	-----
Përfaqësuesi (emri):	-----
Telefoni:	-----
E-mail:	----- ---

B: DEKLARATË

Për nënkontraktorët dhe subjektet në kapacitetet, e të cilave do të mbështetet Operatori Ekonomik (nëse është e zbatueshme)

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se: Informacione për nënkontraktorin
--

Emri i nënkontraktorit të propozuar	NIPT – i	Përqindja e nënkontraktimit	Mallrat/ shërbimet e lidhura me to për t'u nënkontraktuar

- Informacion mbi subjektet mbi kapacitetin, e të cilëve do të mbështetet operatori ekonomik

Emri (at) e subjekteve	NIPT-i	Lloji i kapacitetit për të cilin do të mbështetet operatori ekonomik	Specifiko konkretisht kapacitetin/et

Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit

A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT

Deklarata
Operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv. <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____
